

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT E PRISHTINËS me Trupin Gjykses të përbërë nga Gjykatësi i EULEX-it Jonathan Welford-Carroll, kryetar i trupit gjykses, Gjykatësen Shqipe Qerimi dhe Gjykatësin e EULEX-it Dean Pineles, anëtarë të trupit gjykses, të asistuar nga Zyrtarja Ligjore e EULEX-it Zane Ratniece, procesmbajtëse, në lëndën penale ndaj:

- I. **NK**, nofka 'BF', emri i babait XX, emri i nënës XX, i lindur me XX në fshatin XX, Komuna e XX, Shqiptar nga Kosova, banues në fshatin XX, Komuna e XX, ka ndjekur fakultetin juridik, inspektor në PTK; i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorit Special të EULEX-it, PPS nr. 07/10, që mban datën dhe që është deponuar në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me 25.07.2011 (**Aktakuzë**) për veprat penale:

Akuza 1: **Krime Luftë kundër Popullatës Civile dhe Krime Luftë kundër Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 142, 144 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), aktualisht të dënueshme sipas Neneve 23, 120 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, dhe Neneve 4, 5(1) të Protokollit Shtesë II të katër Konventave të Gjenevës (PSHII); i akuzuari, në cilësinë e tij si anëtar dhe komandant i UÇK-së, dhe si person që mbante pozitë me përgjegjësi në qendrën e ndalimit në Kleçkë, në bashkëkryerje me FL, NXK, NS, AK, BL, BS, SS, dëshmitarin bashkëpunues X, SHS dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së deri tani të paidentifikuar, **ka dhunuar integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të papërcaktuar serbësh dhe**

shqiptarësh civilë dhe të burgosurve ushtarakë serbë, të mbajtur në qendrën e ndalimit në Kleçkë, duke i mbajtur ata në kushte çnjerëzore (duke përfshirë të burgosurit të lidhur me zinxhirë, në lokale të papërshtatshme, të ftohtë të tepërt, mungesë të higjienës, ushqim të papërshtatshëm, rrahjeve të shpeshta); në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, nga fillimi i vitit 1999 deri në mes të qershorit të vitit 1999;

Akuza 2: **Krime Luftë kundër Popullatës Civile**, sipas Neneve 22, 142 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas Neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, dhe Neneve 4, 5(1) PSHII; i akuzuari, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me NXK, NS dhe RM, **ka vrarë AA**, civil Shqiptar nga Kosova i cili më herët ishte ndaluar dhe liruar nga qendra e ndalimit në Kleçkë, duke e qëlluar me armë zjarri AK-47; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, me apo rreth 03/04 prill 1999;

Akuza 3: **Krime Luftë kundër Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 144 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas Neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të viti 1949, dhe Neneve 4, 5(1) PSHII; i akuzuari, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe në bashkëkryerje me NXK, NS dhe dy ushtarë të pidentifikuar të UÇK-së, **ka marrë pjesë në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë** të ndaluar në qendrën e ndalimit në Kleçkë, mbetjet e të cilëve janë gjetur në varr masiv afër Kleçkës dhe janë identifikuar përmes ADN si BC, ZF dhe ZT, të cilët janë ekzekutuar me disa plumba të armës së zjarrit AK-47 nga grupi i përbërë nga NK, NXK, NS dhe dy ushtarë të pidentifikuar të UÇK-së; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, me një datë të papërcaktuar në prill 1999, jo para 11 prillit 1999;

Akuza 4: **Krime Luftë kundër Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 144 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas Neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të viti 1949, dhe Neneve 4, 5(1) PSHII; i akuzuari, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me NXK, **ka shkelur integritetin**

trupor dhe shëndetin e të burgosurit ushtarak Serb, të ndaluar në qendrën e ndalimit në Kleçkë, duke e rrahur vazhdimisht; viktima më pas është vrarë dhe mbetjet trupore të tij janë gjetur në një varr masiv afër Kleçkës që përmbante pesë kufoma; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill 1999, jo para 11 prillit 1999;

Akuza 5: **Krime Lufte kundër Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 144 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas Neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës së vitit 1949, dhe Neneve 4, 5(1) PSHII; i akuzuari në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me NXK, NS, RM, AK dhe dëshmitarin bashkëpunues X **ka marrë pjesë në vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb**, i përmendur lartë në akuzën 4; më saktësisht, i pandehuri ka marrë pjesë në krim duke e marshuar të burgosurin te vendi i ekzekutimit dhe duke e mbajtur atë në dispozicion të drejtpërdrejtë të kryerësit, NS, edhe pse ai e ka ditur, sepse në mënyrë të qartë është informuar për qëllimin e NS për të vrarë të burgosurin nga një bisedë e mëhershme në mes këtij të fundit dhe FL, se i burgosuri do të ekzekutohet; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill 1999, jo para 11 prillit 1999;

Akuza 6: **Krime Lufte kundër Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 144 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas Neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, dhe Nenit 4, 5(1) PSHII; i akuzuari në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me FL, NXK, NS, AK, BL dhe dëshmitarin bashkëpunues X, **ka marrë pjesë në vrasjen e ND dhe VM, që të dy oficerë serbë të policisë**, të mbajtur në qendrën e ndalimit në Kleçkë, të cilët ishin ekzekutuar nga dëshmitari X me disa të shtëna me pistoletë; më saktësisht, i pandehuri ka marrë pjesë në veprën penale duke i mbajtur viktimat në dispozicion të drejtpërdrejtë të kryerësit të ekzekutimit, edhe pse ai e ka ditur, se në mënyrë të qartë është informuar lidhur me qëllimin e FL për të vrarë të burgosurit, çfarë do të

ndodhte me ta; në vendin e quajtur Livadhi i Canit afër Kleçkës, Lipjan, me apo rreth 04/05 prill 1999;

- II. **NXK**, shenja e koduar gjatë luftës 'Sxxx, emri i babait XX, emri i nënës XX, i lindur me XX në fshatin YY, Komuna e XX, Shqiptar nga Kosova, banues në rrugën YY, ka ndjekur shkollën juridike, oficer policie; sipas aktakuzës i akuzuar me vepra penale:

Akuza 1: **Krime Luftë kundër Popullatës Civile dhe Krime Luftë kundër Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas neneve 23, 120 KPK, në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, dhe Neneve 4, 5(1) PSHII; i akuzuari në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me FL, NK, NS, AK, BS, SS, dëshmitarin bashkëpunues X dhe SHS dhe ushtarë tjerë të pidentifikuar të UÇK-së, **kanë dhunuar integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të papërcaktuar serbësh dhe shqiptarësh civilë dhe të burgosurve ushtarakë serbë**, të mbajtur në qendrën e ndalimit në Kleçkë, duke i mbajtur ata në kushte çnjerëzore (duke përfshirë të burgosurit e lidhur me zinxhirë, në lokale të papërshtatshme, në kushte të ftohtit të tepërt, mungesës së higjienës, ushqimit të papërshtatshëm, rrahjeve të shpeshta); në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, nga fillimi i vitit 1999 deri në mes të qershorit të vitit 1999;

Akuza 2: **Krime Luftë kundër Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 144 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas Neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, dhe Neneve 4, 5(1) PSHII; i akuzuari, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe në bashkëkryerje me dëshmitarin X, NS, SS, BS, **kanë torturuar katër të burgosur ushtarakë serbë**, të mbajtur në qendrën e ndalimit në Kleçkë, mbetjet trupore të të cilëve janë gjetur në një varr masiv afër Kleçkës dhe së paku tre prej tyre janë identifikuar përmes ADN-së si BC, ZF dhe ZT, duke i rrahur ata vazhdimisht; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill 1999, jo përpara datës 11 prill 1999;

Akuza 3: **Krime Luftë kundër Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 144 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas Neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, dhe Neneve 4, 5(1) PSHII; i akuzuari në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe në bashkëkryerje me NK, NS dhe dy ushtarë të pidentifikuar të UÇK-së, **ka marrë pjesë në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë**, të mbajtur në qendrën e ndalimit në Kleçkë, tre nga të cilët janë identifikuar përmes ADN-së si BC, ZF dhe ZT, të cilët ishin ekzekutuar me disa plumba të armës së zjarrit AK-47 nga një grup i përbërë nga NK, NXX, NS dhe dy ushtarë të pidentifikuar të UÇK-së; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, jo përpara 11 prillit 1999;

Akuza 4: **Krime Luftë kundër Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 144 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas Neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të viti 1949, dhe Neneve 4, 5(1) të PSHII; i akuzuari, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me NK **ka shkelur integritetin trupor dhe shëndetin e një të burgosuri ushtarak serb**, të mbajtur në qendrën e ndalimit në Kleçkë, duke e rrahur atë vazhdimisht; viktima më pas është vrarë dhe mbetjet e tij trupore janë gjetur në një varr masiv në Kleçkë që përmbante pesë kufoma; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një kohë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, jo përpara prillit 1999;

Akuza 5: **Krime Luftë kundër Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 144 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas Neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët me të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, dhe Neneve 4, 5(1) të PSHII; i akuzuari, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së , në bashkëkryerje me NK, NS, RM, AK dhe dëshmitarin bashkëpunues X **ka marrë pjesë në vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb**, të përmendur lartë në akuzën 4; më saktësisht , i pandehuri ka marrë pjesë në krim duke marshuar të burgosurin te vendi i ekzekutimit dhe duke e mbajtur atë në

dispozicion të drejtpërdrejtë të kryesit të ekzekutimit, NS, edhe pse ai e ka ditur, se është informuar në mënyrë të qartë rreth qëllimit të NS për të vrarë të burgosurin nga biseda e mëhershme ndërmjet të fundit dhe FL, se i burgosuri do të ekzekutohet; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, jo përpara 11 prillit 1999;

Akuza 6: **Krime Luftë kundër Popullatës Civile**, sipas Neneve 22, 142 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas Neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe Neneve 4, 5(1) të PSHII; i akuzuari, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me NK, NS, dhe RM, **ka vrarë AA**, civil shqiptar nga Kosova i cili ishte ndaluar dhe liruar më herët nga qendra e ndalimit në Kleçkë, duke e qëlluar me armë zjarri AK-47; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, me ose rreth 03/04 prill 1999;

Akuza 7: **Krime Luftë kundër Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 144 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas Neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, dhe Neneve 4, 5(1) të PSHII; i akuzuari në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me FL, NK, NS, AK, BL dhe dëshmitarin bashkëpunues X, **ka marrë pjesë në vrasjen e ND dhe VM, që të dy oficerë serbë të policisë**, të mbajtur në qendrën e ndalimit në Kleçkë, të cilët ishin ekzekutuar nga dëshmitari X me disa të shtëna të pistoletës; më saktësisht, i pandehuri ka marrë pjesë në krim duke mbajtur viktimat në dispozicion të drejtpërdrejtë të kryerësit të ekzekutimit, edhe pse ai e ka ditur, se në mënyrë të qartë është informuar rreth qëllimit të FL për të vrarë të burgosurit, çfarë do të ndodhë me ta; në një vend afër Kleçkës të njohur si Livadhi i Canit, Lipjan, me ose rreth 04/05 prill 1999;

III. **FL**, nofka 'CL', emri i babait XX, emri i nënës XX, i lindur me XX në fshatin XX, Komuna e XX, Shqiptar nga Kosova, banues në ZZ, ka ndjekur fakultetin juridik, anëtar i Kuvendit të Kosovës; i akuzuar sipas aktakuzës me veprat penale:

Akuza 1: **Krime Luftë kundër Popullatës Civile dhe Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas Neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët për të katër Konventat të Gjenevës të vitit 1949, dhe Neneve 4, 5(1) të PSHII; i akuzuari në cilësinë e tij si anëtar dhe komandant i UÇK-së, dhe si person që ka ushtruar kontroll të përgjithshëm në qendrën e ndalimit në Kleçkë; dhe në bashkëkryerje me NK, NXK, NS, AK, BL, BS, SS, dëshmitarin bashkëpunues X, SHS dhe ushtarë tjerë të pidentifikuar të UÇK-së, **ka dhunuar integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të papërcaktuar serbësh dhe shqiptarësh civilë dhe të burgosurve ushtarakë serbë**, të mbajtur në qendrën e ndalimit në Kleçkë, duke i mbajtur në kushte çnjerëzore (duke përfshirë të burgosurit e lidhur me zinxhirë, në lokale të papërshtatshme, në kushte të ftohtit të tepërt, mungesës së higjienës, ushqimit të papërshtatshëm, rrahjeve të shpeshta); në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, nga fillimi i 1999 deri në mes të qershorit të vitit 1999;

Akuza 2: **Krime Luftë kundër Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 144 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas Neneve 23, 120 të KPK, në shkelje Nenit 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, dhe Neneve 4, 5(1) të PSHII; i akuzuari, në cilësinë e tij si anëtar dhe komandant i UÇK-së, **ka torturuar një të burgosur ushtarak serb**, të mbajtur në qendrën e ndalimit në Kleçkë, mbetjet trupore të të cilit janë gjetur afër Kleçkës në një varr masiv që përmbante pesë kufoma, duke e rrahur dhe shkelmuar atë gjatë marrjes në pyetje; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, jo përpara 11 prillit 1999;

Akuza 3: **Krime Luftë kundër Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 144 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas Neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët për të

katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, dhe Neneve 4, 5(1) të PSHII; i akuzuari, në cilësinë e tij si anëtar dhe komandant i UÇK-së, në bashkëkryerje me NXX, NS, NK, AK, BL dhe dëshmitarin bashkëpunues X, **ka marrë pjesë në vrasjen e ND dhe VM, që të dy oficerë serbë të policisë**, të mbajtur në qendrën e ndalimit në Kleçkë, të cilët janë ekzekutuar nga dëshmitari bashkëpunues X me disa me disa të shtëna të pistoletës; më saktësisht, i pandehuri ka marrë pjesë në krim duke urdhëruar dëshmitarin X të ekzekutoi të burgosurit; në një vend afër Kleçkës të njohur si Livadhi i Canit, Lipjan, me ose rreth 04/05 prill 1999;

IV. **NS**, nofka 'FT', emri i babait XX, emri i nënës XX, i lindur me XX, në fshatin XX, Komuna e XX, Shqiptar nga Kosova, banues në Rrugën QQ, ka ndjekur fakultetin ekonomik, ekonomist; i akuzuar sipas aktakuzës me vepra penale:

Akuza 1: **Krime Luftë kundër Popullatës Civile dhe Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas Neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, dhe Neneve 4, 5(1) të PSHII; i akuzuari, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së që mbante pozitë me përgjegjësi në qendrën e ndalimit në Kleçkë, në bashkëkryerje me FL, NK, NXX, AK, BL, BS, SS, dëshmitarin bashkëpunues X, SHS dhe me ushtarë tjerë të UÇK-së të paidentifikuar deri më tani, **ka dhunuar integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të papërcaktuar serbësh dhe shqiptarësh civilë dhe të burgosurve ushtarakë serbë**, të mbajtur në qendrën e ndalimit në Kleçkë, duke i mbajtur në kushte çnjerëzore (duke përfshirë të burgosurit e lidhur me zinxhirë, në lokale të papërshtatshme, në kushte të ftohtit të tepërt, mungesës së higjienës, ushqimit të papërshtatshëm, rrahjeve të shpeshta); në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, nga fillimi i 1999 deri në mes të qershorit të vitit 1999;

Akuza 2: **Krime Luftë kundër Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 144 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas Neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët për të

katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, dhe Neneve 4, 5(1) të PSHII; i akuzuari, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe në bashkëkryerje me dëshmitarin X, NXK, SS, BS, **ka torturuar katër të burgosur ushtarakë serbë**, të mbajtur në qendrën e ndalimit në Kleçkë, mbetjet trupore të të cilëve janë gjetur në një varr masiv pranë Kleçkës dhe së paku tri prej të cilave janë identifikuar përmes ADN-së si BC, ZF dhe ZT, duke i rrahur ata vazhdimisht; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, jo përpara 11 prill të vitit 1999;

Akuza 3: **Krime Luftë kundër Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 144 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas Neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, dhe Neneve 4, 5(1) të PSHII; i akuzuari, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe në bashkëkryerje me NK, NXK dhe dy ushtarë të paidentifikuar të UÇK-së, **ka marrë pjesë në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë**, të mbajtur në qendrën e ndalimit në Kleçkë, mbetjet trupore të të cilëve janë gjetur në një varr masiv pranë Kleçkës dhe së paku tri prej të cilave janë identifikuar përmes ADN-së si BC, ZF dhe ZT, të cilët ishin ekzekutuar me disa plumba të armës së zjarrit AK-47 nga një grup i përbërë prej NK, NXK, NS, dhe dy ushtarëve të paidentifikuar të UÇK-së; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, jo përpara 11 prillit të vitit 1999;

Akuza 4: **Krime Luftë kundër Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 144 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas Neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, dhe Neneve 4, 5(1) të PSHII; i akuzuari, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me NK, NXK, RM, AK dhe dëshmitarin bashkëpunues X **ka vrarë një të burgosur ushtarak serb**, të mbajtur në qendrën e ndalimit në Kleçkë, mbetjet trupore të të cilit janë gjetur në një varr masiv pranë Kleçkës që përmbante pesë kufoma, duke i shkaktuar disa goditje në trup (dhe saktësisht në qafë) me një kosë; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, jo përpara 11 prillit të vitit 1999;

Akuza 5: **Krime Luftë kundër Popullatës Civile**, sipas Neneve 22, 142 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas Neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe Neneve 4, 5(1) të PSHII; i akuzuari, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me NK, NXK dhe RM, **ka marrë pjesë në vrasjen e AA**, civil shqiptar nga Kosova i cili ishte ndaluar dhe liruar më herët nga qendra e ndalimit në Kleçkë; më saktësisht, i pandehuri ka marrë pjesë në krim duke mbajtur viktimën në dispozicion të drejtpërdrejtë të kryerësve dhe duke e shtyrë atë në një gropë ku më pas ai është ekzekutuar nga NK dhe NXK me armë zjarri AK-47; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, me ose rreth 03/04 prill 1999;

Akuza 6: **Krime Luftë kundër Robërve të Luftës**, sipas Neneve 22, 144 të KPRSFJ, aktualisht i dënueshëm sipas Neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të Nenit 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, dhe Neneve 4, 5(1) të PSHII; i akuzuari në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me FL, NK, NS, AK, BL dhe dëshmitarin bashkëpunues X, **ka marrë pjesë në vrasjen e ND dhe VM, që të dy oficerë serbë të policisë**, të mbajtur në qendrën e ndalimit në Kleçkë, të cilët ishin ekzekutuar nga dëshmitari X me disa të shtëna të pistoletës; më saktësisht, i pandehuri ka marrë pjesë në krim duke mbajtur viktimat në dispozicion të drejtpërdrejtë të kryerësit të ekzekutimit, edhe pse ai e ka ditur, se në mënyrë të qartë është informuar rreth qëllimit të FL për të vrarë të burgosurit, çfarë do të ndodhë me ta; në një vend afër Kleçkës të njohur si Livadhi i Canit, Lipjan, me ose rreth 04/05 prill 1999;

PAS mbajtjes së seancave të gjyqimit kryesor, me dyer të hapura për publik me datat 11 dhe 14 nëntor 2011, 01 dhe 14 dhjetor 2011, 16, 30 dhe 31 janar 2012, 06, 07, 09, 28 dhe 29 shkurt 2012, 01, 05, 06, 07, 21 dhe 30 mars 2012; të gjitha të mbajtura në praninë e të akuzuarit NK, avokatëve të tij mbrojtës Florin Vertopi dhe Xhafer Maliqi, të akuzuarit NXK, avokatëve të tij mbrojtës Mahmut Halimi dhe Betim Shala, të akuzuarit FL, avokatëve të tij mbrojtës Karim A. A.

Khan, QC dhe Tahir Rrecaj, të akuzuarit NS, avokatit të tij mbrojtës Bajram Tmava; përveç seancave kur avokatët mbrojtës dërguan zëvendësuesit e tyre;¹ dhe në prani të Prokurorit Special të EULEX-it Maurizio Salustro nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës (përveç në seancën e mbajtur me 30 mars 2012² kur ai dërgoi zëvendësuesin e tij³);

PAS këshillim-votimit të trupit gjykues të mbajtur me 02 maj 2012;

SIPAS Nenit 392 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) me datën 02 maj 2012, në seancën e zhvilluar me dyer të hapura për publikun dhe në praninë e të akuzuarve dhe avokatëve të tyre mbrojtës dhe Prokurorit Special të EULEX-it Maurizio Salustro;

shpall këtë

AKTGJYKIM

I. **NK**, me të dhëna personale si më sipër, i mbajtur në paraburgim nga data 16 mars 2011 deri me 21 mars 2012, shpallet siç vijon:

sipas Nenit 390 3) të KPPK-së

Akuza 1: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile dhe Krimeve të Luftës kundër Robërve të Luftës (dhunimin e

¹ Seancat janë mbajtur në prani të akuzuarve tjerë dhe avokatëve të tyre mbrojtës deri me 30 mars kur është bërë ndarja e procedurës.

² Në seancën e mbajtur me 30 mars 2012, është shpallur aktgjykimi lidhur me të akuzuarit tjerë në këtë lëndë, AK, BL, RM, SS, SHS dhe BS.

³ Në seancën e mbajtur me 30 mars 2012 Prokurori Special i EULEX-it Maurizio Salustro ishte zëvendësuar nga Prokurori Special i EULEX-it Charles Hardaway.

integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të papërcaktuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosur ushtarakë serbë)

Akuza 2: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile (vrasjen e AA)

Akuza 3: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Robërve të Luftës (pjesëmarrjen në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë)

Akuza 4: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Robërve të luftës (dhunimin e integritetit trupor dhe shëndetit të një të burgosuri ushtarak serb)

Akuza 5: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Robërve të Luftës (pjesëmarrjen në vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb)

Akuza 6: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Robërve të Luftës (pjesëmarrjen në vrasjen e ND dhe VM, që të dy oficerë serbë të policisë)

II. NXK, me të dhëna personale si më sipër, mbajtur në paraburgim nga data 16 mars 2011 deri me 21 mars 2012, shpallet siç vijon;

sipas Nenit 390 3) të KPPK-së

Akuza 1: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile dhe Robërve të Luftës (dhunimin e integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të papërcaktuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë)

Akuza 2: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Robërve të Luftës (torturimin e katër të burgosurve ushtarakë serbë)

Akuza 3: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Robërve të Luftës (pjesëmarrjen në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë)

- Akuza 4: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Robërve të Luftës (dhunimin e integritetit trupor dhe shëndetit të një të burgosuri ushtarak serb)
- Akuza 5: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Robërve të Luftës (pjesëmarrjen në vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb)
- Akuza 6: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile (vrasjen e AA)
- Akuza 7: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Robërve të Luftës (pjesëmarrjen në vrasjen e ND dhe VM, që të dy oficerë serbë të policisë)

III. **FL**, me të dhëna personale si më sipër, në arrest shtëpiak nga data 22 shtator 2011 deri me 21 mars 2012, shpallet siç vijon:

sipas Nenit 390 3) të KPPK-së

- Akuza 1: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Robërve të Luftës (dhunimin e integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të papërcaktuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë)
- Akuza 2: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Robërve të Luftës (torturimin e një të burgosuri ushtarak serb)
- Akuza 3: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Robërve të Luftës (pjesëmarrjen në vrasjen e ND dhe VM, që të dy oficerë serbë të policisë)

IV. NS, me të dhëna personale si më sipër, mbajtur në paraburgim nga data 16 mars 2011 deri me 21 mars 2012, shpallet siç vijon:

sipas Nenit 390 3) të KPPK-së

- Akuza 1: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile dhe Krimeve të Luftës kundër Robërve të Luftës (dhunimin e integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të papërcaktuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë)
- Akuza 2: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Robërve të Luftës (torturimin e katër të burgosurve ushtarakë serbë)
- Akuza 3: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Robërve të Luftës (pjesëmarrjen në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë)
- Akuza 4: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Robërve të Luftës (vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb)
- Akuza 5: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile (pjesëmarrjen në vrasjen e AA)
- Akuza 6: **I PAFAJSHËM** për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Robërve të Luftës (pjesëmarrjen në vrasjen e ND dhe VM, që të dy oficerë serbë të policisë)

SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE

Sipas Nenit 103 (1) të KPPK-së shpenzimet e procedurës penale sipas Nenit 99 (2) 1) deri 5) të KPPK-së, shpenzimet e nevojshme të të pandehurit dhe pagesa dhe shpenzimet e nevojshme të avokatëve mbrojtës, së bashku me shpenzimet për përkthimin, do të paguhen nga burimet buxhetore sipas tarifave të aplikueshme.

Nuk është ushtruar asnjë padi pronësore juridike. Prandaj, nuk është marrë asnjë vendim sipas Nenit 396 (4) të KPPK-së.

ARSYETIMI

PËRMBAJTJA

I. HYRJA	18
II. JURISDIKSIONI	20
III. LIGJI	21
A. Ekzistenca dhe kualifikimi i konfliktit të armatosur.....	21
B. Elementet e sjelljes së ndaluar: vrasja, torturimi, trajtimi çnjerëzor	28
IV. KONSIDERATAT LIDHUR ME VLERËSIMIN E DËSHMIVE	30
A. Dëshmia e Dëshmitarit Bashkëpunues	30
B. Barra e provës.....	32
C. Vlerësimi i dëshmive.....	35
D. Provat e mbledhura gjatë bastisjes	36
V. KONKLuzionET LIDHUR ME AKUZAT	39
A. Përmbledhje.....	39
B. Ekzistenca e burgut të UÇK-së në fshatin Kleçkë.....	40
C. Dhunimi i integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të papërcaktuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe e të burgosurve ushtarakë serbë	47
1. <u>Kushtet e paraburgimit</u>	48
2. <u>SA dhe YG</u>	55

3. <u>Vëllezërit BK, EK dhe NXK</u>	57
4. <u>Dëshmitari anonim H dhe vëllai i tij</u>	59
5. <u>DT, DV,</u> <u>BC, ZF, ZT,</u> <u>VM dhe ND</u>	61
D. Torturimi i katër të burgosurve ushtarakë serbë	65
E. Vrasja e katër të burgosurve ushtarakë serbë	67
F. Torturimi i një të burgosuri ushtarak serb	68
G. Vrasja e një të burgosuri ushtarak serb.....	69
H. Vrasja e ND dhe VM.....	71
I. Vrasja e AA.....	73
VI. KONKLuzionet mbi përgjegjësinë e të akuzuarve	74
A. Forma e përgjegjësisë	74
B. NK.....	82
1. <u>Roli i NK në burgun e Kleçkës</u>	83
2. <u>Përgjegjësia e NK</u>	88
C. NXK.....	91
D. FL.....	97
1. <u>Roli i L në burgun e Kleçkës</u>	97
2. <u>Përgjegjësia FL</u>	107
E. NS.....	108
1. <u>Roli i NS në burgun e Kleçkës</u>	108
2. <u>Përgjegjësia e NS</u>	109
VII. SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE DHE PADIA PRONËSORE	110
MJET LIGJOR	111
SHTOJCA I Dëshmitë e parashtruara nga Prokuroria	112
SHTOJCA II Dëshmitë e parashtruara nga Mbrojtja	122
SHTOJCA III Dëshmitë e përjashtuara me Aktgjykim	125

I. HYRJA

1. Aktakuza e Prokurorit Special të EULEX-it, PPS. Nr. 07/10, që mban datën dhe që është dorëzuar në Sekretarinë e Gjykatës më 25.07.2011 (Aktakuza) ngre akuza kundër të akuzuarve AK, NK, NXK, BL, FL, RM, NS, SS, SHS dhe BS, për veprat penale që pretendohet të jenë kryer nga ata dhe nga anëtarët e tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), nga fillimi i vitit 1999 deri në mes të qershorit të vitit 1999, kundër civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë në dhe afër Kleçkës, në Kosovë.

2. Aktakuza pretendon se një numër i papërcaktuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurish ushtarakë serbë ishin paraburgosur në një qendër të improvizuar paraburgimi të UCK-së që gjendej në fshatin Kleçkë, në kushte çnjerëzore dhe që u ishin nënshtruar rregullisht rrahjeve. Aktakuza emëron katërmbëdhjetë persona të cilët pretendohet të jenë paraburgosur në atë vend. Dy nga të paraburgosurit e emëruar pretendohet të jenë ekzekutuar me disa të shtëna me armë në vendin e njohur si 'Livadhi i Canit', pranë Kleçkës, më apo rreth datave 4/5 prill të vitit 1999. Njëri nga të paraburgosurit e emëruar pretendohet të jetë torturuar dhe më vonë ekzekutuar me kosë në prill të vitit 1999, jo përpara datës 11 prill 1999. Katër të paraburgosur të emëruar pretendohet se janë rrahur një ditë të tërë dhe se disa ditë më vonë ata ishin ekzekutuar me të shtëna në Kleçkë, në prill të vitit 1999, jo përpara datës 11 prill 1999.

3. Aktakuza pretendon se një i paraburgosur tjetër i emëruar, pas lirim, pretendohet të jetë ekzekutuar me të shtëna në Kleçkë, më ose rreth datave 3/4 prill 1999.

4. Këto pretendime mbështesin në tërësi 34 pika të ndryshme kundër të akuzuarve për krime lufte kundër popullatës civile dhe robërve të luftës, në kundërshtim me Nenet 142, 144 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), gjithashtu të parapara me anë të Neneve 120, 121 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), lexuar me Nenet 22, 24, 26 të KPRSFJ-së dhe 23, 25, 26 të KPK-së, në kundërshtim me Nenin 3 të Përbashkët për të katër Konventave të Gjenevës 1949 dhe Neneve 4, 5(1) të Protokollit Shtesë II (PSHII), të gjitha rregullave të së drejtës ndërkombëtare ishin në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë.

5. Një pikë kundër të akuzuarit AK ishte tërhequr nga Prokurori Special i EULEX-it.⁴

6. Gjatë zhvillimit të gjykimit kryesor procedura është ndarë.⁵ Me 30 mars 2012 Trupi Gjykses shpalli aktgjykim kundër të akuzuarve, AK, BL, RM, SS, SHS dhe BS. Aktgjykimi i 30 marsit 2012 ka shpallur ata të pafajshëm për 11 pika të aktakuzës dhe një pikë kundër AK, e cila ishte tërhequr nga Prokuroria, është hedhur poshtë. Aktgjykimi aktual është bërë lidhur me 22 akuzat të përgjithshme kundër të akuzuarve NK, NXK, FL dhe NS.

7. Të akuzuarit, të cilëve u referohet aktgjykimi aktual, NK, NXK, FL dhe NS, janë të akuzuar me përgjegjësi penale individuale, që pretendohet të kenë kryer dhe të kenë marrë pjesë në shkallë të ndryshme në kryerjen e veprave penale. I akuzuari FL për më tepër akuzohet si komandant dhe si person që ushtronte kontroll të përgjithshëm mbi qendrën e ndalimit në Kleçkë për sa i përket dhunimit të integritetit trupor dhe shëndetit të civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë, dhe si komandant për sa i përket torturimit të një të burgosuri ushtarak serb dhe vrasjen e dy oficerëve ushtarakë serbë, të mbajtur në qendrën e ndalimit në Kleçkë. I akuzuari NK akuzohet gjithashtu si komandant dhe si person që ka mbajtur pozitë me përgjegjësi për qendrën e ndalimit në Kleçkë për sa i përket shkeljes së integritetit trupor dhe shëndetit të civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë. I

⁴ Tërheqja e pjeshme e aktakuzës nga PSRK, 09.11.2011, PPS 07/10, Dosja e shqyrtimit kryesor 4.

⁵ Procesverbali i datës 30.03.2012, para. 10, Dosja e shqyrtimit kryesor 9.

akuzuari NS në kryerjen e krimit të përmendur për më tepër akuzohet në pozitën e tij të përgjegjësisë brenda qendrës së ndalimit në Kleçkë.

8. Të akuzuarit janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha akuzat ndaj tyre.⁶

II. JURISDIKSIONI

9. Sipas Nenit 23 1) të KPPK-së, 'gjkata e qarkut do të ketë juridiksionin për të gjykuar në shkallën e parë, veprën penale të ndëshkueshme me të paktën pesë vjet burgim apo burgim afatgjatë". Aktakuza e Prokurorit Special të EULEX-it i akuzon të akuzuarit për Krime Luftë kundër Popullatës Civile dhe Krime Luftë kundër Robërve të Luftës, që janë vepra penale të ndëshkueshme me burgim prej të paktën pesë vjetësh. Prandaj, gjykata aktuale ka juridiksionin lëndor mbi këtë çështje.

10. Krimet e pretenduara pretendohet se janë kryer në dhe afër Kleçkës, Komuna e Lipjanit në Kosovë. Komuna e Lipjanit gjendet në Qarkun e Prishtinës. Në bazë të kësaj, gjykata aktuale ka juridiksion territorial për këtë çështje, sipas Nenit 27 (1) të KPPK-së.

11. Neni 3.2 i Ligjit Nr.03/L-053 mbi Kompetencat, Caktimin dhe Shpërndarjen e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it, parasheh juridiksionin e Gjyqtarëve të EULEX-it për çështjet e ndjekura penalisht nga PSRK-ja. Neni 5.1 i Ligjit Nr. 03/L-052 mbi Zyrën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PSRK, i jep PSRK-së kompetenca ekskluzive për të kryer hetime dhe ndjekur penalisht Krimet e Luftës. Si pasojë, lënda është brenda juridiksionit të Gjyqtarëve të EULEX-it.

⁶ Procesverbali i datës 11.11.2011, para. 44-65, Dosja e shqyrtimit kryesor 3.

III. LIGJI

A. Ekzistenca dhe cilësimi i konfliktit të armatosur

12. Aktakuza e ngarkon secilin të akuzuar me veprat penale të Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile dhe Krimeve të Luftës kundër Robërve të Luftës.

13. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 mbi Ligjin e Aplikueshëm (12 dhjetor 1999) siç është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/59 (27 tetor 2000), dispozitat e vërteta ligjore të aplikueshme në këtë çështje janë dispozitat e Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë KPRSFJ-së, me ndryshimet e nxjerra nga Rregulloret e përmendura të UNMIK-ut.⁷

14. Sipas Nenit 142 të KPRSFJ-së, vepra penale e Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile kryhet nga “kushdo që në kundërshtim me rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e luftës, konfliktit të armatosur apo pushtimit, urdhëron që popullata civile t’i nënshtrohet vrasjeve, torturave, trajtimit çnjerëzor, eksperimenteve biologjike, vuajtjeve të mëdha apo dhunimit të integritetit trupor apo shëndetit; zhvendosjes apo shpërngulja apo shndërrimi i dhunshëm në një shtetësi apo besim tjetër; prostitucion apo përdhunim të detyruar; aplikimin e masave të shkaktimit të frikës dhe terrorit; marrja e pengjeve, vënia e ndëshkimit kolektiv, sjellje e kundërligjshme në kampe përqendrimi dhe arrestime të tjera të kundërligjshme e paraburgosje, privim nga e drejta e gjyqimit të drejtë dhe të paanshëm; shërbimi me dhunë në forcat ushtarake të ushtrisë armike apo në shërbimin e saj të inteligjencës apo administratës; punë të dhunshme, zija e bukës për popullatën, konfiskimin e pronës, plaçkitjen, shkatërrimin e paligjshëm dhe me qëllim si dhe vjedhjen në shkallë të madhe të pronës që nuk justifikohet për nevojat ushtarake, marrjen e paligjshme të kontributit jo-proporcional apo rekuizimin,

⁷ Dënimi me vdekje është hequr sipas Nenit 1.5. Në bazë të Nenit 1.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/59 për secilën vepër penale që dënohet me vdekje sipas ligjit në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989, dënimi me vdekje është transformuar me dënim me burg mes minimumit të parashikuar me ligj për atë vepër penale dhe maksimumit prej dyzet (40) vjetësh.

zhvlerësimi i valutës së brendshme apo hedhja në treg në mënyrë të kundërligjshme e valutës së re, apo kushdo që kryen njërin nga aktet paraprilese”.

15. Sipas Nenit 144 të KPRSFJ-së, vepra penale e Krimeve të Luftës kundër Robërve të Luftës, kryhet nga “kushdo, që në kundërshtim me rregullat e ligjit ndërkombëtar, urdhëron vrasjet, torturat ose trajtimin çnjerëzor të robërve të luftës, duke përfshirë në këtë mënyrë kryerjen e eksperimenteve biologjike, shkaktimin e vuajtjeve të mëdha apo lëndimeve të rënda ndaj integritetit trupor apo shëndetit, rekrutimin e detyrueshëm në forcat ushtarake të ushtrisë armike, apo privimin nga e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, apo kushdo që kryen ndonjërin nga aktet paraprilese”

16. Aktakuza përcakton se të akuzuarit kanë vepruar në kundërshtim me Nenit 3 të përbashkët për katër Konventat e Gjenevës së datës 12 gusht 1949 (Neni i përbashkët 3 KGJ 1949)⁸ dhe Neneve 4 dhe 5(1) të Protokollit Shtesë të Konventave të Gjenevës së datës 12 gusht 1949, që kanë të bëjnë me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Jo-ndërkombëtare të datës 8 qershor 1977 (Protokolli Shtesë II PSHII 1977).⁹

⁸ Neni i Përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës lexon:

Në rastin e konfliktit të armatosur të karakterit jo ndërkombëtar që zhvillohet në territorin e Palëve të Larta Kontraktuese, secila Palë në konflikt është e detyruar të aplikojë, si minimum, dispozitat në vijim:

(1) Personat që nuk marrin pjesë aktive në luftime, duke përfshirë anëtarët e forcave ushtarake që kanë dorëzuar armët dhe ata që gjenden jashtë luftimeve për shkak të sëmundjes, lëndimeve, paraburgimit, apo çdo shkak tjetër, do të trajtohen në të gjithë rrethanat në mënyrë të njerëzishme, pa ndonjë dallim racor, ngjyre, besimi fetar, gjinie, prejardhjeje apo pasurisë, apo ndonjë kriter tjetër të ngjashëm.

Nga ky këndvështrim, aktet vijuese janë dhe do të mbeten të ndaluara në çdo kohë dhe vend kudo qoftë përsa i përket personave të sipërpërmendur:

(a) dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasjet e çdo lloji, gjymtimi, trajtimi çnjerëzor dhe torturimi;

(b) marrja e pengjeve;

(c) sjellje e dhunshme ndaj dinjitetit personal, në veçanti ndaj trajtimit poshtëruës dhe denigrues;

(d) shqiptimi i dënimeve dhe kryerja e ekzekutimeve pa aktgjykim paraprak të shpallur nga gjykatat me përbërje të rregullta, që jep të gjitha garancitë ligjore që janë të njohura si të pandashme nga popujt e civilizuar.

(2) Të plagosurit dhe të sëmurët do të mblidhen dhe për ta do të ketë përkujdesje.

Një organ i paanshëm humanitar, si Komisioni Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, mund të ofrojë shërbimet e tij ndaj palëve në konflikt.

Palët në konflikt duhet të bëjnë çmos që të sjellin në fuqi, me anë të mjeteve të veçanta apo marrëveshjeve të veçanta, të gjitha apo disa pjesë të dispozitave të tjera të Konventës aktuale.

Aplikimi i dispozitave paraprake nuk do të ketë ndikim në statusin ligjor të palëve në konflikt.

⁹ Neni 4 i Protokollit Shtesë II 1977 (trajtimi çnjerëzor) lexon:

17. Me qëllim që të përcaktohet nëse veprat penale të pretenduara përbëjnë Krime Luftë, trupi gjykues në fillim duhet të përcaktojë nëse, gjatë periudhës së caktuar në vitin 1999 situata në Kosovë ka arritur shkallën e një konflikti të armatosur. Vetëm ekzistenca e një konflikti të armatosur (përkundër trazirave të brendshme) do të çojë në aplikimin e Neneve 142 dhe 144 të

1. Të gjithë personat të cilët nuk marrin pjesë të drejtpërdrejte ose që kanë pushuar të marrin pjesë në luftime, pa marrë parasysh nëse liria e tyre është kufizuar apo jo, gëzojnë të drejtën e respektit ndaj tyre, nderimit dhe bindjes ndaj besimit të tyre fetar. Ata në të gjitha rrethanat do të trajtohen në mënyrë njerëzore pa dallime të kundërta. Është e ndaluar të urdhërohet që të mos ketë të mbijetuar.

2. Pa paragjykitje në përgjithësimet paraprake, aktet vijuese kundër personave të referuar në paragrafin I janë dhe do të mbeten të ndaluara në çdo kohë dhe vend:

(a) dhuna ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqenies fizike apo mendore të personave, veçanërisht vrasja si edhe trajtimi mizor i tillë si tortura, gjymtimi apo çdo formë e ndëshkimit trupor;

(b) ndëshkimet kolektive;

(c) marrja e pengjeve;

(d) aktet e terrorizmit ;

(e) sjellja mizore ndaj dinjitetit personal, veçanërisht trajtimit poshtërues dhe degradues, përdhunimit, prostitucionit të detyruar dhe çdo formë sulmesh seksuale;

(f) skllavëria dhe tregtia me skllavëri e të gjitha formave;

(g) plaçkitja ;

(h) kërcënimet për kryerjen e çdo akti paraprijës;

3. Fëmijëve do t'u kushtohet kujdesi dhe ndihma e nevojshme, dhe veçanërisht:

(a) atyre do t'ju ofrohet arsimit, duke përfshirë arsimin fetar dhe moral, në përputhje me dëshirat e prindërve të tyre, të atyre që janë përgjegjës për kujdesin ndaj tyre;

(b) do të ndërmerren të gjitha hapat e duhur për të lehtësuar bashkimin e familjeve të ndara përkohësisht;

(c) fëmijët që nuk e kanë arritur moshën 15 vjeçare as nuk do të rekrutohen në forcat apo grupet ushtarake dhe as nuk do të lejohen të marrin pjesë në luftime;

(d) mbrojtja e veçantë që siguron ky nen ndaj fëmijëve të cilët nuk e kanë arritur ende moshën 15 vjeçare do të mbetet e aplikueshme për ta nëse ata marrin pjesë të drejtpërdrejte në luftime pavarësisht dispozitave të paragrafit (c) dhe nëse ata zihen robër;

(e) masa do të ndërmerren, nëse konsiderohet e nevojshme, dhe kurdo që është e mundur me lejen e prindërve të tyre apo personave që me ligj apo zakon janë përgjegjës për kujdesin ndaj tyre, për t'i larguar fëmijët përkohësisht nga zonat e luftimeve në një zonë më të sigurt brenda shtetit të tyre dhe do të sigurohet që ata të jenë të shoqëruar nga personat që janë përgjegjës për sigurinë dhe mirëqenien e tyre. Neni 5(1) i Protokollit Shtesë II 1977 (Personat të cilëve u është kufizuar liria) lexon: në shtesë të dispozitave të nenit 4 dispozitat vijuese do të respektohen si minimumi lidhur me personat e privuar nga liria e tyre për arsytet që lidhen me konfliktin e armatosur pa marrë parasysh nëse janë të internuar ose të paraburgosur;

(a) të plagosurit dhe të sëmurët do të trajtohen në përputhje me Nenin 7;

(b) personave të cilëve iu bëhet referencë në këtë paragraf do t'ju, në të njëjtën mënyrë si popullatës vendore civile, ofrohet ushqim dhe ujë i pijshëm dhe do t'u jepen garanci lidhur me shëndetin dhe higjienën dhe mbrojtje kundër klimës së ashpër dhe rreziqeve të konfliktit të armatosur;

(c) ata do të lejohen të marrin ndihmë individuale dhe kolektive;

(d) ata do të lejohen të praktikojnë besimin e tyre dhe, nëse kërkohet dhe është e mundur, të marrin ndihmë shpirtërore nga personat, si kapelanët, që kryejnë funksionet e tyre fetare;

(e) ata do të, nëse detyrohen të punojnë, kenë përfitimin e kushteve të punës dhe garancive të ngjashme me ato që gëzon popullata civile vendore .

KPRSFJ-së. Me fjalë të tjera, në mënyrë që veprat penale të përbëjnë Krime Luftë, duhet të përcaktohet lidhja me konfliktin e armatosur.¹⁰

18. Sipas Konventave të Gjenevës, *konflikti i armatosur ndërkombëtar* është përkufizuar 'të gjitha rastet e shpalljes së luftës apo ndonjë konflikti tjetër të armatosur që mund të zhvillohet mes dy apo më shumë Palëve të Larta Kontraktuese, edhe nëse gjendja e luftës nuk njihet nga njëra palë'. 'Konflikti i armatosur' si i tillë nuk është përkufizuar në Konventat e Gjenevës.

19. Përkufizimi më gjerësisht i përdorur *i konfliktit të armatosur jo-ndërkombëtar* është përkufizimi vijues i formuluar nga Gjykata e Apelit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar të Hagës për ish-Jugosllavinë (TPNJ) në Tadic: 'Konflikti i armatosur ekziston kurdoherë që ka përdorim të forcës së armatosur ndërmjet Shteteve apo kur ka zgjatje të dhunës së armatosur mes autoriteteve qeveritare dhe grupeve të organizuara të armatosura brenda një Shteti. Ligji Ndërkombëtar Humanitar aplikohet që në fillim të konflikteve të tilla dhe zgjerohet përtej pushimit të luftimeve deri në arritjen e një përfundimi të përgjithshëm të paqes; ose, në rastin e konflikteve të brendshme, deri në arritjen e një zgjedhjeje paqësore. Deri në atë moment, ligji ndërkombëtar humanitar vazhdon të aplikohet në të gjithë territorin e Shteteve luftuese apo, në rastin e konflikteve të brendshme, në të gjithë territorin që gjendet nën kontrollin e një palë, pavarësisht nga fakti nëse atje zhvillohen luftime aktuale apo jo.'¹¹

20. Trazirat e brendshme dhe tensionet (si turbullirat, aktet e izoluara dhe sporadike të dhunës, apo akte të tjera të natyrës së ngjashme) nuk përbëjnë një konflikt të armatosur jo-ndërkombëtar.

¹⁰ Për diskutime dhe referenca të vendimeve precedente ligjore shih p.sh. Antonio Cassese, Ligji Penal Ndërkombëtar, Shtypi i Universitetit të Oksfordit 2008, fq.82 ff dhe Antonio Cassese, Guido Acquaviva, Mary De Ming Fan, Alex Whiting, Ligji Penal Ndërkombëtar: Lëndë dhe Komentar, Shtypi i Universitetit të Oksfordit 2011, fq.119 ff.

¹¹ Prokuroria v. Dushko Tadicit, Tribunali Ndërkombëtar Penal i Hagës për ish-Jugosllavinë (TPNJ), Vendimi i Gjykatës së Apelit mbi Mocionin e Mbrojtjes për Ankesën e Përkohshme mbi Juridiksionin , 02.10.1995, par.70.

21. Neni i përbashkët 3 i KGJ të vitit 1949 kërkon që konflikti i armatosur të mos ketë 'një karakter ndërkombëtar' dhe se ai duhet të zhvillohet 'brenda territorit të një Palë të Lartë Kontraktuese'.

22. Kufiri sipas Protokollit Shtesë II, nga ana tjetër, është më i qartë. Sipas Nenit 1.1, Protokollit aplikohet vetëm për konfliktet mes forcave të armatosura të një Pale të Lartë Kontraktuese 'dhe forcave të armatosura disidente apo grupeve të tjera të armatosura të organizuara të cilat, në bazë të përgjegjësisë komanduese ushtrojnë një kontroll të tillë mbi një pjesë të territorit që ju mundëson atyre kryerjen e operacioneve të koordinuara dhe të organizuara ushtarake'. Neni gjithashtu kërkon të njëjtën gjë ashtu si edhe Neni i përbashkët 3 i KGJ 1949, për faktin që konflikti të zhvillohet "brenda territorit të një Pale të Lartë Kontraktuese".¹²

23. Informacionet dhe provat në dispozicion lidhur me strukturën e UÇK-së dhe veprimtarinë në Kosovë në vitet 1998 dhe 1999, siç është konstatuar nga trupi gjyqësor i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ), duke filluar nga së paku mesi i vitit 1998, ilustron se UÇK-ja ishte një 'grup i armatosur i organizuar'. Ndërkohë që aspekte të ndryshme të organizimit dhe veprimtarive të UÇK-së u zhvilluan me hapa të ndryshëm në atë periudhë, ka pasur një progres gradual drejtë centralizimit të autoritetit dhe koordinimit të përpjekjeve kundër RSFJ-së/forcave serbe. Gjatë vitit 1998 UÇK-ja ka formuar stafin e përgjithshëm me shtatë qendra zonash operative nën të, ka përcaktuar rregullore që qeverisnin strukturën e trupave dhe disiplinën ushtarake, ka ndërmarrë sulme të koordinuara kundër forcave të RSFJ-së/serbe, ka përcaktuar një operacion financiar, ka kontrabanduar dhe/apo ka blerë stoqe të mëdha armësh, ka institucionalizuar përdorimin e emblemës dalluese të UÇK-së, dhe ka zbatuar praktikë strategjike në përputhje me qëllimet e saj të mëtejshme.¹³

¹² Manuali mbi Ligjin e Konfliktit të Armatosur Jo-ndërkombëtar me Komentare, Instituti Ndërkombëtar i Ligjit Humanitar, San Remo 2006, në dispozicion në: <http://www.dur.ac.uk/resources/law/NIACManualIYBHR15th.pdf> (qasja e fundit më 7 maj 2012).

¹³ Prokuroria v. Milan Milutinovic, Tribunali Ndërkombëtar Penal i Hagës për ish-Jugosllavinë (TPNJ), Aktgjykim 26.02.2009, par. 840.

24. Jurisprudenca e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) dhe Gjykatës Supreme të Kosovës kanë përcaktuar se ka pasur një konflikt të vazhdueshëm të armatosur në Kosovë të paktën që në fillim të pranverës së vitit 1998 e tutje mes forcave (qeveritare) të armatosura serbe dhe UÇK-së, që ka vazhduar deri në vitin 1999.¹⁴ Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) në çështjen *Milutinovic dhe Gjorgjevic* në mënyrë eksplicite ka treguar se konflikti i armatosur ka vazhduar deri në qershor të vitit 1999.¹⁵

25. Për sa i përket periudhës së mbuluar nga aktakuza në rastin aktual, ekzistenca e një konflikti të armatosur është përcaktuar gjithashtu edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës në çështjen e Vendimit të rastit Kolasinac më 5 gusht 2004 si edhe në Vendimin mbi çështjen e LG më 21 korrik 2005.

26. Duke patur parasysh jurisprudencën e përcaktuar ndërkombëtare dhe vendore për sa i përket ekzistencës së një konflikti të armatosur në Kosovë gjatë periudhës relevante kohore, trupi gjykues është i siguarar se ka ekzistuar një konflikt i brendshëm i armatosur brenda territorit të Kosovës në kohën në çështje . Më tej, trupi gjykues vë re se mbrojtja nuk ka ngritur kundërshtime për ekzistencën e konfliktit të armatosur apo rregullave të aplikueshme të pohuara nga Prokurori Special i EULEX-it në Aktakuzën e tij, duke pranuar në këtë mënyrë se në Kosovë ka pasur me të vërtetë një konflikt të armatosur gjatë tërë periudhës së sipërpërmendur.

27. Ndërkohë që cilësimi i konfliktit të armatosur si konflikt i brendshëm i armatosur përpara përfshirjes së NATO-s është përcaktuar më së miri, ngrihet pyetja nëse me fillimin e sulmeve ajrore të NATO-s në mars të vitit 1999 konflikti arriti nivelin e një konflikti të armatosur

¹⁴ Shih p.sh. Prokuroria v. Milan Milutinovic, Tribunali Ndërkombëtar Penal i Hagës për ish-Jugosllavinë (TPNJ), Aktgjykim 26.02.2009, par. 840-841; Prokuroria v. Vlastimir Gjorgjevic, Tribunali Ndërkombëtar Penal i Hagës për ish-Jugosllavinë (TPNJ), Aktgjykim 23.02.2011 par. 1579 ff; Prokuroria v. Fatmir Limaj, Haradin Bala, Isak Musliu, Tribunali Ndërkombëtar Penal i Hagës për ish-Jugosllavinë (TPNJ), Aktgjykim, 30.11.2005, par. 171 ff (Trupi Gjykues ka shqyrtuar një periudhë në vitin 1998, por gjithashtu ka vënë re se konflikti i armatosur ka vazhduar shumë më gjatë se korriku i vitit 1998); Prokuroria v. Ramush Haradinaj, Idriz Balaj, Lahi Brahimaj, Tribunali Ndërkombëtar Penal i Hagës për ish-Jugosllavinë (TPNJ), Aktgjykim, 03.04.2008, par. 100 (Gjykata e Apelit më 21 korrik 2012 ka urdhëruar një rigjykim të pjesshëm të çështjes që gjendet në zhvillim e sipër).

¹⁵ Shih referencat e bëra për rastet përkatëse ibid.

ndërkombëtar. Trupi gjykues i TPNJ-së në çështjen Gjorgjevic ka adresuar këtë çështje dhe është përgjigjur në mënyrë pozitive. Trupi gjykues i TPNJ-së ka arritur në përfundimin: 'Trupi gjykues është i siguar se nga fundi i muajit maj të vitit 1998 ka ekzistuar një konflikt i armatosur në Kosovë mes forcave serbe, në veçanti, të UJ dhe Policisë Serbe, dhe UÇK-së. Ky konflikt i armatosur ka vazhduar së paku deri në qershor të vitit 1999. Më 24 mars 1999, NATO-ja ka filluar operacionet e saj ushtarake në RFJ-së. Në po të njëjtën ditë qeveria e RFJ-së shpalli gjendjen e luftës. Mbi këtë bazë trupi gjykues pajtohet se që nga data 24 mars 1999, e deri në përfundim të luftimeve në qershor të vitit 1999, ka ekzistuar një konflikt i armatosur ndërkombëtar në Kosovë mes forcave serbe dhe forcave të NATO-s.'¹⁶

28. Për qëllimin e përcaktimit të ligjit të aplikueshëm në këtë rast, trupi gjykues, megjithatë, nuk ka nevojë të bëjë një përcaktim të natyrës së konfliktit të armatosur ekzistues. Edhe nëse konflikti i armatosur pas përfshirjes së NATO-s cilësohet si një konflikt i armatosur ndërkombëtar në mes të forcave Serbe dhe forcave të NATO-s, përmbajtja e detyrimeve të skalitura në Nenin 3 të Përbashkët të KGJ 1949 dhe PSHII 1977 do të vazhdojnë të aplikohen në konfliktin e brendshëm të armatosur në mes të forcave Serbe dhe UÇK -së. Vlefshmëria e Nenit 3 të Përbashkët, siç është theksuar në mënyrë vazhdueshme nga komentatorët, nuk kufizohet në konfliktin e brendshëm të armatosur. Ky i fundit përfaqëson *minimumin* që duhet të aplikohet në të paktën përcaktimin e konflikteve, prandaj kushtet e tij duhet të respektohen a *fortiori* në rastin e konflikteve tipike ndërkombëtare, kur aplikohen të gjitha dispozitat e Konventave të Gjenevës.¹⁷

¹⁶ Prokuroria v. Vlastimir Gjorgjevic, Tribunali Ndërkombëtar Penal i Hagës për ish-Jugosllavinë (TPNJ), Aktgjykim 23.02.2011 par. 1579, 1580 (ankesa në këtë çështje është ende në pritje të vendosjes përpara Gjykatës së Apelit).

¹⁷ Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC) Komentari i Nenit të Përbashkët 3, në dispozicion në: <http://www.icrc.org/ihl.nsf/COM/375-590006?OpenDocument> (qasja e fundit më 7 maj 2012).

B. Elementet e sjellës së ndaluar: vrasja, torturimi, trajtimi çnjerëzor

29. Aktakuza pretendon se të akuzuarit kanë kryer një të njëjtë apo më shumë nga veprat penale në vijim: tortura, trajtim çnjerëzor, vrasje. Siç u tha më sipër, në mënyrë që këto vepra të përbëjnë Krime Luftë sipas Neneve 142 dhe 144 të KPRSFJ-së duhet të ekzistojë një lidhje mes sjelljes kriminale dhe konfliktit të armatosur. Më tej, sjellja kriminale duhet të ketë qenë e drejtuar ndaj një personi të mbrojtur (civil apo rob lufte).

30. Është e nevojshme të përshkruhen shkurtimisht veçoritë kryesore ligjore të sjelljes së ndaluar siç pretendohet në Aktakuzë, domethënë aktet e torturës, trajtimit çnjerëzor, vrasjeve.

31. Ligji Ndërkombëtar bën dallim mes torturës dhe trajtimit çnjerëzor. Elementet *Actus reus* të të dyja veprave penale janë të njëjta dhe kërkojnë ekzistencën e vuajtjeve të mëdha. Tortura kërkon një element shtesë të qëllimit.

32. Neni 1.1 i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve të Tjera Mizore ose Degraduese apo Ndëshkimit 1980 (Konventa mbi Torturën) e përkufizon torturën si ‘çdo akt me anë të së cilit, shkaktohet qëllimisht dhimbje e madhe apo vuajtje, fizike apo mendore, ndaj ndonjë personi për qëllime të tilla si marrja prej atij personi apo personit të tretë i informacioneve apo rrëfimeve, duke e ndëshkuar atë për një akt që ai apo një personi i tretë ka kryer ose që dyshohet se ka kryer, apo duke e frikësuar dhe duke e detyruar atë apo personin e tretë, apo për çdo arsye që bazohet mbi çdo lloj diskriminimi, kur një dhimbje apo vuajtje e tillë shkaktohet nga apo me nxitjen ose me lejen apo pranimin e një zyrtari publik apo ndonjë personi tjetër që vepron në kapacitetin zyrtar. Kjo nuk përfshin dhimbjen apo vuajtjen që pason vetëm nga, të metat e bashkëlindura apo rastësitë ndaj sanksioneve të ligjshme”.

33. TPNJ ka konstatuar se ka tendenca të konsiderojë përkufizimin e përfshirë në Konventën mbi Torturën si 'përfaqësues i ligjit zakonor ndërkombëtar'.¹⁸ Në *Kunarac*, TPNJ ka renditur kriteret e mëposhtme themelore për veprën penale të torturës:

- (1) Shkaktimi, me akt apo mosveprim, të dhimbjes apo vuajtjes së madhe, si fizike apo mendore;
- (2) Akti apo mosveprimi duhet të jetë i qëllimshëm; dhe
- (3) Akti duhet të jetë kryer me qëllimin e marrjes së informacioneve apo të pohimit, duke ndëshkuar, frikësuar apo detyruar viktimën apo personin e tretë, apo duke diskriminuar, mbi çdo bazë, ndaj viktimës apo personit të tretë.¹⁹

34. 'Trajtimi çnjerëzor' është i përkufizuar në Elementet e Veprave Penale për Gjykatën Ndërkombëtare Penale (GJNP) si shkaktimi i 'dhimbjes apo vuajtjes së madhe fizike apo mendore'.²⁰ Siç është përmendur më sipër, elementi që e dallon trajtimin çnjerëzor nga tortura është mungesa e kushtit që trajtimi të shkaktohet për një qëllim të caktuar.²¹

35. Organet për të drejtat e njeriut gjithashtu aplikojnë një përkufizim që është i ngjashëm me përkufizimin e adoptuar nga GJNP, dhe duke theksuar nivelin e rëndë të dhimbjes apo vuajtjes fizike apo mendore. 'Ata kanë gjetur shkelje në ndalimin e trajtimit çnjerëzor në rastet e keqtrajtimit aktiv por gjithashtu edhe në rastet e kushteve mjaft të mjera të paraburgimit, ashtu si edhe në rastet e paraburgimit në vetmi. Mungesa e ushqimit adekuat, ujit apo trajtimit

¹⁸ Prokuroria v. Anto Furundžija, Tribunali Ndërkombëtar Penal i Hagës për ish-Jugosllavinë (TPNJ), Aktgjykim, 10.12.1998, par. 160-161.

¹⁹ Prokuroria v. Dragoljub Kunarac, Radomir Kovac, Zoran Vukovic, TPNJ, Aktgjykim i ankimuar, 12.06.2002, paras.142, 144.

²⁰ Gjykata Ndërkombëtare Penale, Elementet e veprave penale (Procesverbal zyrtar i Asamblesë së Palëve Shteteve të Statutit të Romës të Gjykatës Ndërkombëtare Penale, Seanca e parë, Nju Jork, 3-10 shtator 2002 dhe Procesverbalet Zyrtare të Konferencës Rishqyrtuese të Statutit të Romës të Gjykatës Ndërkombëtare Penale Kampala, 31 maj - 11 qershor 2010), në dispozicion në: <http://www.icj-cpi.int/NR/rdonlyres/336923D8-A6AD-40EC-AD7B-45BF9DE73D56/0/ElementesOfCrimesEng.pdf> (qasja e fundit më 8 maj 2012).

²¹ Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC) Studim mbi Ligjin Ndërkombëtar Zakonor Humanitar 2005 (dhe e azhornuar), Rregulli 90, Databaza e Ligjit Ndërkombëtar Zakonor Humanitar, në dispozicion në: http://www.icrc.org/customary-ihl/eng/docs/v1_cha_chapter32_rule90 (qasja e fundit më 8 maj 2012).

mjekësor për personat e paraburgosur gjithashtu është konsideruar se përbën trajtim çnjerëzor.²²

36. Akti i vrasjes i referohet privimit të jetës së një personi tjetër, një përkufizim i drejtpërdrejtë, po ashtu i përfshirë në KPRSFJ-në dhe në Nenin aktual 146 të KPK-së.

37. *Mens rea* i veprës penale në disa raste është specifikuar me anë të një rregulli të caktuar ndërkombëtar në mënyrë eksplicite apo implicite, si në rastin e torturës (qëllimi). Në raste të tjera, është propozuar që ajo që kërkohet është elementi subjektiv i përshkruar për veprën penale themelore.²³

IV. REFLEKTIME LIDHUR ME VLERËSIMIN E PROVAVE

A. Dëshmia e Dëshmitarit Bashkëpunues

38. Në çështjen aktuale, trupi gjykues është përballur me një grup rrethanash të pazakonshme. Aktakuza në mënyrë shprehimore deklaroi se 'në rastin na fjalë, dyshimi i bazuar mirë kundër të gjithë të pandehurve ngrihet kryesisht nga deklaratimet e Dëshmitarit Bashkëpunues X, ish-i dyshuar brenda të njëjtit hetim'. Në seancën e datës 30 janar 2012, Prokurori Special i EULEX-it, lidhur me kontekstin e dëshmisë së Dëshmitarit Bashkëpunues X, deklaroi: 'Çështja e pranueshmërisë është parësore lidhur me të, përndryshe nuk ka gjykim.'²⁴ Duke pasur parasysh këto pohime të Prokurorit, trupi gjykues përmend Nenin 157(4) të KPPK, i cili vendos kufizime lidhur me masën mbi të cilën mund të mbështetemi në dëshminë e dëshmitarit bashkëpunues, në atë që 'gjykata nuk do të shpallë asnjë person fajtor duke u bazuar vetëm në provën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues'.

²² Ibid.

²³ Antonio Cassese, Ligji Ndërkombëtar Penal, Shtypi i Universitetit të Oksfordit 2008, fq.93.

²⁴ Procesverbali i datës 30.01.2012, paragr.76, 101, 103, 105, Dosja e gjykimit të Gjykatës 6.

39. Dëshmitari Bashkëpunues X (AZ)²⁵ ka pasur statuse të ndryshme në këtë çështje, të tilla si, dëshmitar, i pandehur, dhe së fundmi, si dëshmitar bashkëpunues. Ai bëri vetëvrasje më 28 shtator 2011 dhe nuk mund të ishte i pranishëm për gjykimin kryesor. AZ ka qenë anëtar i UÇK-së dhe iu bashkua rreth prillit të vitit 1998 (me nofkën 'MZ'). Ai u caktua në Brigadën e 121 të UÇK-së. Në deklaratatë të ndryshme dhënë tek Prokurori Special i EULEX-it dhe në polici, AZ ka dhënë një version të ngjarjeve në Kleçkë, në të cilat ai kishte qenë dëshmitar dhe në të cilat kishte marrë pjesë. Gjatë gjithë periudhës së shërbimit të tij në UÇK, AZ deklaroi se kishte mbajtur një ditar. Shënimet në atë ditar thuhet se janë bërë kryesisht në të njëjtën kohë me ngjarjet e përshkruara nga vetë AZ. AZ deklaroi se ai i kishte ruajtur ditarët e tij që nga përfundimi i konfliktit, derisa ia dorëzoi ato policisë.

40. Mbrojtja e sfidoi pranueshmërinë e deklaratave dhe ditarëve të AZ. Trupi gjykues, pas dëgjimit të argumenteve nga palët, e ka shqyrtuar me hollësi pranueshmërinë e provave të AZ. Analizat e vlerësuara, *inter alia*, nëse mbrojtjes i ishte dhënë mundësia për të sfiduar akuzat e AZ, dhe nëse ajo mundësi kishte qenë 'adekuate dhe e përshtatshme', në përputhje me Nenin 156(2) të KPPK-së dhe sipas dispozitave përkatëse të Nenit 6(3)(d) të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (ECHR). Trupi gjykues, me anë të një aktvendimi të datës 21 mars 2012, i ka deklaruar dëshmitë e AZ, të papranueshme. Aktvendimi i datës 21 mars 2012 tregon në detaje bazat për përjashtimin e dëshmimeve të AZ.²⁶

B. Barra e provës

²⁵ Urdhri i trupit gjykues mbi dorëzimin e provave, 20.01.2012, Dosja e gjykimin të Gjykatës 5. Urdhri revokonte statusin e mbrojtur të AZ. Urdhri *inter alia* deklaronte që identiteti i Dëshmitarit Bashkëpunues X ishte bërë gjerësisht i njohur, si pasojë e vdekjes së tij, si edhe nga raportimet e shtypit mbi ditarët e tij dhe dokumenteve të tjera.

²⁶ Aktvendimi i trupit gjykues mbi Pranueshmërinë e Deklaratave dhe Ditarëve të AZ, 21.03.2012, Dosja e gjykimin të Gjykatës 8. Aktvendimi përbën pjesë të procesverbalit të seancës së datës 21.03.2012.

41. Në aktgjykimin aktual, trupi gjykues do të vendosë nëse provat e dorëzuara nga prokuroria vërtetojnë fajësinë e secilit nga të katër të akuzuarit, për sa i përket secilës akuzë për të cilën akuzohen të akuzuarit sipas aktakuzës, p.sh. gjashtë akuza kundër NK, shtatë akuza kundër NXX, tri akuza kundër FL dhe gjashtë akuza kundër NS.

42. Trupi gjykues i referohet Nenit 6(2) të KEDNJ-së, i cili mbron presupozimin e pafajësisë të cilën e gëzojnë të akuzuarit. Presupozimi i pafajësisë është përcaktuar, po ashtu, edhe në Nenin 3(1) të KPPK-së. Ky presupozim vendos mbi prokurorin barrën e vërtetimit të fajësisë së të akuzuarit, një barrë e cila mbetet mbi prokurorinë gjatë gjithë gjyqimit.

43. Në aktakuzën e prokurorisë propozohen 30 dëshmitarë, përveç Dëshmitarit Bashkëpunues, që do të dëgjohen në gjykimin kryesor. Pas përjashtimit të dëshmimeve të AZ nga dosja e lëndës, prokuroria e pa të panevojshme thirrjen e ndonjë dëshmitari dhe ishte e gatshme të procedonte me përfundimin e gjyqimit kryesor. Pas marrëveshjes nga palët, provat e shkruara të dorëzuara nga Prokurori Special i EULEX-it u lexuan në procesverbal.²⁷ Pas marrëveshjes nga palët, të gjitha deklaratat e dëshmitarëve²⁸ u konsideruan të lexuara. Në paraqitjen e provave, Prokurori iu referua listës që e kishte dorëzuar më parë në gjykatë.²⁹ Ajo listë specifikonte dokumentet mbi të cilat synonte të mbështetej prokuroria, si edhe ato prova mbi të cilat ajo nuk synonte të mbështetej. Në seancën e gjyqimit kryesor të datës 30 mars 2012, prokurori nuk specifikoi nëse vlerësimi fillestar i prokurorisë ishte i efektshëm. Duke pasur parasysh se të gjitha ato dokumente u dorëzuan në gjykatë në mbështetje të aktakuzës, trupi gjykues i mori plotësisht parasysh listën e prokurorisë dhe provat. Provat e dorëzuara nga prokurori janë listuar në **SHTOJCËN I**, e cila përbën një pjesë integrale të aktgjyqimit.

²⁷ Procesverballi i datës 21.03.2012, Dosja e gjyqimit të Gjykatës 8.

²⁸ Gjatë gjyqimit kryesor mbrojtja debatoi se prokuroria nuk e gëzonte të drejtën të kryente marrje në pyetje me dëshmitarët pas konfirmimit të aktakuzës dhe kërkoi që deklaratat e dëshmitarëve të tillë të shpallehin të papranueshme. Trupi gjykues me anë të Aktvendimit të datës 20.01.2012, e refuzoi kërkesën e mbrojtjes, si të pabazuar dhe vendosi që deklaratat e dëshmitarëve do të qëndrojnë në dosje: Aktvendimi mbi Kërkesën e Mbrojtjes për të Përjashtuar Deklaratat e Dëshmitarëve të marra nga prokurori pas Konfirmimit të Aktakuzës, 20.01.2012, Dosja e gjyqimit të Gjykatës 6.

²⁹ Lista e PSRK-së, dokumente mbi të cilat synon të mbështetet prokurori dhe dokumente mbi të cilat nuk synon të mbështetet prokurori, dosja e gjyqimit të Gjykatës 4.

44. Provat e paraqitura nga mbrojtja dhe të pranuar nga trupi gjykues gjatë gjykimit kryesor janë listuar në **SHTOJCËN II** e cila përbën një pjesë integrale të aktgjykimit.³⁰

45. Si rezultat, nuk janë dëgjuar dëshmitarë *viva voce* nga trupi gjykues. Trupi gjykues vë re se një drejtim i tillë në paraqitjen e çështjes nga prokuroria u adoptua nga Prokurori Special i EULEX-it, menjëherë pas vendimit të trupit gjykues për të përjashtuar dëshmitë e AZ. Si e tillë, u krijua përshtypja se prokurori në fakt u tërhoq nga ndjekja e mëtejshme penale, në shkallën e parë, me qëllim që të avancohet me shpejtësi me përfundimin e gjykimit kryesor. Kjo mund të bëhej fare mirë për të ushtruar të drejtën e ankesës së prokurorisë, veçanërisht, duke e sjellë çështjen e pranueshmërisë së AZ përpara Gjykatës Supreme. KPPK-ja përcakton rolin e prokurorisë dhe të trupit gjykues. Trupi gjykues ndërsa ka detyrën të ‘... përcaktojë me vërtetësi dhe në mënyrë të plotë faktet që janë të rëndësishme për arritjen e një vendimi të ligjshëm’ (Neni 7(1), (2) KPPK-së), mund të mos përfshihet për të zëvendësuar prokurorinë në procedurë, gjë që do shkaktoje tejkalimin e rolit të gjykatës. Pavarësia dhe paanshmëria e gjykatës është një element qenësor i konceptit të një gjykimi të drejtë.

46. Për më tepër, trupi gjykues i referohet Nenit 379 të KPPK-së. Ky nen përcakton që ‘në fjalën e tij apo të saj përfundimtare prokurori do të paraqesë vlerësimin e tij apo të saj të provave të marra gjatë gjykimit kryesor, do të shpjegojë përfundimet e tij apo të saj lidhur me faktet që janë të rëndësishme për vendimin, dhe do të paraqesë dhe justifikojë propozimin e tij apo të saj lidhur me përgjegjësinë penale të të akuzuarit ...’. Me lejen e të gjithë të akuzuarve, avokatët e tyre mbrojtës dhe prokuroria, palët u udhëzuan të paraqesin fjalët e tyre përfundimtare me shkrim.³¹ Trupi gjykues vërtetoi se palët e kishin përdorur me vend të drejtën

³⁰ Lista e provave të dorëzuara nga mbrojtja nuk përmban pjesët e aluduara të ditarit të AZ. Në veçanti, Prova e Mbrojtjes, D (FL) 1, 2, 2a, që aludohet të jenë pjesë të Ditarit të AZ, që gjendet në provat e mbrojtjes në dosjen I dhe Prova e Mbrojtjes D (FL) 5c, që aludohet të jetë ditari i AZ, që gjendet në provat e mbrojtjes në dosjen I. Provat në fjalë janë përjashtuar nga lista, duke pasur parasysh Aktvendimin e trupit gjykues, të datës 21.03.2012, që i deklaroi provat e AZ të papranueshme.

³¹ Procesverbal i datës 21.03.2012, paragr.42-48, 51-55, Dosja e gjykimit të Gjykatës 8.

për të dhënë fjalët përfundimtare.³² Prokurori Special i EULEX-it, në fjalën e tij përfundimtare propozoi që trupi gjykues që t'i shpallë '... të gjithë të akuzuarit fajtorë për veprat penale të akuzuar sipas aktakuzës dhe t'i dënojë ata sipas ligjit'.³³ Si justifikim për këtë Prokurori Special i EULEX-it theksoi se 'prokurori beson që këto prova' (p.sh. provat e zhvarrimit nga varri KER01, ku u gjetën pesë trupa), 'të kombinuara me të gjitha provat e tjera të lexuara në procesverbalin e seancës së datës 22³⁴ mars 2012, mjaftojnë për të provuar përgjegjësinë penale të të gjithë të akuzuarve'. Nuk u dha asnjë justifikim tjetër nga Prokurori Special i EULEX-it për propozimin e tij për t'i shpallur fajtorë të gjithë të akuzuarit për akuzat kundër tyre.

47. Në këtë aspekt, trupi gjykues rikujton detyrimin që ka prokurori, sipas Nenit 379 të KPPK-së, sipas të cilit prokurori duhet të justifikojë propozimin e tij. Në mënyrë që justifikimi të ketë kuptim duhet bërë mbi detaje të mjaftueshme se mbi cilën ose cilat prova të veçanta mbështetet prokurori, sa nga këto prova lidhen me propozimin e fajësisë për secilin të akuzuar, për secilën akuzë. Vetëm një justifikim i tillë përmbush qëllimin dhe funksionin e Nenit 379 të KPPK-së. Justifikimi që dha prokurori special i EULEX-it në fjalën e tij përfundimtare ishte i përgjithshëm, pa ndonjë specifikim, dhe në këtë mënyrë ai dështoi në përmbushjen e kërkesave të Nenit 379 të KPPK-së.

48. Si e tillë, trupi gjykues ishte vënë në një situatë të vështirë. Siç u përmend më herët, trupi gjykues është i obliguar sipas Nenit 7(1) të '...përcaktojë në mënyrë të vërtetë dhe të plotë faktet që janë të rëndësishme për arritjen e një vendimi të ligjshëm'. Prandaj, trupi gjykues, pavarësisht dështimit të prokurorisë për të justifikuar përgjegjësinë e propozuar kriminale të akuzuarve, ndërmori shqyrtimin në detaje të dëshmive të deponuara në gjykatë. Si rezultat i këtij shqyrtimi, trupi gjykues e pa të domosdoshme dhe të justifikuar ri-hapjen e procedurës kundër të akuzuarve NK, NXX, FL dhe NS, në pajtim me Nenin 385(1) të KPPK-së.³⁵ Megjithatë, në përgjigje ndaj vendimit të trupit gjykues, Prokuroria ritheksoi qëndrimin e vet të mëhershëm

³² Procesverbali i datës 30.03.2012, paragr.6-9, Dosja e gjykimit të Gjykatës 9.

³³ Fjala përfundimtare me shkrim e prokurorisë, 22.03.2012, Dosja e gjykimit të Gjykatës 8.

³⁴ Prokuroria duhet të ketë synuar t'i referohet datës 21 mars 2012, kur është mbajtur edhe seanca; nuk ka pasur seancë më datën 22 mars 2012.

³⁵ Procesverbali datës 30.03.2012, para. 9, Dosja e gjykimit kryesor 9.

se '...dëshmitë e përfshira në dosje të lëndës janë më së të mjaftueshme për t'ia lejuar trupit gjykues të marrë një vendim të bazuar dhe të drejtë për sa i përket përgjegjësisë penale të akuzuarve' dhe se 'prokurori nuk do të paraqesë dëshmi tjera, apo të kërkojë të mblidhen dëshmi tjera gjatë shqyrtimit kryesor'. 'Prandaj, prokurori shtynë trupin gjykues të merr vendim bazuar në provat e disponueshme'.³⁶

49. Po të vazhdohej me thirrjen e dëshmitarëve ex officio, në rrethanat e lëndës aktuale, do të rezultonte në tejkalimin e kompetencave të trupit gjykues dhe vendosjen në rolin e Palës në procedurë. Në këtë situatë, trupit gjykues i mbeten dëshmitë me shkrim të deponuara në gjykatë, dhe argumenti i prokurorisë i paraqitur në aktakuzë. Për sa i përket dëshmive me shkrim, trupi gjykues vëren se deklaratat me shkrim të dëshmitarëve janë konsideruar si të lexuara bazuar në marrëveshjen e Palëve. Për më tepër, mbrojtja nuk është shërbyer me të drejtën për të kërkuar të thirren dëshmitarë në shqyrtimin kryesor. Kjo pozitë është mbajtur nga mbrojtja po ashtu edhe kur trupi gjykues shpalli ri-hapjen e procedurës.³⁷

C. Vlerësimi i provave

50. Lidhur me çdo akuzë kundër secilit të akuzuar në aktakuzë, standardi që duhet përmbushur për një dënim janë provat përtej dyshimit të arsyeshëm. Neni 396(7) i KPPK-së thekson që 'gjykata do të deklarojë qartësisht dhe në mënyrë përfundimtare se cilat fakte i konsideron të provuara dhe cilat jo, ashtu si edhe bazat për këtë gjë'. Në bazë të kësaj, trupi gjykues duhet të përcaktojë lidhur me secilën pikë të akuzës ndaj secilit të akuzuar, nëse është i siguruar përtej dyshimit të arsyeshëm, mbi të gjitha provat, që çdo element i asaj vepre penale është vërtetuar. Trupi gjykues, sipas Neni 7(1), (2) të KPPK-së '... duhet në mënyrë të vërtetë

³⁶ Parashtrimi i PSRK-së, 04.04.2012, PPS nr.07/10, Dosja e gjykimit kryesor 9.

³⁷ Është konstatuar se mbrojtja e Fatmir Limajt në parashtresën e tyre të datës 27.03.2012 ka deklaruar: 'Mbrojtja nuk ka thirrur ndonjë dëshmitarë apo ballafaquar pjesën e mbetur të dëshmive të Prokurorisë në këtë lëndë. Kjo nuk është e nevojshme për shkak të rrethanave unike të lëndës aktuale.' Parashtresat përfundimtare të mbrojtjes në emër të FL, 27.03.2012, para. 16, Dosja e gjykimit kryesor 9.

Ky pozicion nuk është ndryshuar nga mbrojtja pas datës 30 mars 2012, kur trupi gjykues shpalli vendimin për ri-hapjen e procedurës kundër të akuzuarve NK, NXX, FL dhe NS.

dhe të plotë të përcaktojë faktet që janë të rëndësishme për arritjen e një vendimi të ligjshëm’ dhe ‘... ka për detyrë të shqyrtojë me kujdes dhe me devocion maksimal profesional të përcaktojë me vëmendje të barabartë faktet kundër të pandehurit si edhe ato në ... favor ...’.

51. Duke ndjekur drejtimin e adoptuar nga prokurori special i EULEX-it për të mos thirrur dëshmitarë për t’u marrë në pyetje në gjykatë, trupi gjykues në shqyrtimin e pretendimeve të aktakuzës mund të vlerësojë vetëm provat me shkrim të dorëzuara nga prokurori. Trupi gjykues vë re se në parim të gjitha provat duhet të paraqiten në praninë e të akuzuarit gjatë seancës së hapur për publikun sipas pikëpamjes së argumentit të kundërt. Vlerësimi vetëm i provave me shkrim, veçanërisht i deklaratave të dëshmitarëve, në mënyrë të natyrshme vendos kufizime mbi trupin gjykues. Meqë nuk janë dëgjuar dëshmitarët e prokurorisë dhe duke mos pasur mundësinë të vihet re sjellja e tyre, trupi gjykues mund të arrijë vetëm në disa përfundime të caktuara për sa i përket provave të provuara qartësisht, me kujdesin e veçantë që nëse deklaratat me shkrim të dëshmitarëve çojnë në provimin e sjelljes së të akuzuarve.

D. Provat e mbledhura gjatë bastisjes

52. Mbrojtja e NK, gjatë seancës së datës 14 nëntor 2011 argumentoi që bastisja e kryer në pronën e NK, në XX, XX ishte kryer pa autorizimin e duhur gjyqësor.³⁸ Në seancën e datës 1 dhjetor 2011, prokurori special i EULEX-it deklaroi se nuk ishte marrë ndonjë urdhër gjykate për bastisje dhe se bastisja ishte kryer duke u bazuar në Nenin 245 (1),(2) dhe Nenin 243 (2),(7) të KPPK-së.³⁹ Prokurori deklaroi që ai nuk synonte të mbështetej në provat e sekuestruara në bastisjen e pronës së NK, në XX, XX. Megjithatë, provat e dorëzuara në gjykatë nga prokuroria, përfshijnë gjithashtu materiale që e kishin origjinën në atë bastisje. Trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk mund të përcaktohet ekzistenca e asnjë nga rrethanat e Nenit 245 (1) të KPPK-së. Vihet re po ashtu nga trupi gjykues se lidhur me NXX, NS, RM, BL dhe SS, prokurori

³⁸ Procesverbali i datës 14.11.2011, paragr.148-152, Dosja e gjykimit të Gjykatës 4.

³⁹ Procesverbali i datës 01.12.2011, paragr.28, Dosja e gjykimit të Gjykatës 4.

special i EULEX-it aplikoi për urdhër për bastisje.⁴⁰ Si e tillë, mbetet e paqartë se përse prokurori nuk aplikoi për urdhër për bastisje në rastin e NK. Prokurori nuk tregoi se cilat rrethana të veçanta e bënë të nevojshme kryerjen e bastisjes pa urdhër gjykatë.

53. Prandaj, trupi gjykues mund të mos e konsiderojë të justifikuar bastisjen dhe materiali që e kanë origjinën nga ajo bastisje dhe që janë dorëzuar në gjykatë, janë shpallur të papranueshme dhe janë përjashtuar nga dosja, në bazë të Nenit 246 1) të KPPK-së. Provat e përjashtuara janë listuar në **SHTOJCËN III** të këtij aktgjykimi, që përbën një pjesë integrale të tij.

54. Mbrojtja e FL, gjatë seancës së datës 7 mars 2012 ka argumentuar se bastisja e kryer në rezidencën e FL, ishte kryer pa një autorizim të duhur gjyqësor.⁴¹ Prokuroria ka dorëzuar në gjykatë dosjen e PSRK – G, që përmbante materiale të marra gjatë bastisjes së ‘rezidencës së FL’. Ato prova paraqiten në mbështetje të aktakuzës. Trupi gjykues vë re se dosja e gjykatës nuk përmban urdhër për bastisje nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake në çështjen hetimore, GJPP 25/10 (PPS 07/10), e cila ka rezultuar me aktakuzën aktuale kundër të akuzuarit në këtë çështje. Mbrojtja e FL dorëzoi në gjykatë një urdhër për bastisje, të lëshuar nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake, në një çështje tjetër hetimore, GJPP 91/10 (PPS 425/09), për vepra penale që nuk kanë lidhje me këtë aktakuzë. Ai urdhër për bastisje u pranua si provë gjatë seancës së datës 7 mars 2012.⁴² Sipas urdhrit për bastisje të Gjyqtarit të Procedurës Paraprake, bastisja, sa për FL, ka qenë e autorizuar për tri adresa të ndryshme, duke përfshirë pronën në Rrugën “ZZ” dhe një pronë tjetër në XX, XX. Provat e dorëzuara nga prokuroria në dosjen G të PSRK, nuk përmbajnë një tregues për të identifikuar se cila prova ishin sekuestruar në secilën pronë, ajo thjeshtë i referohet ‘Rezidencës së FL’. Për më tepër, mbrojtja e FL dorëzoi në gjykatë listën e objekteve të sekuestruara nga Njësia e Hetimit të Krimeve të Rënda të EULEX-it, dhe duket se janë sekuestruar sende edhe nga adresa e katërt në LL.⁴³ Kjo adresë nuk përfshihet në urdhrin e Gjyqtarit të Procedurës Paraprake në hetimin tjetër.

⁴⁰ Aplikimi i PSRK për urdhrin për bastisje, 16.03.2011, PPS no.07/10, GJPP dosja 3.

⁴¹ Procesverbali i datës 07.03.2012, para. 46, 48, 68, Dosja e gjykimit të Gjykatës 8.

⁴² D(FL)4d, Gjykata e Qarkut të Prishtinës, urdhër për bastisje, 28.04.2010, GJPP 91/10 (PPS 425/09), Dosja e provave të mbrojtjes.

⁴³ D(FL)4b, Njësia e Krimeve të Rënda të EULEX-it, orari i pronave të bastisura, Dosja e provave të mbrojtjes.

55. Gjatë gjykimit Prokurori nuk i ka shpjeguar bazat mbi të cilat janë konfiskuar sendet për lëndën aktuale. As shkresat e lëndës e as materialet e paraqitura Gjykatës nga Prokurori nuk përmbanin urdhrin për bastisje të lëshuar në tjetër procedurë hetimore. Krejtësisht e kundërt, ishte mbrojtësi i cili e paraqiti kopjen e urdhrit për bastisje në hetimin tjetër GJPP 91/10 (PPS 425/09). Trupi gjykues ka vërejtur se në kohën kur është lëshuar urdhri për bastisje në hetimin tjetër me 28 prill 2010, Prokurori ishte tashmë në posedim të provave nga AZ që e fajsonin FL. Gjithashtu, aktvendimi për zgjerimin e hetimeve kundër FL nuk tregonin se hetimet janë zgjeruar për FL si rezultat i sendeve të konfiskuara gjatë bastisjes me 28 prill 2010. Për aplikimin e Nenit 244 KPPK-së, sendet duhet të janë të atilla që shpjen kah vepra tjetër penale dhe themelojnë bazat për fillimin e hetimeve. Prokurori nuk shpjegoi nëse ishte rasti i tillë. Aktvendimi për zgjerimin e hetimeve për FL nuk përmbante as atë identifikim. Prandaj, nga materialet dhënë Gjykatës, trupi gjykues nuk është në gjendje të verifikoj ekzistimin e rrethanave nga Neni 244 KPPK-së. Trupi gjykues thekson se prokurori, në listën e tij, të bashkëngjitur procesverbalit nga 01 dhjetori 2011 (dokumentet mbi të cilat Prokuroria mendon të mbështetet dhe dokumentet mbi të cilat Prokuroria nuk mendon të mbështetet, Regjistratori gjyqësor nr. 4), nuk shënoj ndonjë nga sendet e konfiskuara, të përmbajtura në regjistratorin G të PSRK-së, në vendbanimin FL, si prova mbi të cilat Prokurori mendon të mbështetet në pretendimet kundër të akuzuarit. Megjithatë, duke pas parasysh atë që u tha më lartë, trupi gjykues konstaton se në lëndën aktuale nuk ka pasur urdhër për bastisje të lëshuar nga Gjyqtari i procedurës paraprake për bastisjen e vendbanimit të FL. Dispozitat e KPPK-së janë strikte për sa i përket pasojave të bastisjes kur shkelet KPPK-ja. Neni 246 1), 6) i KPPK-së thekson se provat e marra pa një urdhër për bastisje në shkelje të dispozitave të Kodit dhe në shkelje të Nenit 245 (1), (3), (4) dhe (5) të Kodit do të jenë të papranueshme. Rrjedhimisht, provat që gjenden në dosjen G të PSRK-së e që janë listuar në **SHTOJCËN III** të këtij aktgjykimi shpallen si të papranueshme. SHTOJCA III përbën pjesë integrale të këtij aktgjykimi.

V. KONKLuzionet lidhur me akuzat

A. Përmbledhje

56. Deklaratat e dëshmitarëve që gjenden në prova përmbajnë dëshmi mbi vendet e pretenduara të UÇK-së për ndalim në vende tjera përveç Kleçkës, dhe të ngjarjeve që janë zhvilluar diku tjetër përveç Kleçkës. Disa prej versioneve zbuluan prova në ngjarje që mund të quhen vepra penale. Megjithatë, trupi gjykues i shqyrtoi deklaratat e dëshmitarëve vetëm lidhur me pretendimet e aktakuzës. Në disa raste, veçanërisht, kur i referohet deklaratave të dëshmitarit të mbrojtur, trupi gjykues, me sa ka pasur mundësi, është kufizuar në recitimin e detajeve të tregimit të tyre, që të ruajë anonimitetin e tyre ose nga të akuzuarit dhe mbrojtja, ose nga publiku i gjerë.

57. Duke pasur parasysh tërësinë e provave të dorëzuara nga prokuroria, trupi gjykues është bindur se një burg, i cili konsiderohet gjithashtu edhe si qendër paraburgimi, është mbikëqyrur nga UÇK-ja në fshatin Kleçkë në vitin 1999. Trupi gjykues nuk pati mundësi të arrinte në përfundimin që kushtet në qendrën e paraburgimit *per se* ishin të tilla që të përbënin trajtim mizor.⁴⁴

58. Nga personat e emëruar në aktakuzë, trupi gjykues konkludon që Dëshmitari Anonim H dhe vëllai i janë nënshtruar trajtimit mizor në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, ka të ngjarë në shkurt të vitit 1999, dhe SA diku në mars 1999 deri në prill 1999. Provat nuk kanë qenë të mjaftueshme që trupi gjykues të përcaktojë se veprat penale të tjera të pretenduara në

⁴⁴ Aktakuza e prokurorit special të EULEX-it i është referuar kushteve ‘çnjerëzore’ në qendrën e paraburgimit në fshatin Kleçkë. Në këtë aktgjykim trupi gjykues ka përdorur termat ‘trajtim çnjerëzor’ dhe ‘trajtim mizor’ në mënyrë të ngjashme. Në rastin Naletilic dhe Martinovic, trupi gjykues në Tribunalin Ndërkombëtar Penal të Hagës për ish-Jugosllavinë (TPNJ) konsideroi: ‘Jurisprudenca e Tribunalit tregon se veprat penale të trajtimit çnjerëzor dhe të trajtimit mizor janë klauzola të mbetura sipas Neneve 2 dhe 3 të Statutit, respektivisht. Materialisht, elementët e këtyre veprave penale janë të njëjta.’ Prokurori v. Mladen Naletilic dhe Vinko Martinovic, Tribunali Ndërkombëtar Penal i Hagës për ish-Jugosllavinë (TPNJ), Aktgjykimi, 31.03.2003, para. 246.

Në rastin Kordic dhe Cerkez, trupi gjykues i Tribunalit Ndërkombëtar Penal të Hagës për ish-Jugosllavinë (TPNJ) konfirmoi që ‘trajtimi mizor është i njëjtë me veprën penale të trajtimit çnjerëzor në kornizën e shkeljeve të rënda të dispozitave të Konventave të Gjenevës’. Prokurori v. Dario Kordic dhe Mario Cerkez, Tribunali Ndërkombëtar Penal i Hagës për ish-Jugosllavinë, Aktgjykimi, 26.02.2001, paragr.265. Shihni, po ashtu, edhe Prokurori v. Tihomir Baskic, Tribunali Ndërkombëtar i Hagës për ish-Jugosllavinë (TPNJ), Aktgjykimi, 03.03.2000, paragr.186.

aktakuzë janë kryer në qendrën e paraburgimit të UÇK-së në Kleçkë, ose pranë qendrës së paraburgimit në Kleçkë. Mbetjet e disa viktimave janë gjetur në fshatin Kleçkë dhe provat e mbështesin zhdukjen e tyre. Megjithatë, rrethanat e tjera të zhdukjes së tyre mbeten të paqarta.

B. Ekzistenca e një burgu të UÇK-së në fshatin Kleçkë

59. Aktet e akuzuara në aktakuzë pretendohet të kenë ndodhur në ose lidhur me një burg të UÇK-së, po ashtu të përshkruar edhe si një qendër paraburgimi, të ngritur në fshatin Kleçkë, ku civilët shqiptarë të dyshuar për bashkëpunim me regjimin, serb, civilët serbë dhe oficerët e policisë dhe ushtarakë serbë janë paraburgosur. Burgu në Kleçkë ka shërbyer po ashtu edhe si një qendër paraburgimi për ushtarët e UÇK-së të hetuar ose të dënuar për vepra disiplinore. Disa dëshmitarë deklaruan se ata nuk kishin dijeni për ekzistencën e një burgu në Kleçkë, dhe as që kanë parë ndonjë të burgosur atje⁴⁵ Prandaj, është e nevojshme, për trupin gjykues të përcaktojë nëse ka ekzistuar një burg i UÇK-së në Kleçkë dhe nëse individë janë paraburgosur atje në kohën materiale të kësaj aktakuze.

60. Ndërkohë që nuk është krejtësisht e qartë, provat tregojnë se në kohën materiale fshati i Kleçkës ka qenë nën zonën operative të Pashtrikut.⁴⁶ Komanda e Brigadës së 121të, të njohur gjithashtu edhe si Brigada e 'Kumanovës',⁴⁷ ndodhej në Kleçkë. BL (i akuzuar në aktgjykimin e parë në rastin Kleçka) deklaroi se ai ka qenë ushtar në Brigadën 121, që nga fillimi e deri në

⁴⁵ Dëshmitari E, 28.10.2010, procesverbal i ZPSRK-së, mbi dëgjimin e dëshmitarit në një hetim, fq. 3, 4; Dëshmitari G, 11.01.2011, deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, e Policisë së EULEX-it, fq. 3, 4, dosja e PSRK B; AQ, 07.06.2011, deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, e Policisë së EULEX-it, fq. 3, 5, dosja e PRSK-së C; IA, 07.04.2011, deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, e Policisë së EULEX-it, fq. 3, dosja e PSRK-së C; BZ, 05.04.2011, procesverbal i marrjes në pyetje të dëshmitari në një hetim, PSRK-së, fq. 4, dosja e PRSK-së C; DD, 04.04.2011, deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, Policia e EULEX-it, fq. 3, dosja e PSRK-së C; BK, 08.01.2011, deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, Policia e EULEX-it, fq. 4, dosja e PSRK-së C; AO, 30.11.2010, deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, e Policisë së EULEX-it, fq. 5, dosja e PSRK-së C.

⁴⁶ AQ, ibid, fq. 3.

⁴⁷ QK, 14.06.2011, deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, e Policisë së EULEX-it, fq. 3, dosja e PSRK-së C; IA, supra note 42, fq. 3; NH, 02.12.2010, deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, e Policisë së EULEX-it, fq. 3, dosja e PSRK-së C; Dëshmitari G, supra note 42, fq.3.

përfundim të konfliktit. Ai ka dëshmuar gjithashtu se komanda e Brigadës 121 ndodhej në Kleçkë.⁴⁸ Po ashtu, i akuzuari NS ka dëshmuar se komanda e Brigadës 121 ndodhej në Kleçkë.⁴⁹ SS (i akuzuar në aktgjykimin e parë në rastin Kleçka) konfirmoi se shtëpia e tij në Kleçkë është përdorur nga UÇK-ja në vitin 1998. Dikur në vitin 1998, Kleçka është djegur nga forcat serbe. Nga janari i vitit 1999 deri në qershor të vitit 1999, ai ishte caktuar në Brigadën 121 në Luzhnicë. Siç del edhe nga deklarata e SS, komandanti i Brigadës 121 në prill të vitit 1999 ishte i stacionuar në Kleçkë.⁵⁰ BS (i akuzuar në aktgjykimin e parë në rastin Kleçka) deklaroi se kishte qenë anëtar i Brigadës 121. Ai kishte qenë në Kleçkë dhe se shtabi i Brigadës 121 ndodhej në Kleçkë.⁵¹ Sipas AK (i akuzuar në aktgjykimin e parë në rastin Kleçka) në vitin 1999, derisa ai u lëndua më 18 prill 1999, ai shkoi në Kleçkë kur kërkohet nga shtabi ose komanda e Brigadës 121. Nga deklarata e të akuzuarit AK nuk del tërësisht qartë nëse shtabi i përgjithshëm i UÇK-së ishte, po ashtu, i stacionuar në Kleçkë apo nëse vetëm shtabi i Brigadës 121 ndodhej atje⁵². Disa dëshmitarë, Dëshmitari Anonim M⁵³, BAZ⁵⁴, ST⁵⁵, FK⁵⁶, AQ⁵⁷, AO⁵⁸, dëshmuan se ose shtabi i Brigadës 121 ose Brigada 121 kanë qenë të vendosura në Kleçkë. BEK dëshmoi se në vitin 1999 ai ka qenë në bazën e UÇK-së në Kleçkë⁵⁹. Ish-anëtari i UÇK-së, IZ deklaroi se ai nuk kishte qenë në Kleçkë, por kishte dëgjuar që një bazë e UÇK-së gjendej atje⁶⁰. BZ tregoi se ndonjëherë shtabi i Brigadës 121 lëvizte edhe në Berishë⁶¹.

⁴⁸ BL, 11.05.2011, procesverbal i marrjes në pyetje të dyshuarit në një hetim, ZPSRK, fq. 3 Dosja e PSRK-së O.

⁴⁹ NS, 11.05.2011, procesverbal i marrjes në pyetje të dyshuarit në një hetim, PSRK, faqe 3 Dosja e PSRK-së O.

⁵⁰ SS, 11.05.2011, procesverbal i marrjes në pyetje të të dyshuarit në një hetim, PSRK, fq. 3, 4, dosja e PSRK-së O.

⁵¹ BS, 12.05.2011, procesverbal i marrjes në pyetje të të dyshuarit në një hetim, ZPSRK, fq. 4, dosja e PSRK-së O.

⁵² AK, 14.04.2011 shënimet e dëgjimit gjatë paraburgimit dosja e shqyrtimit kryesor GJPP dosja 3

⁵³ Dëshmitari anonim M, 20.05.2011 shënimet e PSRK-së të marrjes në pyetje të dëshmitarit në hetuesi, fq. 3

⁵⁴ BAZ, 23.05.2011, Policia e EULEX-it deklarata e dëshmitarit, PSRK dosja D.

⁵⁵ ST, 25.05.2011, Policia e EULEX-it deklarata e dëshmitarit, PSRK dosja D

⁵⁶ FK, 31.05.2011 Policia e EULEX-it deklarata e dëshmitarit, PSRK dosja D

⁵⁷ AQ, Shënim supra 45, fq. 3

⁵⁸ AO, Shënim supra 45, fq. 3

⁵⁹ BEK, Shënim supra 45, fq. 3

⁶⁰ IZ, 19.05.2011 Policia e EULEX-it deklarata e dëshmitarit, PSRK dosja D

⁶¹ BZ, , Shënim supra 45, fq. 5

61. Disa dëshmitarë⁶², gjithashtu dhe të akuzuarit NXK, NS dhe FL⁶³ kanë treguar se shtabi i përgjithshëm i UÇK-së ndodhej në fshatin Divjakë. Sipas BZ, nga janari i vitit 1999 e deri në mes të prillit të vitit 1999, ai ka qenë shef i shtabit të përgjithshëm të UÇK-së. Shtabi ishte në fshatin Divjakë deri në prill të vitit 1999 dhe më pas lëvizi në Devetak, pranë Shtimjes. Dëshmitari A, përveç të tjerëve, ka qenë i stacionuar në shtabin e përgjithshëm të UÇK-së në Divjakë. Dëshmitari A ka qenë i ngarkuar për gjykatën ushtarake dhe është ndihmuar në punën e tij nga Dëshmitari E. Ndërkohë që BZ nuk e dinte a kishte ndonjë burg në Kleçkë, ai e dinte që ekzistonte një qendër disiplinore në fshatin Lladrovç. Qendra ishte nën përgjegjësinë e gjykatës ushtarake dhe policia ushtarake ruante burgun dhe të burgosurit.⁶⁴

62. Sipas deklaratës së të akuzuarit NK ka patur një burg në Kleçkë, i cili ka qenë nën juridiksionin e gjykatës ushtarake. NK, brenda kornizës së policisë ushtarake, është marrë me rastet e ushtarëve dhe nganjëherë anëtarëve të policisë ushtarake. NK ka punuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me kryetarin e gjykatës ushtarake, Dëshmitarin A. Nëse NK mendonte se ekziston dyshimi i bazuar për ndonjë person, ai e dërgonte atë person te Dëshmitari A, i cili më tutje konsideronte nëse ka arsye për paraburgim. NK ka shkuar nganjëherë në burg në Kleçkë për të çuar persona atje apo për të kryer ndonjë marrje në pyetje. Edhe pse NK nuk ka treguar për raste të posaçme, ai ka dëshmuar se ishte e mundur që civilët gjithashtu të dërgohen në burg.⁶⁵

63. Sipas NM, në fund të vitit 1998 ai ishte emëruar në shtabin e UÇK-së në Divjakë. Nga deklarata e NM del se BZ ka qenë shef i shtabit të përgjithshëm të UÇK-së. Po ashtu, edhe departamenti ligjor ishte stacionuar në Divjakë. Atij i kujtohej se Dëshmitari A dhe Dëshmitari E

⁶² Është vërejtur se shtabi i përgjithshëm i UÇK-së mund të përhapet gjithashtu edhe në vende të tjera. Dëshmitari W i ka përshkruar keqtrajtimet në një vend tjetër, ku ai ka thënë se ishin komandues të UÇK-së: dëshmitari E me 16.06.2011 në intervistën e bere nga Policia e EULEX-it ZPSRK dosja D. BZ dëshmoi se deri në prill të vitit 1999 shtabi i përgjithshëm ishte në Divjakë dhe pastaj ka lëvizur në Devetak afër Shtimjes; BZ Supra note 42 fq 2.

⁶³ NXK, 11.05.2011, procesverbal i dëgjimit të të dyshuarit në një hetim, PSRK, faqe 5, dosja e PSRK O; NS supra note 45, faqe 2, 3.

⁶⁴ BZ, supra note 42, fq 2,3

⁶⁵ NK, supra note 46, pp.6, 7, 8, Dosja O e PSRK.

punonin atje.⁶⁶ AH, që u bashkua me policinë ushtarake të UÇK-së, në fund të dhjetorit të vitit 1998 apo në fillim të janarit të vitit 1999, kujton se A-ja kishte qenë gjyqtar në gjykatën ushtarake, dhe në një rast, ai kishte shoqëruar një ushtar të arrestuar tek A-ja.⁶⁷ Po ashtu, SB e njihte A-në si gjyqtar, që i kishte dhënë atij formularë apo forma në një mbledhje që ishte zhvilluar ose në Kleçkë ose në Divjakë.⁶⁸

64. Kjo konfirmohet nga Dëshmitari A i cili deklaroi se në fund të vitit 1998, ai mori detyrën e drejtorit në departamentin ligjor të UÇK-së, në fshatin Divjakë. Ai shërbeu si i vetmi gjyqtar në zonën e Divjakës, deri në prill të vitit 1999. Aty zhvilloheshin gjyqet ushtarake, po ashtu, edhe me pjesëmarrjen e prokurorit ushtarak, Haki Kryeziu, dhe të një avokati mbrojtës *ex officio*, Dëshmitarin E.⁶⁹ Deklarata e Dëshmitarit E konfirmon se ai kishte qëndruar me A-në në Divjakë, pranë Kleçkës, për një periudhë të caktuar kohore. Ai e ndihmonte A-në në hartimin e dokumenteve ligjore, dhe siç u zhvillua nga praktika, vepronte në mbrojtje të ushtarëve të akuzuar të UÇK-së.⁷⁰ Deklarata e Haki Kryeziut konfirmon se ai ka qëndruar me A-në nga dhjetori i vitit 1998 deri në mars/prill të vitit 1999, në Divjakë, pranë Kleçkës, por ata nuk bënë ndonjë punë.⁷¹ Nga deklarata e HK del se afër Kleçkës ka pasur një burg, ku ai kishte parë persona të paraburgosur.⁷²

65. Më tej edhe dëshmitari A deklaroi se ai ka vizituar shpesh burgun e Kleçkës, në dalje të Divjakës. Sipas A, nuk kishte shumë të burgosur në burgun e Kleçkës. Kishte burgje të improvizuara edhe në zona të tjera të zonës operative të Pashtrikut, Lladrocit dhe Kervasarit.⁷³ Në veçanti, A-së iu kujtua rasti i BKU, komandant i brigadës, i cili ishte dënuar me vdekje si

⁶⁶ NM, 05.04.2011 shënimet e PSRK në marrjen në pyetje gjatë hetimit, PSRK dosja C.

⁶⁷ AH 27.05.2011 shënimet e PSRK në marrjen në pyetje gjatë hetimit, PSRK dosja D.

⁶⁸ SB, 27.05.2011 shënimet e PSRK në marrjen në pyetje gjatë hetimit, PSRK dosja D.

⁶⁹ Dëshmitari A, 23.09.2010 shënimet e PSRK në marrjen në pyetje gjatë hetimit, PSRK dosja B.

⁷⁰ Dëshmitari E, supra note 42.

⁷¹ HK. 20.10.2010, shënimet e PSRK të dëshmisë në hetuesi. PSRK dosja C.

⁷² Ibid.

⁷³ Dëshmitari A, supra note 69, fq.3, 4.

dezertues. BKU u dërgua në burgun e Kleçkës në pritje të zbatimit të vendimit.⁷⁴ Gjithashtu, dëshmitarë të tjerë, HK,⁷⁵ dëshmitari E⁷⁶ dinin, në shkallë të ndryshme, për rastin e BKU. Ndërsa BZ dinte rastin e BKU, me sa dinte ai, BKU ishte mbajtur i ndaluar në Lladroc.⁷⁷ BKU pohoi se ai ka qenë komandant i brigadës 123 dhe më vonë me datë 15 apo 16 janar 1999 është arrestuar dhe mbajtur i ndaluar deri me datë 23 mars 1999. Megjithatë BKU refuzoi të specifikonte vendin ku ishte mbajtur i ndaluar.⁷⁸ Lidhur me këtë, trupi gjykues konstaton se dëshmitari V dëshmoi se ai kishte qenë ushtar i UÇK-së dhe më vonë ishte akuzuar si spiun dhe në një moment të caktuar ishte dërguar në burgun e Kleçkës. V ka parë aty të burgosurin BKU bashkë me të burgosur të tjerë.⁷⁹

66. Përveç dëshmitarit V edhe dëshmitari F dëshmoi se në mars 1999 ai ishte arrestuar nga UÇK-ja dhe ishte dërguar në një shtëpi në Kleçkë dhe mbajtur në një dhomë e cila dukej si bodrum bashkë me pesë apo gjashtë të burgosur të tjerë. Dëshmitari F është ndaluar për shkak fjalëve se ai ishte kundër UÇK-së. Ai është marrë në pyetje dhe më vonë liruar në shtëpinë në Kleçkë.⁸⁰ Dëshmitari anonim B deklaroi se në fund të prillit apo fillim të majit 1999 ai ka qenë roje fshati dhe forcat serbe e kanë kapur atë në befasi dhe ai ka ikur në malet në afërsi të fshatit. Pas disa ditësh B është arrestuar nga patrulla këmbësore serbe, i kanë lidhur sytë dhe është dërguar në një shtëpi ku është marrë në pyetje dhe goditur me sende të forta në gjithë trupin dhe është pyetur lidhur me UÇK-në. Dëshmitari anonim B ishte i detyruar tu thoshte atyre çfarë dinte. Rreth tre ditë më vonë B u lirua dhe pas disa ditësh ka shkuar në Kleçkë për ndihmë. B-së i është thënë të paraqitet në shtab në Kleçkë. Në Kleçkë, në një shtëpi dy katëshe, B është vendosur në njërin nga dy dhomat në bodrum. Pas pesë apo gjashtë ditësh B është dërguar sipër dhe është marrë në pyetje. B ka shpjeguar çfarë kishte ndodhur dhe çfarë kishte thënë forcave serbe. Pas disa ditësh B-së i është dhënë një vendim gjykate i cili caktonte ndaj B

⁷⁴ Ibid, pp.1, 5, 6.

⁷⁵ HK, supra note 71.

⁷⁶ Dëshmitari E, supra note 45, fq.4, 5.

⁷⁷ BZ, supra note 45, fq.4.

⁷⁸ BKU, 04.10.2010, Procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit në PSRK gjatë hetimit, p.2, dosja e PSRK-së B.

⁷⁹ Dëshmitari V, 18.04.2011, intervistë përpara Zëvendës Prokurorit Federal në Zvicër, PSRK dosja C.

⁸⁰ Dëshmitari F, 02.01.2011, Deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit nga policia e EULEX-it, p.3, Dosja B.

tridhjetë ditë ndalim.⁸¹ Në intervistën para Prokurorit Special të EULEX-it B-së i është treguar një dokument i datës 17 maj 1999 “vendim për ndalim” lëshuar nga gjykata ushtarake e UÇK-së. Vendimi mban emrin e gjyqtarit hetues PU.⁸² Lidhur me këtë trupi gjykues konstaton se dëshmitari A ka deklaruar se emri ‘PU’ ishte përdorur nga A në vend të emrit të tij të vërtetë si mburojë ndaj çdo hakmarrje të mundshme nga i akuzuari. Dëshmitari A pohoi gjithashtu se vendimi në fjalë i gjykatës ushtarake të UÇK-së mbante nënshkrimin e tij.⁸³

67. Dëshmitari C deklaroi se në mars të vitit 1999, atij i kanë thënë në shtab të UÇK-së në Llapushnik se djali i tij mbahej i ndaluar në Kleçkë. C shkoi në këmbë në Kleçkë dhe prej aty u dërgua me makinë në fshatin Terpeze ku u mbajt i ndaluar. Pas gjashtë ditësh C u dërgua përsëri në Kleçkë ku u vendos në bodrum. C qëndroi rreth shtatë ditë aty dhe më në fund u lirua me datë 03 prill 1999.⁸⁴ Gjithashtu, dëshmitari M deklaroi se ai ishte arrestuar në mars apo prill të vitit 1999 dhe dërguar në Kleçkë. Aty, M është marrë në pyetje nga pjesëtarë të UÇK-së si dhe nga një gjyqtar dhe pas një kohe të caktuar ai u lirua.⁸⁵ Dëshmitari O dëshmoi se ai ishte marrë nga ushtarë të UÇK-së në 1998 apo 1999 së bashku me dëshmitarin P, dëshmitarin Q dhe SOS të cilët ishin të gjithë civilë. Fillimisht ata u dërguan në Likoc dhe janë mbajtur aty dy ditë. Pastaj, të katërt janë dërguar në Kleçkë dhe vendosur në një dhomë me tre burra të tjerë njëri prej të cilëve ishte BKU. O është mbajtur në Kleçkë një muaj.⁸⁶ Ndërsa dëshmitarit Q nuk i kujtohej një datë e veçantë kur janë arrestuar, Q deklaroi se ishte dimri i vitit 1999 dhe kishte akoma borë. Gjithashtu dëshmitari Q deklaroi se fillimisht ata ishin dërguar në Likoc dhe mbajtur aty dy ditë dhe pastaj ishin dërguar në Kleçkë. Gjithashtu Q deklaroi se në Kleçkë ata i kishin vendosur në një dhomë bashkë me tre burra njëri prej të cilëve ishte BKU.⁸⁷ Deklarata e

⁸¹ Dëshmitari anonim B, 04.12.2010, Deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit nga policia e EULEX-it, pp.4, 5, PSRK dosja B.

⁸² Ibid, p.5.

⁸³ Dëshmitari A, supra note 69, pp.2, 8.

⁸⁴ Dëshmitari anonim C, 21.09.2010, Procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit në PSRK gjatë hetimit, pp.2, 3, 4, PSRK dosja B.

⁸⁵ Dëshmitari anonim M, 30.03.2011, Deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit nga policia e EULEX-it, PSRK dosja D.

⁸⁶ Dëshmitari O, 24.05.2011, Deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit nga policia e EULEX-it, pp.2, 3, 4, PSRK dosja D.

⁸⁷ Dëshmitari Q, 26.05.2011, Deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit nga policia e EULEX-it, fq.2, 3, 4, PSRK dosja D.

dëshmitari P mbështeti deklaratat e O dhe Q në atë se ata dhe SOS ishin arrestuar dhe dërguar fillimisht në Likoc dhe pastaj në Kleçkë. P tha se gjatë kësaj kohe të parit e tij ishte i dobët por atij iu kujtua se në Kleçkë i kishin vendosur në një dhomë me të burgosur të tjerë të cilët mund të kenë qenë dy.⁸⁸ Të gjithë, tre dëshmitarët O, P dhe Q deklaruan se ishin liruar në të njëjtën kohë dhe SOS ishte liruar më vonë.

68. Duke pasur parasysh efektin e kombinuar të provave më lart, trupi gjykues gjen se ka ekzistuar një burg në fshatin Kleçkë ku individë të caktuar janë mbajtur të ndaluar nga pjesëtarë të UÇK-së. Bazuar në deklaratat e dëshmitarëve trupi gjykues ka mundur të identifikojë si minimum përshkrimin e ndërtesës që është përdorur për të mbajtur të ndaluar individë të caktuar (paragraphs.72-85 më poshtë), se ishte një ndërtesë dy katëshe familjare/rezidenciale. Një kat dukej si kat përdhese por ishte ndërtuar, të paktën pjesërisht, nën nivelin e tokës. Kishte dy dhoma, ku individët mbaheshin të ndaluar me të paktën një dritare me pamje nga jashtë. Tuelaeti ishte jashtë në oborr. Kati sipër përdorej nga pjesëtarët e UÇK-së dhe përdorej edhe për intervistimin e individëve të ndaluar.

69. Aktakuza deklaroi se përveç burgut “zyrtar” të Kleçkës UÇK-ja ka përdorur lokale të tjera në fshatin Kleçkë për të ndaluar të burgosur. Këto lokale ishin shtëpi të djegura në të cilat mungonin kushtet e jetesës më elementare dhe ku të burgosurit mbaheshin nganjëherë të lidhur me zinxhirë.⁸⁹ Bazuar në provat me shkrim trupi gjykues nuk ishte në gjendje të arrinte në përfundimin se këto shtëpi të tjera të djegura janë përdorur për të mbajtur të ndaluar individë të caktuar apo për të identifikuar kushtet e paraburgimit në këto shtëpi të djegura. Provat me shkrim kanë vërtetuar ndërtesën siç deklarohet në paragrafin 68, më lart dhe se kati i poshtëm i ndërtesës ishte përdorur për të mbajtur të ndaluar individë të caktuar.

70. Më tej në këtë Aktgjykim janë vlerësuar rrethanat e ndalimit.

⁸⁸ Dëshmitari P, 25.05.2011, Deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit nga policia e EULEX-it, fq.2, 3, 4, PSRK dosja D.

⁸⁹ Aktakuza, fq.23.

C. Dhunim i integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të papërcaktuar të civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosur ushtarakë serbë

71. Aktakuza ngrenë një pretendim të përgjithshëm lidhur me kushtet në Kleçkë se një numër i papërcaktuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosur ushtarakë serbë janë mbajtur në kushte çnjerëzore, përfshirë të burgosur të lidhur me zinxhirë, lokale të papërshtatshme, kushtet e të ftohtit të tepërt, mungesës së higjienës, ushqimit të papërshtatshëm, rrahjeve të shpeshta. Më tej aktakuza përmend persona të caktuar nënshtruar keqtrajtimit për të cilin pretendohet përgjegjësia e të akuzuarit.

1. Kushtet e paraburgimit

72. Bazuar në deklaratat e dëshmitarëve, trupi gjykues vëren se ndërsa kushtet e paraburgimit ishin të vështira, vetë kushtet nuk përbënin një trajtim mizor.

73. Dëshmitarët F, O, P dhe Q, që kanë thënë se janë paraburgosur në Kleçkë, kanë treguar se atyre u ishin dhënë dyshekë sfungjeri për të fjetur, si edhe batanije.⁹⁰ Asnjëri nga dëshmitarët nuk dëshmoi të ishte privuar nga ushqimi. Dëshmitari Anonim C tha se kishte shumë pak ushqim që jepej çdo 24 orë,⁹¹ Dëshmitarët D, F, dhe Dëshmitari Anonim B thanë se ushqimi u

⁹⁰ Dëshmitari F, supra note 80; Dëshmitari O, supra note 86; Dëshmitari P, supra note 88; Dëshmitari Q, supra note 87. Dëshmitari Anonim B dëshmoi se ishin siguruar shtretër metalikë për fjetje.

⁹¹ Dëshmitari Anonim C, supra note 84, fq.2, 3, 4.

jepej më shumë herë gjatë ditës.⁹² Gjithashtu, asnjëri nga dëshmitarët nuk tha se ishin privuar nga përdorimi i banjës. Dëshmitarët D, O, P, Q dhe F kujtojnë se nuk kishte banjë brenda, por ata shoqëroheshin për në banjë në oborr.⁹³ Vetëm Dëshmitari Anonim C tha se gjatë paraburgimit të tij prej rreth shtatë ditësh në Kleçkë, ai asnjëherë nuk u la jashtë qelisë. Ai përshkroi gjithashtu që qelia dukej si një ahur, me ujë të rrjedhshëm brenda në qeli.⁹⁴

74. Në mënyrë të ngjashme, Dëshmitari Anonim M tha se nuk kishte dysheme, vetëm dhe se rridhte ujë.⁹⁵ Të tjerët, P dhe Q, kujtonin se dyshemeja ishte e mbuluar me dërrasa druri.⁹⁶ Duke pasur parasysh deklaratat kundërtëse lidhur me faktin nëse dyshemeja përbëhej nga dheu dhe ishte ndonjëherë e mbuluar me balte, trupi gjykues nuk ka qenë në gjendje të bëjë një përcaktim të saktë në këtë drejtim.

75. Vetëm Dëshmitari P tha se brenda dhomës vinte erë plehu.⁹⁷ Asnjë nga dëshmitarët e tjerë nuk e përmendi erën. Ndërsa vetëm njëri dëshmitar tha që nuk kishte dritare,⁹⁸ disa Dëshmitarë të tjerë, O, Q, P dhe V, dhe Dëshmitari Anonim I, kujtonin një ose më shumë dritare.⁹⁹ Vetëm sipas dëshmisë së Dëshmitarit I del se ai ka parë 30 persona të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë.¹⁰⁰ Asnjë dëshmitar tjetër nuk përmend në deklaratat e tij një numër kaq të madh të burgosurish. Nuk provohet nga dëshmitë e dëshmitarëve që të burgosurit mbaheshin me zinxhirë. Dëshmitari A që e ka vizituar burgun në Kleçkë rregullisht ka dhënë dëshmi se të burgosurit nuk ankoheshin nga trajtimi në burg, përveç një të burgosuri që

⁹² Dëshmitari D, 18.01.2011, Procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit në PSRK gjatë hetimit, PSRK dosja C and 24.12.2010, Deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit nga policia e EULEX-it, PSRK dosja C; Dëshmitari F, supra note 80; Dëshmitari Anonim B, supra note 81.

⁹³ Dëshmitari D, ibid. Dëshmitari O, supra note 86; Dëshmitari P, supra note 88; Dëshmitari Q, supra note 87; Dëshmitari F, supra note 80.

⁹⁴ Dëshmitari Anonim C, supra note 84, pp.2, 3, 4.

⁹⁵ Ibid. Dëshmitari Anonim M, supra note 49 dhe supra note 79.

⁹⁶ Dëshmitari P, supra note 82; Dëshmitari Q, supra note 81.

⁹⁷ Dëshmitari P, supra note 88.

⁹⁸ Dëshmitari F, supra note 80.

⁹⁹ Dëshmitari O, supra note 86; Dëshmitari Q, supra note 87; Dëshmitari P, supra note 88; Dëshmitari V, supra note 79; Dëshmitari Anonim I, 22.11.2010, Deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit nga policia e EULEX-it, PSRK dosja B.

¹⁰⁰ Dëshmitari Anonim I, ibid. Dëshmia P6, Dëshmitari Anonim I, 02.11.2011, Procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit në PSRK gjatë hetimit, Dëshmitë e Prokurorisë dosjet P1-P31.

ishite i lodhur duke qëndruar brenda qelisë së tij gjithë ditën, dhe i kërkoi A-së të lejohej të bënte ndonjë lloj pune.¹⁰¹

76. Në veçanti, mund të nxirret nga deklarata e dëshmitarit D, që ishte një ushtar në ushtrinë serbe, se ai ishte dërguar në Kleçkë dhe ishte vënë në të njëjtën dhomë në bodrum me SA (paragr. 88-93 më poshtë). Po ashtu përshkrimi i shtëpisë në përgjithësi përputhej me përshkrimin e dhënë nga dëshmitarët e tjerë. D-së i kujtohet se ishte një shtëpi dy-katëshe. Të burgosurit mbaheshin në bodrum, nuk kishte banjë dhe për të kryer nevojat e tyre të burgosurit duhet të shoqëroheshin në një banjë të improvizuar në oborr, që në fakt ishte një vrimë në tokë, e rrethuar me dërrasa të drunjta. D-së i kujtohet se njëri nga të burgosurit 'SH' ishte subjekt i rrahjeve përpara të gjithë të burgosurve të tjerë. Trupi gjykues vë re se 'SH' ishte pseudonimi i SA (par. 92 poshtë). 'SH' dërgohej lart dhe D-ja mund ta dëgjonte tek ulërinte. Të burgosurit e tjerë nuk ishin keqtrajtuar në praninë e D-së. Po ashtu, vetë D-ja nuk u keqtrajtua ndonjëherë. Ndërsa D-ja i konsideronte kushtet e burgimit si 'shumë të këqija', ai dëshmoi se atyre ju jepej ushqim dy herë në ditë, në mëngjes dhe pasdite. Sipas D-së, të gjithë të burgosurit ishin mbajtur të palidhur.¹⁰² Më tej, D-ja dha dëshmi se të burgosurit duhet të flinin në dyshekë sfungjeri në një dysHEME betoni. Ndonjëherë në mëngjes atyre u jepej edhe ndonjë kovë me ujë, që të laheshin. Po ashtu ata digjnin edhe dru brenda dhomës.¹⁰³

77. Dëshmitari F u arrestua nga anëtarët e UÇK-së në mars të vitit 1999 dhe u dërgua në Kleçkë, në një shtëpi që dukej si shtëpi familjare. Me sa kujtonte F-ja, dhoma në të cilën u vendos ai, nuk kishte ndonjë dritare dhe dukej si bodrum. Por bora jashtë kishte rënë dhe kishte krijuar goxha trashësi. Kishte edhe pesë apo gjashtë të burgosur të tjerë. F-ja tha se ata u trajtuan të gjithë mirë, nuk u rrahën, merrnin ushqim tri herë në ditë. Ata kishin dyshekë në tokë, si edhe batanije. Po ashtu, në dhomë kishte edhe një sobë druri, që e mbante dhomën të ngrohtë. Të paraburgosurit mbaheshin në dhomë me derën e mbyllur, por jo me çelës gjatë

¹⁰¹ Dëshmitari A, supra note 69, fq.4.

¹⁰² Dëshmitari D, supra note 92.

¹⁰³ Ibid.

ditës. Ajo mbyllej me çelës gjatë natës. Kur të paraburgosurit duhet të shkonin në banjë, ata trokisnin në derë dhe lejoheshin të shkonin në banjë jashtë shtëpisë.¹⁰⁴

78. Sipas deklaratave të Dëshmitarëve O, P dhe Q, ata ishin arrestuar nga anëtarët e UÇK-së dhe ishin paraburgosur në Kleçkë, në të njëjtën kohë, në të njëjtën dhomë, së bashku me SOS. Dëshmitarët O dhe Q kujtojnë se në dhomë kishte edhe tre të burgosur të tjerë, njëri prej të cilëve ishte BKU. Dëshmitari P tha se ai nuk shikonte mirë gjatë asaj kohe dhe ndoshta dy të burgosurit e tjerë që ishin në dhomë me të, ishin O, Q dhe SOS. Që të tre Dëshmitarët O, P dhe Q dëshmuar se asnjë nga të burgosurit nuk ishte keqtrajtuar. Ata mund të përdornin banjën jashtë, disa metra larg. Dera e qelisë mbahej e mbyllur me çelës, por ata mund të trokisnin në derë dhe shoqëroheshin për në banjë. Dëshmitari Q e përshkroi banjën si një vrimë në tokë, me copa druri anash dhe sipër. P-ja tha se në dhomë vinte erë plehu. O, P dhe Q thanë se kishin dyshekë sfungjeri për të fjetur, dhe kishin edhe batanije. O dhe Q dallonin nëse në dhomë kishte mobilie apo jo. Po ashtu, edhe lidhur me numrin e dritareve në dhomë, Dëshmitarët kanë dhënë informacione të ndryshme, një ose më shumë dritare. Sipas P dhe Q, dyshemeja ishte e mbuluar me dërrasa të drunjta. Si P, ashtu edhe Q, deklaruan se gjatë burgimit të tyre në Kleçkë, ata nuk kishin frikë se mos vriteshin. Megjithatë, trupi gjykues vë re se një frikë e tillë mund të mos ishte e lidhur me siguri me paraburgimin e tyre në Kleçkë. P, Q dhe O përshkruan se në fillim ata ishin çuar në Likovc dhe pastaj ishin dërguar me makinë në Kleçkë nga ushtarët e UÇK-së. Rrugës për në Kleçkë, në një moment të caktuar, atyre iu kërkua që të zbrisnin nga makina dhe të viheshin në rresht. Po ashtu, ushtarë të maskuar dhe të armatosur të UÇK-së dolën nga makina. O-ja tha se që nga ai moment ai kishte frikë se mos e vrisnin.¹⁰⁵

79. Dëshmitari V, që ishte paraburgosur në Kleçkë për 56 ditë, tha se ndërtesa përbëhej nga një bodrum dhe një kat. Në nivelin e oborrit kishte dy dhoma dhe sipër ishte edhe një kat tjetër, të cilin e kishte zënë policia ushtarake. Që nga qelia, V-ja mund të shihte oborrin. Mbi derën e qelisë kishte një të çarë dhe ai mund të shihte se kush vinte e shkonte. BKU dhe dy vëllezërit KR ishin në qelinë e tij. Më vonë, u soll edhe vëllai i tretë, që u lirua menjëherë. BKU u morr në

¹⁰⁴ Dëshmitari F, supra note 80.

¹⁰⁵ Dëshmitari O, supra note 86; Dëshmitari Q, supra note 87; Dëshmitari P, supra note 88.

pyetje në katin e sipërm disa herë. V-ja nuk e pa asnjëherë BKU të keqtrajtohej. V-ja mund të shihte shenja në duart dhe shpatullat e tij, por BKU tha se ai ishte vrarë. Një herë BKU u mërzit shumë, dhe kjo ndodhi pasi ai mori një letër. V-ja mendoi se BKU ishte dënuar me vdekje. Dëshmitari kujton se dy vëllezërit KR (par. 95 më poshtë) morën letra që urdhëronin dënimin me vdekje mbi akuzat e të qënurit spiunë. V-ja, po ashtu, rikujton një djalë të ri 17 vjeç, nga fshati Obri. Ai qëndroi në dhomën e tyre për dy ditë, sepse kishte vjedhur disa gjëra. Ushtarët e UÇK-së e rrahën, veçanërisht BH. BH (që po ashtu quhej edhe 'GJ') përshkruhej si një 'kasap'. Ai ishte i vetmi që rrihte pa mëshirë. Në qelinë tjetër ishin dy serbë, babë e bir. Ata nuk u keqtrajtuuan asnjëherë. Personalisht V-ja nuk u keqtrajtua asnjëherë në Kleçkë, 'vetëm u godit dy herë me gjunjë'.¹⁰⁶

80. Trupi gjykues konstaton se deklarata me shkrim e Dëshmitarit V nuk është e qartë në disa pjesë. Dëshmitari V deklaroi se, kur ishte në burg në Kleçkë, MS i drejtoi V-së kërcënime për jetën. Më tej, V-ja vazhdoi: 'Ai më tërhoqi jashtë qelisë, me një thes mbi kokë dhe më kërcënoi jetën. Kur isha në burg, MS, së bashku me kushëririn e tij dhe tre persona të tjerë, erdhën tre herë në qelinë time. Njëherë ata më kërcënuan dhe në një rast tjetër ata më goditën me shkelma.'¹⁰⁷ Në të njëjtën deklaratë V-ja thotë në dëshminë e tij: 'Personalisht, unë nuk jam keqtrajtuar ndonjëherë në Kleçkë. Më kanë goditur vetëm dy herë me gju në stomak. Dëshiroj të shtoj se në një rast babai im u lejua që të vinte e të më takonte në Kleçkë.'¹⁰⁸

81. Dëshmitari Anonim B deklaroi se në maj të vitit 1999 ai ishte paraburgosur në Kleçkë, në një shtëpi dy-katëshe. Kati i sipërm dukej se përdorej nga policia ushtarake e UÇK-së. B-ja u vendos në njëherë nga dy dhomat në bodrum. B-ja pati mundësi të dilte jashtë në oborr, ku ai takoi dy ushtarë të paraburgosur të UÇK-së dhe ku pati mundësinë të bisedonte me ta. Më vonë B-ja lëvizi në qelinë me dy të paraburgosurit e tjerë. B-ja i përshkroi kushtet si të mira. Ata kishin tri krevate metali; patën mundësinë të hanin pak ushqim dhe të rruheshin e të laheshin

¹⁰⁶ Dëshmitari V, supra note 79.

¹⁰⁷ Dëshmitari V, ibid, p.4.

¹⁰⁸ Dëshmitari V, ibid, fq.7.

rregullisht. Dera e qelisë mbahej e hapur gjatë ditës dhe ata patën mundësinë të qëndronin jashtë në oborr. Gjatë natës dera mbahej e mbyllur me çelës.¹⁰⁹

82. Dëshmitari Anonim M, një civil, deklaroi se në mars ose në prill të vitit 1999 ai ishte arrestuar nga UÇK-ja dhe ishte dërguar në një shtëpi dy-katëshe në Kleçkë, dhe ishte vënë në njërën nga dy dhomat në bodrum. Bodrumi ishte i errët, nuk kishte dysheme, vetëm dhe, e ujë e baltë në tokë. Disa orë më pas, M-ja u mor në pyetje. Në fillim M-ja dëshmoi se ai ishte kërcënuar me shkopinj druri, por nuk ishte goditur. Më tej, M-ja deklaroi se ai nuk kishte parë ndonjë krim që të kishte ndodhur në shtëpinë në Kleçkë, por kishte dëgjuar disa persona të caktuar që po ulërinin kur po merreshin në pyetje në katin e parë. Pasi u kthyen ata dukeshin se ishin rrahur, pavarësisht se nuk mundi të shihte gjakderdhje. Lidhur me marrjen e tij në pyetje në shtëpinë në Kleçkë, më vonë Dëshmitari Anonim M dëshmoi se pas marrjes së tij në pyetje, një person me një maskë e goditi atë me shkop në kurriz dy herë.¹¹⁰

83. Dëshmitari Anonim L dëshmoi se në vitin 1999 ai u largua nga Brigada 121 dhe donte të shkonte në Brigadën 123. L-ja nuk ishte i kënaqur me komandantët e njësisë së tij në Brigadën 121. Më vonë Dëshmitari Anonim L u arrestua nga një anëtar i policisë ushtarake të UÇK-së dhe u dërgua në Kleçkë, dhe u vendos në një lloj garazhi apo bodrumi të një shtëpie private. Bodrumi ishte në katin përdhes. Ndërtesa kishte, po ashtu, edhe një kat tjetër. L-ja pa edhe një ushtar të burgosur të UÇK-së në qelinë e tij. Ishte e qartë që ishte rrahur shumë. L-ja e kaloi natën në bodrum dhe të nesërmen u mor në pyetje nga një ushtar i UÇK-së, që quhej ON. L-së iu tha se ai nuk duhet të kishte shkuar në një brigadë tjetër, pa lejen e një personi të caktuar. Më pas, L-ja u lirua.¹¹¹

84. Dëshmitari Anonim I, një ushtar i UÇK-së, ishte në Kleçkë në maj, qershor të vitit 1999. Dëshmitarit i kujtohej që në Kleçkë kishte një qendër paraburgimi. Ishte një shtëpi dy-katëshe. Në një rast, Dëshmitari Anonim I po kalonte aty pranë dhe pa nëpërmjet dritares me hekura

¹⁰⁹ Dëshmitari Anonim B, supra note 81.

¹¹⁰ Dëshmitari Anonim M, supra note 53.

¹¹¹ Dëshmitari Anonim L, 12.04.2011, Procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit në PSRK gjatë hetimit, PSRK dosja D.

nga jashtë dhe pa rreth 30 të burgosur brenda. Ata ishin të gjithë në bodrum. Nga jashtë dukej si kati përdhes, por faktikisht ishte bodrumi. Policia ushtarake qëndronte në katin e sipërm. Dëshmitari I nuk ishte personalisht dëshmitar i ndonjë krimi në Kleçkë.¹¹²

85. Dëshmitari N, ndoshta në maj të vitit 1999 ishte dërguar nga ushtarët e UÇK-së ose në Kleçkë ose në Berishë, në një shtëpi një-katëshe me një bodrum. N-ja ishte vendosur në një dhomë në bodrum. Në dysheme kishte sfungjerë. Banja ishte jashtë në oborr. Ditën e katërt, N-ja ishte dërguar sipër për t'u marrë në pyetje. Gjatë tri ditëve, N-së i ishte dhënë ushqim dhe ishte nxjerrë jashtë në banjë. N-ja nuk ishte keqtrajtuar dhe nuk kishte qenë dëshmitar i ndonjë krimi. N-së i ishte krijuar përshtypja se atë e kishin marrë për shkak të thashethemeve që ai po bashkëpunonte me serbët. Pas intervistës, N-në e kishin liruar.¹¹³

86. Trupi gjykues vë re se disa nga dëshmitarët dëshmuar se disa nga të burgosurit e tjerë ishin ose dukeshin që ishin rrahur. Megjithatë trupi gjykues nuk është i bindur se persona të caktuar i janë nënshtruar keqtrajtimit mbi baza sistematike me anë të përzgjedhjes arbitrare të të burgosurve për abuzim. Deklaratat e dëshmitarëve nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar se gjendja e tyre si të paraburgosur në Kleçkë, bën që ata të kishin frikë të vazhdueshme ndaj abuzimit fizik ose vdekjes. Duke pasur parasysh provat e mësipërme, trupi gjykues arrin në përfundimin se kushtet e paraburgimit *per se* nuk përbëjnë trajtim mizor.

87. Nëse një sjellje e caktuar përbën trajtim mizor, kjo është një çështje që në fakt duhet përcaktuar për secilin rast në mënyrë individuale.¹¹⁴ Në këtë kontekst, aktakuza emëron persona të cilët i janë nënshtruar trajtimit çnjerëzor, ish-drejtori i burgut, SA, ish-oficeri i policisë YG, tre vëllezërit BK, EK dhe NXX, civilët Dëshmitari Anonim H dhe vëllai i tij, pesë ushtarakët serbë, DT, DV¹¹⁵, BC, ZF, ZT, VM dhe ND. Provat e dorëzuara nga prokurori tregojnë

¹¹² Dëshmitari Anonim I, supra note 99.

¹¹³ Dëshmitari N, 04.01.2011, Deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit nga policia e EULEX-it, PSRK dosja C.

¹¹⁴ Prokurori kundër. Fatmir Limaj, Haradin Bala, Isak Musliu, TPNJ, Aktgjykim i Shqyrtimit Kryesor, 30.11.2005, paragr.232.

¹¹⁵ Trupi Gjykues konstaton se në faqen 24 të aktakuzës ku gjenden pretendimet e Prokurorisë për trajtim çnjerëzor të të burgosurve në Kleçkë, mes të tjerëve Prokuroria përmend emrin DEV. Megjithatë, në një vend *P 425/11 AK et al*
Aktgjykim / 2

se mundësisht edhe persona të tjerë të caktuar i janë nënshtruar trajtimit mizor. Megjithatë, këto nuk janë listuar nga prokurori në aktakuzë. Trupi gjykues është i kufizuar vetëm në pretendimet në aktakuzë dhe është i kufizuar që të zgjerojë aktakuzën. Rrjedhimisht, trajtimi mizor i pretenduar i personave, të cilët janë emëruar në aktakuzë, shqyrtohet më tej.

2. SA dhe YG

88. Siç është konsideruar në aktgjykim edhe më sipër (paragr. 67 më sipër) Dëshmitari Anonim C dëshmoi se pas burgimit në Tërpezë, më 26 mars 1999, ai ishte marrë dhe ishte vënë në një qeli në Kleçkë. Qelia ishte në bodrum. C-ja qëndroi aty rreth shtatë ditë. Në qeli kishte edhe katër të burgosur të tjerë. C-ja kujton se njëri nga të burgosurit quhej SA dhe tjetri ishte nga Prizreni dhe quhej I/Y. C-ja deklaroi se qelia ishte si stallë, ai nuk u lejua të dilte nga qelia gjatë qëndrimit aty. Ata kishin ujë të rrjedhshëm në qeli dhe vetëm pak ushqim, çdo 24 orë pak bukë apo diçka të ngjashme. Herë pas here të burgosurit dërgoheshin sipër dhe merreshin në pyetje. C-ja kujton se ishte dikush me emrin H që vinte dhe i merrte të burgosurit sipër për t'u marrë në pyetje dhe i rrihte. Të gjithë të burgosurit në qelinë e C-së ishin rrahur keq. C-ja vetë nuk ishte rrahur dhe nuk ishte marrë në pyetje në Kleçkë. C-ja dëshmoi se në Kleçkë kishte ushtarë që shkonin e vinin, por ai nuk mund të njihnte ndonjërin prej tyre. Më 3 prill të vitit 1999, C-ja ishte liruar nga 'MZ' / [name redacted], për të cilin C-ja mendonte se ishte drejtori i burgut.¹¹⁶

89. Dëshmitari A (paragr. 64-65 më sipër) kujton ta ketë parë SA në Kleçkë. SA ishte nën hetime, por rasti i tij nuk arriti kurrë deri tek Dëshmitari A. Kishte thashetheme se SA ishte drejtori i një burgu në Vushtrri ose në Mitrovicë dhe se ai kishte torturuar të burgosurit politikë.

tjetër në aktakuzë Prokuroria i referohet DV. Gjithashtu, provat nga vendi KER01 i referohen DV. Për këtë arsye, trupi gjykues e ka konsideruar atë si gabim shkrimi në faqen 24 të aktakuzës, dhe se Prokuroria e kishte fjalën për DV.

¹¹⁶ Dëshmitari Anonim C, supra note 84, fq.4, 5.

Dëshmitari A deklaroi se SA mbahej në njërin nga dy dhomat në katin përdhës, por A-ja nuk e dinte se çfarë kishte ndodhur me të.¹¹⁷

90. Ndryshe nga Dëshmitari Anonim C, Dëshmitari A nuk dha dëshmi lidhur me kushtet e paraburgimit në Kleçkë, ose nëse SA kishte ndonjë shenjë dhune fizike. Në të njëjtën kohë, ka qenë dëshmia e A-së që SA ka qenë në paraburgim të UÇK-së në Kleçkë. Ndërsa keqtrajtimi i SA mbështetet nga dëshmia e Dëshmitarit D.

91. Dëshmitari D, një ushtar në ushtrinë serbe, deklaroi se më datën 3 mars 1999, ai u arrestua nga anëtarët e UÇK-së. D-ja u dërgua në disa vende dhe pas një farë kohe në një shtëpi dy-katëshe dhe u vendos në një bodrum. Kishte rreth gjashtë të burgosur të tjerë atje, që të gjithë shqiptarë. Ata ishin në gjendje të keqe dhe shihej menjëherë se ata ishin rrahur. D-së i kujtohet një i burgosur, një burrë plak, që të tjerët e thërrisnin 'SH'. Të burgosur të tjerë thanë që përpara konfliktit ai ishte drejtori i burgut të Smrekonicës. Disa herë ushtarët e UÇK-së erdhën në dhomë dhe e rrahën 'SH' në sy të të gjithëve. Ata, po ashtu, e merrnin 'SH' lart dhe të burgosurit mund ta dëgjonin atë të ulëriste. Asnjë i burgosur tjetër nuk u keqtrajtua në praninë e Dëshmitarit D.¹¹⁸

92. Dëshmitari R dëshmoi se SA, me pseudonimin 'SH' apo 'SHK', u zhduk më 15 mars të vitit 1999, dhe ishte parë për herë të fundit në Mitrovicë. SA kishte punuar për 25 vjet si drejtor i burgut të qarkut të Smrekonicës, në Mitrovicë. Dëshmitari R nuk dinte detaje të tjera të zhdukjes së SA.¹¹⁹

93. Duke pasur parasysh dëshmitë e mësipërme, trupi gjykues është bindur se SA është paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, që drejtohej nga UÇK-ja, në mars të vitit 1999, ka të ngjarë deri më 3 prill të vitit 1999. Trupi gjykues, po ashtu, pranon se SA nuk ka marrë pjesë aktive në luftime të asaj kohe. Pavarësisht se trupi gjykues nuk është në gjendje të

¹¹⁷ Dëshmitari A, supra note 69, fq.6.

¹¹⁸ Dëshmitari D, supra note 92.

¹¹⁹ Dëshmitari R, 22.12.2010, Deklarata e marrjes në pyetje e dëshmitarit në policinë e EULEX-it, PSRK dosja C.

vlerësojë në tërësi rrahjet të cilave i ishte nënshtruar SA, trupi gjykues është i bindur që rrahjet përbënin trajtim mizor. Trupi gjykues, konstaton se që të dy dëshmitarët, Dëshmitari Anonim C dhe Dëshmitari D përshkruan trajtimin si 'rrahje të madhe'. Nga deklarata e C-së del se SA ishte rrahur edhe në sy të të burgosurve të tjerë, në qeli, dhe kur SA ishte dërguar lart, ulërimat e tij mund të dëgjoheshin nga lart në qeli.

94. Duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të të akuzuarve, trupi gjykues gjen se SA është keqtrajtuar në një mënyrë që i shkaktoi atij vuajtje të mëdha mendore dhe fizike, dhe kanë përbërë një sulm të rëndë ndaj dinjitetit njerëzor.

95. Lidhur me YG, trupi gjykues konstaton se vetëm Dëshmitari Anonim C kujton që I/Y ishte i paraburgosur në Kleçkë. Megjithëse ekziston një mundësi që ky mund t'i referohet YG, nuk ka prova të tjera. Si e tillë, dëshmia e Dëshmitarit Anonim C nuk është e mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e aktakuzës se YG ishte paraburgosur në Kleçkë, ose që ai i është nënshtruar trajtimit mizor.

3. Vëllezërit BK, EK dhe NXK

96. Dëshmitari V deklaroi se në fund të vitit 1997 ai u bë plotësisht anëtar i UÇK-së. Më vonë, V-ja u arrestua tri herë nga UÇK-ja. Në njërin rast ai u dërgua në Kleçkë dhe u mbajt atje për 56 ditë. Gjatë kësaj kohe, ai ishte në një dhomë me BKU, dhe në një moment, po ashtu, edhe me dy vëllezërit, IS dhe EL, që ishin nga Caralluga. Vëllai i tretë u soll më vonë, por u lirua menjëherë. Dy vëllezërit, IS dhe EL, qëndruan në burg mes 20 dhe 30 ditëve dhe pastaj u transferuan në një burg tjetër. Dy vëllezërit i thanë V-së se ata akuzoheshin se ishin spiunë. V-ja dëshmoi se IS dhe EL iu nënshtruan rrahjeve dy ose tri herë, por V-ja nuk e dinte nga kush. IS dhe EL u goditën me shkelma, u qëlluan në fytyrë me shpulla dhe u rrahën me shkopinj

bejsbolli. Zakonisht ata që i rrihnin vëllezërit vinin në mbrëmje. HS dhe 'MZ' kontrollonin se kush hynte dhe kush dilte nga burgju.¹²⁰

97. Trupi gjykues konstaton mospërputhjen në emrin e njërit prej vëllezërve, siç kujton V-ja dhe siç deklarohet në aktakuzë.

98. Dëshmitari A kujton se tre vëllezërit KR ishin marrë nga policia ushtarake për në burgun e Kleçkës. Njëri nga vëllezërit quhej BA. A-ja nuk kujtonte nëse ishte ai apo policia ushtarake që i morën në pyetje tre vëllezërit KR. Ata akuzoheshin se kishin bashkëpunuar me serbët. Ata nuk u transferuan asnjëherë tek A-ja për gjykim. Dëshmitari A dëgjoji se tre vëllezërit KR ishin liruar nga FL.¹²¹

99. Dëshmitari T njihte të tre vëllezërit, BK, EK dhe NXK, që jetonin në Carallugë. Siç del nga deklarata e T-së, dy vëllezërit EL dhe NX ishin arrestuar nga UÇK-ja në vitin 1999, ka mundësi në shkurt 1999. BA ishte arrestuar nga UÇK-ja një muaj më pas. Dëshmitari T e takoi NX dy ditë pasi ishin liruar vëllezërit. T-ja deklaroi se ai nuk mund të shihte ndonjë plagë tek NX. NC, po ashtu, tha se atij nuk i kishin bërë asgjë. Më vonë, T-ja dëgjoji në radio se familja e NX ishte vrarë nga forcat serbe.¹²²

100. Trupi gjykues gjen se tre vëllezërit BK, EK dhe NXK ishin paraburgosur nga UÇK-ja në Kleçkë. Trupi gjykues, po ashtu, pranon se vëllezërit nuk po merrnin pjesë aktive në luftimet e asaj kohe. Megjithatë, provat mbi trajtimin e tyre në burgun e UÇK-së në Kleçkë, janë shumë të kufizuara. Vetëm Dëshmitari V ka dhënë dëshmi mbi keqtrajtimin dhe kjo është bërë vetëm për dy nga vëllezërit, dhe dëshmisë i mungonte një identifikim i saktë i njërit nga dy vëllezërit. Për më tepër, dëshmia e V-së kundërshtohet nga dëshmia e T-së. Prandaj, provat me shkrim në

¹²⁰ Dëshmitari V, supra note 79.

¹²¹ Dëshmitari A, supra note 69, fq.4.

¹²² Dëshmitari T, 03.05.2011, Deklarata e marrjes në pyetje e dëshmitarit në policinë e EULEX-it, fq.4, 5, 6, PSRK dosja C.

dosje nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar se vëllezërit BK, EK dhe NXK i janë nënshtruar trajtimit mizor në burgun e UÇK-së në Kleçkë.

4. Dëshmitari anonim H dhe vëllai i tij

101. Dëshmitari Anonim H dëshmoi se ai dhe vëllai i tij, më 27 shkurt 1999, janë marrë nga një grup prej katër apo pesë burrash, tri prej të cilëve ishin me uniformat e UÇK-së dhe dy me rroba civile. Dëshmitari Anonim H dhe vëllai i tij ishin me sy të lidhur dhe ishin dërguar në një vend të caktuar. Aty H-ja ishte marrë në pyetje. Ndërkohë që H-ja u përgjigjej pyetjeve, ai tërë kohën rrihej me shkopinj dhe grushte. H-ja ishte rrethuar nga katër ose pesë burra që e qëllonin me radhë me ç'të kishin mundësi. Kur H-ja rrëzohej në tokë toke ata e ngrinin lart dhe vazhdonin rrahjen. Kur H-ja ra në tokë pa vetëdije, këta persona filluan t'a qëllonin në këmbë me shkopinj ndërkohë që vazhdonin t'a shkelmonin në të gjithë trupin. Meqenëse H-ja nuk mund të qëndronte në këmbë për shkak të rrahjes e kishin ngritur lart dhe dërguar jashtë shtëpisë dhe e kishin hedhur në baltë dhe dëborë. Dëshmitarit H i ishte kthyer vetëdija nga i ftohti dhe ai mund të dëgjonte britmat e vëllait të tij që vinin nga brendësia e shtëpisë. Pas pak ata erdhën dhe morën H-në, duke e dërguar atë në katin e sipërm ku i vëllai ishte i shtrirë. Të dy ishin të prangosur dhe ende me kapuç në kokë. Më vonë dy burra me uniformë të UÇK-së ua hoqën kapuçat nga koka. Të njëjtën natë disa burra erdhën lart dhe mbartën H-në poshtë në bodrum sepse ai nuk ishte në gjendje të ecte. Vëllai i tij u tërhoq zvarrë nga këmbët poshtë shkallëve. Në bodrum ata u lanë të shtrire në një dyshek të hollë sfungjeri. H mund të shihte lëndimet tek i vëllai dhe një prerje të thellë në ballë. H-ja ishte shumë i pafuqishëm dhe mezi arriti të merrte afër tij një shishe me ujë që t'i jepte pak ujë të vëllait. Kur H-ja e arriti shishen e ujit dhe provoi t'i japë pak ujë të vëllait, ai nuk ishte në gjendje të çonte ujin poshtë. Meqë vëllai i H-së po

vdiste, H kërkoi ndihmë duke bërtitur por askush nuk erdhi. H u mundua të ngjallte vëllain me frymëmarrje goje me gojë dhe u mundua t'i bëjë masazh zemrës me bërryl por vëllai tij vdiq. H-ja mbajti të vëllain në krahë për një kohë të papërcaktuar. Kishte aguar kur një grup personash erdhën me një civil rreth 55 vjeçar në krye, i cili iu drejtua H-së në gjuhën serbe duke e pyetur nëse H-ja ishte torturuar dhe nëse i vëllai kishte vdekur si rezultat i torturave. Dëshmitari H ishte përgjigjur duke thënë se ai dhe vëllai i tij ishin torturuar dhe se vëllai kishte vdekur si pasojë e torturave. Dëshmitari H dëshmoi se ky person kishte kërkuar ndjesë dhe i kishte thënë se do t'i siguronte një doktor. Të nesërmen, një grup më i madh anëtarësh të UÇK-së kishte ardhur në bodrum. Disa prej tyre ishin munduar t'i vishnin çizme H-së por kjo nuk kishte qenë e mundur sepse H-ja ishte gjithandej i ënjtur dhe kishte dhimbje. Të njëjtën ditë një grup anëtarësh të UÇK-së transferuan H-në dhe trupin e vdekur të të vëllait tek OSBE-ja. H-ja nuk ishte në gjendje të identifikonte rrugën nëpër të cilën ai ishte dërguar sepse H-ja kishte pasur kokën të mbuluar gjatë gjithë kohës. Personeli i OSBE-së e kishte dërguar H-në menjëherë në spital. Dy ditët e para H kishte qëndruar në reanimacion për shkak të disa thyerjeve në fytyrë, shpatull dhe duar dhe gjendjes së tij të përgjithshme. H-ja qëndroi në spital për dhjetë ditë dhe më vonë u trajtua në një spital tjetër.¹²³

102. Ndërkohë që H-ja, duke patur parasysh se kishte qenë me sy të lidhur shumicën e kohës, nuk mund të identifikonte se ku ishin mbajtur ai dhe vëllai i tij, Dëshmitari A dëshmoi se ai ishte i informuar për dy të burgosur serbë që ishin në Kleçkë. Dëshmitari A kishte shkuar menjëherë në burgun e Kleçkës. Kur A-ja kishte arritur, njëri nga të burgosurit serbë tashme kishte vdekur, dhe ishte e qartë se i burgosuri tjetër ishte rrahur sepse fytyra e tij ishte e ënjtur. A-ja kishte folur me të në gjuhën serbe. I burgosuri serb i kishte thënë se ai nuk ishte ushtarak dhe se i burgosuri tjetër ishte vëllai i tij i cili ishte ushtar. A-së i kujtohet se të dy të burgosurit kishin të veshur uniforma. Dëshmitari A kishte thirrur një mjek i cili kishte përgatitur një raport mjekësor. I burgosuri serb i cili ende ishte gjallë ishte në gjendje shumë të keqe. A-ja i kishte dhënë atij ca ilaçe. Pas konsultimit me BZ, i cili ishte shefi i shtabit të përgjithshëm, dëshmitari A kishte

¹²³ Dëshmitari Anonim H, 24.08.2010, Deklarata e marrjes në pyetje e dëshmitarit në policinë e EULEX-it, PSRK dosja B.

urdhëruar që dy të burgosurit t'i dorëzohen OSBE-së.¹²⁴ BZ i kujtohet se dëshmitari A kishte biseduar me të në lidhje me dy serbët, por ai tha se ata ishin dërguar në qendrën e ndalimit në Lladroc. Dëshmitari A i kishte thënë se njëri prej tyre kishte vdekur. BZ kishte propozuar që serbët duhet të vizitoheshin nga doktori dhe se duhej të verifikohej shkaku i vdekjes. Atij i kujtohej gjithashtu se të dy ata i ishin dorëzuar një organizate ndërkombëtare.¹²⁵

103. Trupi gjykues gjen se dëshmia e Dëshmitarit Anonim H përputhet me dëshminë dhënë nga Dëshmitari A. Trupi gjykues vëren se edhe BZ ishte informuar nga Dëshmitari A në lidhje me dy serbët, një prej të cilëve kishte vdekur. BZ tha se ata ishin mbajtur në Lladroc. Megjithatë, BZ nuk e kishte parë personalisht Dëshmitarin Anonim H dhe vëllain e tij në qendrën e ndalimit dhe ka gjasa që ai mbështetej në informata të dhëna nga të tjerët. Kështu që një thashetheme e tillë nuk zhvlerëson dëshminë e Dëshmitarit Anonim H dhe Dëshmitarit A se Dëshmitari Anonim H dhe vëllai i tij ishin mbajtur në Kleçkë. Trupi gjykues gjen se Dëshmitari Anonim H dhe vëllai i tij janë ndaluar nga UÇK-ja në qendrën e ndalimit në Kleçkë. Trupi gjykues gjithashtu pranon se H dhe vëllai i tij nuk ishin duke marrë pjesë aktivisht në armiqësitë e asaj kohe.

104. Duke lënë mënjanë për momentin çështjen e përgjegjësisë penale të të akuzuarve, trupi gjykues është i bindur se Dëshmitari Anonim H dhe vëllai i tij janë rrahur siç u shpjegua nga Dëshmitari Anonim H dhe më tej vërtetuar nga Dëshmitari A. Një rrahje e tillë kombinuar me faktin se Dëshmitari Anonim H pa vëllain e tij duke vdekur në krahët e tij si pasoje e keqtrajtimit të rëndë fizik, në pamundësi që H-ja të kërkonte ndihmë mjekësore dhe pa ju siguruar ndihmë mjekësore, përbën trajtim mizor të Dëshmitarit Anonim H dhe vëllait të tij.

5. DT, DV¹²⁶, BC, ZF, ZT, VM dhe ND

¹²⁴ Dëshmitari A, supra note 69, p.5.

¹²⁵ BZ, supra note 45, p.4.

¹²⁶ Trupi Gjykues konstaton se në faqen 24 të aktakuzës ku gjenden pretendimet e Prokurorisë për trajtim çnjerëzor të të burgosurve në Kleçkë, mes të tjerëve Prokuroria përmend emrin DEV. Megjithatë, në një vend tjetër në aktakuzë Prokuroria i referohet DV. Gjithashtu, provat nga vendi KER01 i referohen DV. Për këtë arsye, *P 425/11 AK et al*
Aktgjykim / 2

105. Për sa i përket pretendimeve lidhur me kushtet e ndalimit dhe rrahjet e rënda të DT, DV, BC, ZF, ZT, VM dhe ND, aktakuza nuk specifikon në çfarë provash mbështetet Prokuroria për të vërtetuar këto pretendime.¹²⁷

106. Trupi gjykues vëren se në lidhje me akuzat tjera në aktakuzë, për sa i përket DT, DV, BC, ZF, ZT, VM and ND, Prokuroria është mbështetur në dëshminë e Dëshmitarit Bashkëpunues AZ.

107. Përveç dëshmisë së AZ, dosja përmban raporte të zhvarrosjes dhe identifikime të tjera përmes ADN-së nga dy vende në Kleçkë, KER01 dhe KEQ01.

108. Në vendin KER01 u gjetën mbetjet e pesë trupave,¹²⁸ dhe në vendin KEQ01 u gjetën mbetjet e dy trupave.¹²⁹ Në bazë të identifikimit të ADN-së u përcaktua se trupat e gjetur në vendin KER01 janë ato të DT, DV, BC, ZF dhe ZT.¹³⁰ Në bazë të identifikimit të ADN-së u përcaktua se dy trupat e gjetur në vendin KEQ01 janë ato të VM dhe ND.¹³¹

109. Me tej, Prokuroria ka dorëzuar në gjykatë një deklaratë me shkrim të TM. TM ka dëshmuar se në prill të vitit 1999 ka qenë komandant i njësisë ushtarake të Prizrenit në Armatën e Jugosllavisë. Sipas njohurive të TM, më datë 9 prill 1999 dy anëtarë të forcave rezerviste të Armatës së Jugosllavisë, ZF and ZT, ishin larguar qëllimisht nga njësitë e tyre dhe

trupi gjykues e ka konsideruar atë si gabim shkrimi në faqen 24 të aktakuzës, dhe se Prokuroria e kishte fjalën për DV.

¹²⁷ Aktakuzë, pp.23-26.

¹²⁸ Policia e EULEX-it, raporti i zhvarrosjes i policisë, 30.09.2009, lënda numër. 0068-09-ECW4, PSRK dosja H; Policia e EULEX-it, raporti vlerësues i policisë, 24-26.08.2009, lënda numër. 0068-09-ECW4, PSRK dosja H.

¹²⁹ PSRK dosja I.

¹³⁰ Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, 05.02.2010, KER01-001B, MPU 2000-010251 (ZF), PSRK dosja L; Ministria e Drejtësisë e Kosovës, KER01/004B, MPU 2000-000251 (ZT), PSRK dosja L; Ministria e Drejtësisë e Kosovës, Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, KER01-005B, MPU 1999-000047 (BC); Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, KER01-006B, MPU 1999-010047 (DV), PSRK dosja L; Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, KER01-007B, MPU 2000-020251 (DT); Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, lista e raporteve krahasuese të AND për: UNMIK-OMPF, 001/10, 186/09, 178/09, 177/09, 168/09, PSRK dosja H.

¹³¹ Zyra e EULEX-it për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, konfirmimi i identitetit, KEQ01-002B, MPU 1999-000043 (VM), PSRK dosja I; Zyra e EULEX-it për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, konfirmimi i identitetit, KEQ01-001B, MPU 2001-000001 (ND), PSRK dosja I.

kishin shkuar në shtëpitë e braktisura ku banonin myslimanë dhe shqiptarë dhe kishin vjedhur disa gjëra si pasojë e së cilës u urdhërua që ZF dhe ZT të dërgoheshin në Gjykatën Ushtarake në Prishtinë. Më datë 11 prill 1999, TM lëshoi urdhrin për udhëtim. DV dhe BC kishin siguruar shoqërimin. Nga personat që u nisën për udhëtim, DT ishte vartës i drejtpërdrejtë i TM. Më vonë TM kishte mësuar se vetura nuk kishte ndjekur rrugën e caktuar, por ishte kthyer në fshatin Novak, dhe pastaj ndoshta kishte ndjekur rrugën për në fshatin Gjinoc. Të njëjtën ditë, rreth orës 16:00, një anëtar i UÇK-së i cili u identifikua si 'BJ' kishte thirrur me anë të radios duke thënë se ishte rrëmbyer një makinë me ushtarë të Armatës së Jugosllavisë dhe se pikërisht në atë moment DV po pinte kafe me të. 'BJ' nuk kishte përmendur individë të tjerë të cilët ishin rrëmbyer. TM nuk dinte se çfarë kishte ndodhur me ushtarët. Me vonë ai kishte lexuar një artikull mbi ushtarët e rrëmbyer publikuar në 'Vecernje Novosti', ku kishte edhe një fotografi me ushtarë të UÇK-së duke mbajtur koka të prera njerëzish. TM nuk kishte njohur askënd në fotografi.¹³² Vërehet se në një intervistë të mëvonshme me datë 11 prill 2005 TM ndryshoi deklaratën e tij fillestare duke thënë se me datë 11 prill 1999 në radiolidhje u tha se TD ishte rrëmbyer, gjithashtu edhe ZF, ZT, DV dhe BC.¹³³ Në deklaratën e tij të mëtejshme TM dëshmoi se 'BJ komandonte 'Shqiponjat e Zeza' të UÇK-së dhe se gjithashtu njihej si "TR". Emri i tij ishte IT dhe komandanti i tij ka qenë RH. Ata të dy ishin të vendosur në Gllarevë.¹³⁴

110. Në intervistën e dhënë para Prokurorit Special të EULEX-it, Dëshmitari Anonim I deklaroi se në prill të vitit 1999 ai kishte qenë në Kleçkë dhe se kishte parë se katër ushtarë të UÇK-së, MS, BKA, SK dhe MK kishin sjellë katër oficerë serbë të cilët i kishin arrestuar atë ditë më herët. Dëshmitari Anonim I kishte parë se oficerët serbë nuk i kishin duart e lidhura por se atyre u ishin marrë armët. Anëtarët e policisë ushtarake kishte marrë përsipër oficerët serbë dhe i kishte vendosur në bodrumin e shtëpisë. Dëshmitarit Anonim I i ishte thënë se emri i njërit prej

¹³² Dëshmia P21b, TM, Departamenti i Luftës kundër Krimit të Organizuar, Ministria e Brendshme e Republikës së Serbisë, procesverbali, 27.01.2005, dëshmi të Prokurorisë, dosje P1-P31.

¹³³ Dëshmi P21c, TM, Departamenti i Luftës kundër Krimit të Organizuar, Ministria e Brendshme e Republikës së Serbisë, procesverbali, 11.04.2005, Dëshmi të Prokurorisë, dosje P1-P31.

¹³⁴ Dëshmi P21b, TM, supra note 132; Dëshmi P 21c, TM, ibid.

oficerëve ishte DM ose 'diçka e tillë'. Dëshmitari Anonim I nuk dinte se çfarë u kishte ndodhur atyre më vonë.¹³⁵

111. Trupi gjykues gjen se nuk ka prova të mjaftueshme që mbështesin saktësisht pretendimet e Prokurorisë se oficerët serbë i ishin nënshtruar trajtimit çnjerëzor gjatë ndalimit nga UÇK-ja në qendrën e ndalimit në Kleçkë.

112. Mirëpo, nga dëshmitë del se oficerët serbë DT, ZF, ZT, DV dhe BC janë zhdukur me datë 11 prill 1999. Në bazë të dëshmisë së TM, oficerët serbë të lartpërmendur ishin rrëmbyer nga anëtarë të UÇK-së. Të njëjtën ditë, me datë 11 prill 1999 TM, ishte kontaktuar në lidhje me rrëmbimin nga një anëtar i UÇK-së i thirrur "BJ" i cili ishte i vendosur në Gllarevë. Dëshmitari Anonim I ka dëshmuar se në Prill të 1999 në bazën e UÇK-së në Kleçkë ai kishte parë se ishin sjellë katër te burgosur serbë te arrestuar. Dëshmitarit Anonim I i kujtohet se emri i njërit nga oficeret ishte DM ose "diçka e tillë", emër i cili është i ngjashëm me emrin e DV. Për më tepër, trupat e pesë oficerëve ishin gjetur në vendin e quajtur KER01 në Kleçkë. Duke patur parasysh këto prova, trupi gjykues është i mendimit se ka mundësi shumë të madhe se DT, ZF, ZT, DV dhe BC janë dërguar në qendrën e ndalimit të UÇK-së në Kleçkë në prill të 1999. Më tej nga dëshmitë rezulton se ata janë vrarë.

113. Përsa i përket VM dhe ND nuk ka prova të mjaftueshme që trupi gjykues të arrijë në përfundimin mbi zhdukjen dhe më vonë vrasjen e tyre, gjë e cila rezulton nga raportet *post mortem* në lidhje me vendin KEQ01.

D. Torturat e katër të burgosurve ushtarakë serbë

114. Aktakuza pretendon se në mes/fund të prillit katër rezervistë ushtarakë serbë janë dërguar në godinën kryesore të UÇK-së në Kleçkë dhe vendosur në godinën kryesore në katin

¹³⁵ Dëshmia P6, Dëshmitari Anonim I, supra note 100.

përdhes. Aty ata u rrahën gjatë gjithë ditës. NS dhe NXK u bënë atyre pyetje duke i rrahur. SS dhe BS gjithashtu kanë marrë pjesë në rrahje. Të njëjtën ditë, të burgosurit u transferuan në një nga shtëpitë e djegura, dhe disa ditë më vonë, të njëjtët të burgosur u ekzekutuan dhe u varrosën. Siç rezulton nga aktakuza, mbetjet e katër të burgosurve u gjeten në varrezën masive ku kishte pesë trupa (KER01) (para.108 më sipër).

115. Aktakuza mbështetet ekskluzivisht në dëshmitë e siguruar nga Dëshmitari Bashkëpunues AZ. Përveç dëshmisë së tij, dosja përmban edhe raporte të zhvarrosjes dhe identifikime tjera të ADN-së nga vendi në Kleçke, KER01. Në vendin KER01 u gjetën edhe mbetjet e pesë trupave, të cilat përmes identifikimit të ADN-së u përcaktuan të ishin ato të DT, DV, BC, ZF dhe ZT (paragr.108 më sipër).¹³⁶

116. Siç u tha më lart (paragr 109 më sipër), TM dëshmoi se në prill të 1999 ai ishte komandant i Njësisë Ushtarake të Prizrenit në Armatën e Jugosllavisë. Më datë 11 prill 1999 dy anëtarë të forcave rezerviste të Armatës së Jugosllavisë, ZF dhe ZT u shoqëruan nga DV, BC dhe DT për në Gjykatën Ushtarake në Prishtinë. Të njëjtën ditë, rreth orës 16:00, një anëtar i UÇK-së i cili u identifikua si 'BJ' dërgoi një thirrje përmes radios duke thënë se ishte rrëmbyer një makinë me ushtarë të Armatës së Jugosllavisë dhe se pikërisht në atë moment të caktuar DV po pinte kafe me të. 'BJ' nuk përmendi individë të tjerë të cilët ishin rrëmbyer. TM nuk e dinte se çfarë kishte ndodhur me ushtarët. Me vone ai kishte lexuar një artikull në lidhje me ushtarët e rrëmbyer publikuar nga 'Vecernje Novosti', që kishte një fotografi me ushtarë të UÇK-së duke mbajtur koka te prera njerëzish. TM nuk njihte askënd në fotografi. Vërehet se në një intervistë të mëvonshme me datë 11 prill 2005 TM ndryshoi deklaratën e tij fillestare në atë se në radiolidhje më datë 11 prill 1999 u tha se DT ishte rrëmbyer gjithashtu edhe ZF, ZT, DV dhe BC. Në deklaratën e tij të mëtejshme TM dëshmoi se 'BJ' komandonte 'Shqiponjat e Zeza' të UÇK-së dhe se gjithashtu njihej si "TR". Emri i tij ishte IT dhe komandant i tij ishte RH. Të dy ata ishin të vendosur në Gllarevë.¹³⁷

¹³⁶ Supra note 130.

¹³⁷ Dëshmi P 21, TM, supra note 126 dhe supra note 127.

117. Dëshmitari Anonim I dëshmoi se në prill të vitit 1999 ai ishte në Kleçkë dhe kishte parë se katër ushtarë të UÇK-së, MS, BKA, SK dhe MK, kishin sjellë katër oficerë serbë, të cilët i kishin arrestuar atë ditë më herët. Dëshmitari Anonim I kishte parë se oficerët serbë nuk i kishin duart e lidhura por se atyre u ishin marrë armët. Anëtarët e policisë ushtarake kishin marrë përsipër oficerët serbë dhe i kishin vendosur në bodrumin e shtëpisë. Dëshmitari Anonim I tha se atij i ishte thënë se emri i njërit nga oficerët ishte DM ose 'diçka e tillë'. Dëshmitari Anonim I nuk e dinte se çfarë kishte ndodhur me ta më vonë.

118. Trupi Gjykues gjen se nuk ka prova të mjaftueshme ku mund të mbështeten saktësisht pretendimet e Prokurorisë se oficerët serbë i ishin nënshtruar torturës gjatë kohës kur ata ishin ndaluar nga UÇK-ja në qendrën e ndalimit në Kleçkë.

119. Megjithatë, siç është treguar më lart, provat tregojnë se oficerët serbë DT, ZF, ZT, DV and BC u zhdukën me datë 11 prill 1999. Sipas dëshmisë së TM, oficerët serbë ishin rrëmbyer nga anëtarë të UÇK-së. Të njëjtën ditë, me datë 11 prill 1999 TM, u kontaktua nga një anëtar i UÇK-së 'BJ', në lidhje me rrëmbimin, i cili ishte i vendosur në Gllarevë. Dëshmitari Anonim I ka dëshmuar se në prill të 1999 në bazën e UÇK-së në Keçkë ai kishte parë se ishin sjellë katër te burgosur serbë të arrestuar. Dëshmitarit Anonim I i kujtohej se emri i njërit nga oficerët ishte DM ose 'diçka e tillë', që përse i përket emrit është i ngjashëm me emrin e DV. Për më tepër, trupat e pesë oficerëve u gjetën në vendin e quajtur KER01 në Kleçkë. Në bazë të këtyre provave, trupi gjykues është i mendimit se ekziston një mundësi e madhe se DT, ZF, ZT, DV dhe BC janë sjellë në qendrën e ndalimit të UÇK-së në Kleçkë në prill të 1999. Me tej provat tregojnë se ata janë vrarë.

E. Vrasja e katër të burgosurve ushtarakë serbë

120. Aktakuza thotë se katër rezervistë ushtarakë serbë të cilët në mes apo fund të prillit 1999 janë dërguar në ndërtesën kryesore në Kleçkë dhe mbajtur të ndaluar aty (paragr 114 më sipër)

janë ekzekutuar më vonë nga një grup prej pesë pjesëtarësh të UÇK-së në një arë aty afër. Aktakuza mbështetet në dëshminë e dëshmitarit bashkëpunues AZ në atë se katër rezervistët ushtarakë serbë ishin marrë nga NS, NXK dhe NK dhe dy pjesëtarë të tjerë të UÇK-së emrat e të cilëve nuk i kujtoheshin AZ. AZ nuk ka mundur të shohë vetë të shtënat por ai ka parë vetëm katër të burgosurit duke u dërguar në vendin e ekzekutimit dhe pastaj ka dëgjuar të shtënat me armë.

121. Duke lënë mënjanë dëshminë e AZ, dosja përmban raportet e zhvarrosjes dhe identifikime të tjera ADN nga vendi në Kleçkë, KER01. Në vendin KER01 janë gjetur mbetjet e pesë trupave të cilët bazuar në identifikimin ADN është gjetur se janë të DT, DV, BC, ZF dhe ZT (paragr.108 më lart).¹³⁸ Bazuar në raportet *post mortem*, shkaku i vdekjes së BC, ZF dhe ZT, kanë qenë të shtëna me armë zjarri në kokë dhe DT: prerje e fytit, traumë në kraharor shkaktuar nga një objekt jo i mprehtë dhe në parakrahun e djathtë, dhe DV: prerje e fytit nga një mjet i mprehtë. Më tej siç është vërejtur më herët (paragr.109 më lart), TM pohoi zhdukjen e DT, DV, BC, ZF dhe ZT me datë 11 prill 1999, dhe se lidhur me zhdukjen e tyre TM është kontaktuar nga një pjesëtar i UÇK-së, 'BJ'. Dëshmitari anonim I (paragr.110 më lart) dëshmoi se në prill të vitit 1999 ai ka parë katër oficerë serbë që janë sjellë në Kleçkë.

122. Bazuar në këto prova, trupi gjykues vlerëson se mundësia është jashtëzakonisht e madhe që DT, ZF, ZT, DV dhe BC janë sjellë në qendrën e ndalimit të UÇK-së në Kleçkë në prill të vitit 1999. Lidhur me zhdukjen e tyre, trupi gjykues është në gjendje të arrijë vetëm në përfundimin se ata janë vrarë dhe shkaku i vdekjes së tyre është dhënë në raportet *post mortem*.

F. Tortura e një të burgosuri ushtarak serb

¹³⁸ Supra note 130.

123. Aktakuza pretendon se nga fundi i prillit 1999 një i burgosur serb i veshur me rroba civile është sjellë në burgun e Kleçkës dhe ekzekutuar pak orë më vonë. Prokuroria mbështetet në dëshminë e Dëshmitarit Bashkëpunues AZ në atë se para se të ekzekutohej i burgosuri serb ishte marrë në pyetje dhe goditur me grushte dhe shqelma nga FL. AZ ishte i pranishëm kur FL mori në pyetje të burgosurin, bashkë me pjesëtarë të tjerë të UÇK-së përfshirë NS, NXX, NK, BL, SS dhe BS. Duke cituar dëshminë e AZ aktakuza pretendon se para se të ekzekutohej i burgosuri është rrahur përsëri nga NK dhe NXX.

124. Më tej në aktakuzë thuhet se në këtë fazë nuk është e mundur të vërtetohet nëse i burgosuri serb i cili është torturuar dhe më vonë vrarë ishte DT apo DV, mbetjet e të cilëve janë gjetur në një varrezë masive afër Kleçkës, KER01.

125. Trupi gjykues konstaton se nuk ka prova të tjera që pohojnë torturën e pretenduar të të burgosurit ushtarak serb me saktësi ashtu siç pretendohet në aktakuzë nga prokuroria. Pas përjashtimit të dëshmisë së AZ, trupi gjykues i referohet provave nga zhvarrosja në vendin KER01 nga raportet *post mortem* për DT dhe DV. Bazuar në këto prova, trupi gjykues arrin në përfundimin se DT dhe DV janë vrarë dhe shkak i vdekjes së tyre ishte siç është përshkruar në raportet post mortem, DV: prerje e fytit me mjet të mprehtë,¹³⁹ dhe DT: prerje e fytit me mjet të mprehtë, traumë në kraharor dhe parakrahun e djathtë shkaktuar nga një mjet jo i mprehtë.¹⁴⁰

G. Vrasja e një të burgosuri ushtarak serb

¹³⁹ Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, Departamenti i Drejtësisë, raporti i autopsisë, vendi i varrezës në Kleçkë, 29.10.2009, numri i lëndës. KER01/006B, PSRK dosja L; Departamenti i Drejtësisë, Zyra e Ekzaminuesit Mjekësor, çertifikatë vdekje, DV, 12.12.2009, lënda numër. KER01-006B, MPU 1999-010047, PSRK dosja L.

¹⁴⁰ Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, Departamenti i Drejtësisë, raporti i autopsisë, vendi i varrezës në Kleçkë, 29.10.2009, numri i lëndës. KER01/007B, PSRK dosja L; Departamenti i Drejtësisë, Zyra e Ekzaminuesit Mjekësor, çertifikatë vdekje, DT, 04.03.2010, lënda numër. KER01-007B, MPU 2000-020251, PSRK dosja L.

126. Aktakuza pretendon se në prill të vitit 1999, jo para datës 11 prill 1999, një i burgosur ushtarak serb është dërguar në burgun e Kleçkës dhe ekzekutuar pak orë më vonë nga NS me një kosë, sipas udhëzimeve të FL. Dëshmitari Bashkëpunues AZ gjeti kosën për NS që ai të priste të burgosurin. Në Aktakuzë thuhet se dëshmitari bashkëpunues AZ ia kishte dhënë kosën të akuzuarit AK, i cili më tej ia kishte dhënë NS. Në lidhje me te akuzuarit NS, NK dhe NXK aktakuza pretendon se ata ishin pjesë e grupit i cili kishte marshuar të burgosurin tek vendi i ekzekutimit dhe që kishte vënë viktimën në dispozicion të kryerësit dhe gjithashtu parandaluar arratisjen e tij.

127. Përshkrimi i ngjarjeve në fjalë bazohet në deklaratat e Dëshmitarit Bashkëpunues AZ dhënë para Policisë dhe Prokurorisë. Dëshmia e AZ është deklaruar provë e papranueshme dhe si e tillë nuk mund të merret parasysh nga Trupi Gjykes në shpalljen e këtij Aktgjykimi. Megjithatë, trupi gjykes i referohet tërheqjes së pjeshme të Aktakuzës, ushtruar nga Prokurori Special i EULEX-it më datë 11 nëntor 2011, i cili hodhi poshtë pretendimet e lartpërmendura kundër te akuzuarit AK. Në tërheqjen e pjeshme të Aktakuzës Prokurori Special i EULEX-it deklaroi se i akuzuari 'AK i siguroi Prokurorisë dokumente (përfshirë certifikata mjekësore dhe fotografi), në lidhje me plagosjen e pretenduar të tij gjatë luftës'. 'Në veçanti, një certifikatë mjekësore tregon se me datë 18 prill 1999 Z. KR kishte marrë disa plagë nga armë zjarri në shumë pjesë të trupit, përfshirë fytin'. 'Dokumentet e paraqitura nga Z. KR, për të cilat Prokuroria nuk ishte e informuar në kohën e Aktakuzës, janë në konflikt me rrëfimin e AZ përsa u përket datave.'¹⁴¹

128. Duke lënë mënjanë dëshminë e AZ, provat përmbajnë raporte të zvarrosjes dhe raporte post mortem si dhe identifikime të mëtejshme përmes ADN-së nga vendi KER01 në Kleçkë. Në vendin KER01 janë gjetur mbetjet e pesë trupave, të cilët përmes identifikimit të ADN-së u përcaktuan të jenë ato të DT, DV, BC, ZF dhe ZT. Raporti post mortem i DV tregon shkakun e vdekjes: prerje e qafës nga një mjet i mprehtë.¹⁴² Raporti post mortem i DT tregon shkakun a

¹⁴¹Tërheqja e Pjeshme e Aktakuzës nga PSRK-ja, supra note 4.

¹⁴² Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, Departamenti i Drejtësisë, raporti i autopsisë, vendi i varrezës në Kleçkë, 29.10.2009, numri i lëndës. KER01/006B, PSRK dosja L; Departamenti i Drejtësisë, Zyra P 425/11 AK et al Aktgjykim / 2

vdekjes: prerje e qafës nga një mjet i mprehtë, traumë në kraharor dhe parakrahun e djathtë si pasojë e forcës së ushtruar nga një mjet jo i mprehtë.¹⁴³ Më tej, raportet mbi zhvarrosjen në vendin KER01 në Kleçkë, vërtetojnë se mes mbetjeve mortore është gjetur një kosë.¹⁴⁴ Mjeku ligjor pranë DML-së, MG, dëshmoi se ato lëndime mund të shkaktohen duke përdorur drapër apo kosë.¹⁴⁵ Antropologu mjeko-ligjor TF dëshmoi se lëndimet e gjetura përputhen me lëndime të shaktuara nga përdorimi i një mjete si kosa e gjetur në vendngjarje.¹⁴⁶ Antropologu mjeko-ligjor pranë DML-së, CC, dha vlerësimin e saj se ka gjasa që tehu të jetë vendosur në varr në të njëjtën kohë si trupi 001B.¹⁴⁷

129. Nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar se DT ose DV janë vrarë në rrethanat e sakta siç është përshkruar në Aktakuzë, në mënyrë më specifike, nga kush dhe në bazë të urdhër të kujt. Përveç konkluzioneve të lartpërmendura në lidhje me DT, DV, BC, ZF and ZT (paragr. 112) trupi gjykues, bazuar në raportin post mortem pranon se DV and DT janë vrare dhe se shkak i vdekjes se tyre është siç është përshkruar ne raportet e tyre post-mortem.

H. Vrasja e ND dhe VM

130. Aktakuza pretendon se më datë 03 prill 1999, Dëshmitarit Bashkëpunues AZ i ishte thënë se FL kishte urdhëruar vrasjen e ND dhe VM, dy oficerë të policisë serbe të cilët ishin ndaluar në shtëpitë e djegura në Kleçkë për rreth tre muaj. Pasi AZ kishte kërkuar konfirmim nga vetë FL, FL ishte çuditur se këta të dy ishin ende gjallë. Të nesërmen FL kishte shkuar në burgun e Kleçkës me NXX, NK dhe NS. Atje, ai kishte urdhëruar që të burgosurit të merreshin nga shtëpia e

e Ekzaminuesit Mjekësor, çertifikatë vdekje, DV, 12.12.2009, lënda numër. KER01-006B, MPU 1999-010047, PSRK dosja L.

¹⁴³ Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, Departamenti i Drejtësisë, raporti i autopsisë, vendi i varrezës në Kleçkë, 29.10.2009, numri i lëndës. KER01/007B, PSRK dosja L; Departamenti i Drejtësisë, Zyra e Ekzaminuesit Mjekësor, çertifikatë vdekje DT, 04.03.2010, lënda numër. KER01-007B, MPU 2000-020251, PSRK dosja L.

¹⁴⁴ Raporti i Policisë mbi Zhvarrosjen, supra note 122.

¹⁴⁵ MG, 20.01.2010, Procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit ekspert në PSRK gjatë hetimit, fq.3, PSRK dosja L.

¹⁴⁶ TF, 20.01.2010, Procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit ekspert në PSRK gjatë hetimit, fq.3, PSRK dosja L.

¹⁴⁷ Dëshmi P23, CC, 06.12.2011, Procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit ekspert në PSRK gjatë hetimit, fq.3, dëshmitë e prokurorisë, dosjet P1–P31.

djegur dhe të dërgoheshin në vendin që njihej si Livadhi i Canit. Dëshmitari bashkëpunues AZ, të akuzuarit AK dhe BL shoqëruan të burgosurit deri në vend. Atje, FL urdhëroi Dëshmitarin Bashkëpunues që personalisht t'i qëllonte dy të burgosurit. Përsa i përket të akuzuarve NXK, NK dhe NS,, në aktakuzë thuhet se të akuzuarit kanë kontribuar në krim duke mbajtur viktimat në dispozicion të ekzekutuesit, duke parandaluar çdo mundësi ikjeje dhe, me praninë e tyre, duke bërë urdhrin e FL edhe me detyrues për dëshmitarin bashkëpunues.

131. Përshkrimi i ngjarjeve të përmendura bazohet në deklaratat e dhëna nga AZ. Duke lënë mënjanë atë përshkrim, dosja përmban raporte të zhvarrosjes dhe raporte post mortem dhe identifikime të mëtejshme të ADN-së nga vendi në Kleçkë, KEQ01. Në vendin KEQ01 janë gjetur mbetjet e dy trupave. Përmes identifikimit të ADN-së u vërtetua se dy trupat e gjetur tek vendi KEQ01 janë të VM dhe ND.¹⁴⁸ Raporti post mortem për VM tregon shkakun e vdekjes: e shtënë me armë në kokë dhe trup.¹⁴⁹ Raporti post mortem për ND tregon shkakun e vdekjes: të shtëna me armë në kokë.¹⁵⁰ Certifikatat e vdekjes për VM and ND konstatojnë vendin e vdekjes: Kleçkë, Komuna e Lipjanit.¹⁵¹

132. Nuk ka prova të tjera mbi rrethanat e vdekjes së VM dhe ND.

133. Për këtë arsye, trupi gjykues gjen se pretendimet e aktakuzës nuk mund vërtetohen saktësisht siç janë përshkruar aty dhe se trupi gjykues është në gjendje të arrijë vetëm në përfundimin se VM dhe ND janë vrarë.

¹⁴⁸ Zyra e EULEX-it për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, certifikatë vdekje, 10.12.2010, numri i lëndës. KEQ01-002B, MPU 1999-000043 (VM), PSRK dosje I; Zyra e EULEX-it për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, certifikatë vdekje, 10.12.2010, numri i lëndës. KEQ01-001B, MPU 2001-000001 (ND), PSRK dosja I.

¹⁴⁹ Ministria e Drejtësisë së Kosovës, Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, raporti i autopsisë, vendi i varrezës në Malishevë, 14.09.2010, numri i lëndës. KEQ01/002B, PSRK dosja I.

¹⁵⁰ Ministria e Drejtësisë së Kosovës, Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, raporti i autopsisë, vendi i varrezës në Malishevë, 14.09.2010, numri i lëndës. KEQ01/001B, PSRK dosja I.

¹⁵¹ Zyra e EULEX-it për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, certifikatë vdekje, 14.12.2010, VM, MPU 1999-000043, KEQ01-002B, PSRK dosja I; Zyra e EULEX-it për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, certifikatë vdekje, 14.12.2010, ND, MPU 2001-000001, KEQ01-001B, PSRK dosja I.

I. Vrasja e AA

134. Aktakuza pretendon se me ose rreth datës 03/04 prill 1999, AA, i burgosur civil, është ekzekutuar me të shtëna nga armë zjarri nga një grup përbërë nga NK, NXK, NS dhe RM shumë afër burgut të Kleçkës. Përsa i përket të akuzuarit NS, aktakuza thekson se i akuzuari ishte pjesë e grupit që shoqëroi AA, mbajti AA në dispozicion të kryerësve, duke parandaluar arratisjen e tij, dhe mori pjesë në veprimin e përbashkët të shtyrjes së AA në gropën ku AA u qëllua. Aktakuza pretendon se të akuzuarit NK dhe NXK qëlluan AA me AK-47-at e tyre duke shkaktuar në këtë mënyrë vdekjen e tij.

135. Përshkrimi i mëparshëm i ngjarjeve në aktakuzë, bazohet në deklaratat e Dëshmitarit Bashkëpunues AZ dhënë në polici dhe prokurori.

136. Duke lënë mënjanë dëshminë e AZ, Dëshmitari Anonim C dëshmoi se më datë 26 mars 1999, atë e kishin futur në një qeli në Kleçkë. Në qeli kishte pasur edhe katër të burgosur të tjerë, përfshirë edhe një shqiptar me emër AA. Ai i kishte thënë C-së se armata serbe e kishte përdorur atë për t'u treguar vendndodhjen e fshatrave shqiptare dhe pozicionet e UÇK-së, kështu që ai ishte konsideruar si bashkëpunëtor. C-ja theksoi se të gjithë bashkë të burgosurit në qelinë e tij ishin rrahur (para.88 më lart). Me tej, C-ja dëshmoi se më datë 03 prill 1999 ai ishte liruar së bashku me të burgosurit tjerë, përfshirë AA. C-ja kishte shoqëruar AA në fshatin Sankoc dhe e kishte dorëzuar tek kryetari i fshatit ose koordinatori, SI, dhe i kishte kërkuar atij që të shoqëronte AA në fshatin "Dobrashevc" ku ishte familja e AA. Ditën e nesërme filloi ofensiva serbe, dhe C-ja kishte menduar se AA ishte munduar të shkonte vetë në 'Dobrashevc'.¹⁵²

137. Aktakuza thekson se AA është liruar së bashku me dëshmitarin D. Në lidhje me këtë Trupi Gjykses vëren se dëshmitarit D i kujtohej 'SH' (para. 91 më lart), dhe tha se ai ishte liruar së

¹⁵² Dëshmitari Anonim C, supra note 84.

bashku me tre të burgosur të tjerë, dy prej të cilëve babë e bir, por atij nuk i kujtohej emri apo origjina e të burgosurit të tretë.¹⁵³

138. Trupi gjykues gjen se përsa i përket AA provat janë të kufizuara. Vetëm Dëshmitari Anonim C ka deklaruar se ai është liruar së bashku me AA nga qendra e ndalimit të Kleçkës. AA mbetet i zhdukur.¹⁵⁴ Edhe pse trupi i të vdekurit mungon, krimi i vrasjes mund të përcaktohet,¹⁵⁵ provat në këtë rast nuk e lejojnë Trupin Gjykues që të arrijë në përfundimin se AA është vrarë në mënyrën siç përshkruhet në aktakuzë.

VI. KONKLuzionet mbi Përgjegjësinë e të Akuzuarve

A. Forma e përgjegjësisë

139. Në fillim trupi gjykues është i detyruar të shqyrtojë mangësitë në aktakuzë lidhur me formën e përgjegjësisë ndaj të akuzuarve.

140. Akuza 1 kundër NK thotë se NK akuzohet '... në cilësinë e tij si **komandant** ... UÇK-së, dhe si person që mbante **pozitë me përgjegjësi** në qendrën e ndalimit në Kleçkë...'. Akuza 1 kundër FL thotë se FL akuzohet '... si **komandant** ... UÇK-së dhe si **person që ushtron kontroll të përgjithshëm** në qendrën e ndalimit në Kleçkë ...'. Akuza 2 dhe akuza 3 akuzojnë FL edhe në cilësinë e tij 'si **komandant** i UÇK-së'. Akuza 1 kundër NS thotë se NS akuzohet '... në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së i cili mbante pozitë me **përgjegjësi** në qendrën e ndalimit në Kleçkë.¹⁵⁶

¹⁵³ Dëshmitari D, supra note 92.

¹⁵⁴ Dëshmi P3, memo e Departamentit të Mjekësisë Ligjore të EULEX, 12.10.2011, 2011-DFM-129, Dëshmi të Prokurorisë, dosje P1-P31.

¹⁵⁵ Prokurori kundër. Miroslav Kvočka, Mlado Radić, Zoran Žigić, Dragoljub Prcać, TPNJ, Aktgjykim mbi Ankesë, 28.02.2005, paragr.326; Prokurori kundër. Sefer Halilović, TPNJ, Aktgjykim në Shqyrtim Kryesor, 16.11.2005, paragr.37; Prokurori kundër. Radoslav Brđanin, TPNJ, Aktgjykim në Shqyrtim Kryesor, 01.09.2004, paragr.385.

¹⁵⁶ Aktakuza, fq.3, 9, 11.

141. Asnjë nga pikat e akuzës kundër NXK nuk pretendon përgjegjësi komanduese lidhur me qendrën e ndalimit në Kleçkë apo në ndonjë mënyrë tjetër. Megjithatë provat e shqyrtuara nga gjykata dukej se mbështetnin pretendimin se NXK ka mbajtur një pozitë me përgjegjësi komanduese në qendrën e ndalimit. Në pajtim me këtë gjykata ftoi prokurorin që të konsiderojë ndryshimin e aktakuzës për të përfshirë këtë pretendim kundër tij. Pas seancës së datës 30 mars 2012, kur është ndarë procedura, prokurori me anë të parashtresës së tij të datës 4 prill 2012 refuzoi të ndryshonte aktakuzën dhe qëndrimi i tij ishte se trupi gjykues duhej të vazhdonte me aktakuzën në formën e saj të tanishme duke kërkuar nga trupi gjykues... që të marrë një vendim bazuar në provat në dispozicion’.

142. Formulimi i lartpërmendur i aktakuzës implikon se aktakuza pretendon përgjegjësi të lartë (komanduese) të të akuzuarve, NK, FL dhe NS. Megjithatë në aktakuzë nuk përmendet asnjë bazë ligjore për atë formë përgjegjësie. Aktakuza i referohet vetëm dispozitave të KPRFSJ dhe KPK-së bashkë, siç janë përcaktuar në nenin 22 KPRFSJ-së, apo bashkëkryerje siç është përcaktuar nga neni 23 KPK-së. Të njëjtat pika të akuzës pretendojnë gjithashtu në bashkëkryerje për të njëjtat krime.

143. Kështu neni 22 i KPRFSJ-së dhe neni 22 i KPK-së mbështesin vetëm atë pjesë të së njëjtës pikë të akuzës ku pretendohet se të akuzuarit kanë kryer të njëjtin krim në bashkëkryerje.

144. Më tej, aktakuza dështon të specifikojë mjaftueshëm shkakun e akuzave lidhur me përgjegjësinë e lartë (komanduese). Neni 6(3)(a) KEDNJ jep një personi të akuzuar të drejtën që të informohet për shkakun e akuzës, p.sh, aktet për të cilat akuzohet dhe mbi të cilat bazohet aktakuza si dhe për natyrën e akuzës, p.sh klasifikimin e akteve në fjalë. Për më tepër, informatat lidhur me natyrën dhe shkakun e akuzës duhet të jenë të duhura për ti mundësuar të akuzuarit që të përgatisë siç duhet mbrojtjen e tij.¹⁵⁷

¹⁵⁷ Shih Ayçoban dhe të tjerë kundër. Turqisë, GJEDNJ, Aktgjykim, 22.12.2005, paragr.21, <http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-71817>.

145. Neni 305(1)3)4)5) KPPK parasheh shprehimisht kushtin se aktakuza duhet të përmbajë klasifikimin ligjor të veprës penale me referenca të dispozitave të kodit penal; rrethanat për të përcaktuar veprën penale **me saktësi**; dhe një shpjegim të bazës për ngritjen e aktakuzës mbi bazat e rezultateve të hetimit dhe provave që vërtetojnë faktet kyçe.

146. Në vitin 1977 doktrina e përgjegjesisë së lartë (komanduese) është pranuar si ligj zakonor ndërkombëtar dhe është kodifikuar në Protokollin Shtesë I të Konventave të Gjenevës për konfliktet e armatosura ndërkombëtare. Statusi i tij si ligj zakonor ndërkombëtar është konfirmuar me përfshirjen e qartë të përgjegjesisë së lartë (komanduese) në nenin 7(3) të Statutit të TPNJ dhe neni 6(3) I Statutit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën (TPNR) si dhe neni 28 i Statutit të Romës për GJPN.¹⁵⁸ Duhet të theksohet se ligji ndërkombëtar njeh parimin e përgjegjesisë komanduese në konflikt të armatosur *ndërkombëtar* dhe të *brendshëm*.¹⁵⁹

147. Elementet e përgjegjesisë së lartë nën ligjin zakonor ndërkombëtar janë elaboruar nga TPNJ në rastin *Celebici* si në vijim:

- 1) Ekzistenca e marrëdhënies epror-vartës;
- 2) Eprori ka ditur apo ka pasur arsye të dijë se vepra penale do të kryhej apo ishte kryer; dhe
- 3) Eprori ka dështuar të marrë masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar veprën penale apo për të ndëshkuar kryerësin.¹⁶⁰

148. Në pajtim me jurisprudencën e TPNJ në rastet kur pretendohet përgjegjësia penale e lartë faktet materiale që duhet të paraqiten në aktakuzë janë:

¹⁵⁸ Statuti i Romës përfshin në fakt deklarinimin e fundit të këtij parimi bazuar në traktat. Megjithatë duhet të theksohet se neni 28 i Statutit të Romës nuk pasqyron detyrimisht ligjin zakonor ndërkombëtar në tërësi.

¹⁵⁹ Shih Qendra e së Drejtës Humanitare, Përgjegjësia Komanduese: E Drejta Bashkëkohore, e cila gjendet në <http://www.hlc-rdc.org/uploads/editor/Command%20Responsibility.pdf> (qasja e fundit 28.06.2012); Prokurori kundër. Fatmir Limaj, Haradin Bala, Isak Musliu, TPNJ, Aktgjykimi i Shqyrtimit Kryesor, 30.11.2005, paragr.519

¹⁶⁰ Prokurori kundër. Zejnil Delalić, Zdravko Mucić, i njohur si 'Pavo', Hazim Delić, Esad Landžo, i njohur si 'Zenga', TPNJ, Aktgjykimi i Shqyrtimit Kryesor, 16.11.1998, paragr.346; Prokurori kundër. Fatmir Limaj, Haradin Bala, Isak Musliu, TPNJ, Aktgjykimi i Shqyrtimit Kryesor, 30.11.2005, paragr.520.

- 1) (i) se i akuzuari është eprori i (ii) vartësve të identifikuar të mënyrë të mjaftueshme (iii) mbi të cilët ai kishte kontroll efektiv – në kuptimin e aftësisë materiale për të parandaluar apo ndëshkuar sjellje kriminale dhe (iv) për të cilat akte pretendohet se ai është përgjegjës;
- 2) Sjellja e të akzuarit me anë të së cilës mund të gjendet se ai (i) ka ditur apo ka pasur arsye për të ditur se krimet do të kryheshin apo ishin kryer nga vartësit e tij dhe (ii) sjellja lidhur me këtë e atyre të tjerëve për të cilët pretendohet se ai është përgjegjës; dhe
- 3) Sjellja e të akzuarit përmes së cilës mund të gjendet se ai ka dështuar në marrjen e masave të nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar këto akte apo për të ndëshkuar personat që i kanë kryer ato.¹⁶¹

149. Një epror mund të posedojë *mens rea* për përgjegjësi të lartë në rastet kur:

- 1) Ai ka pasur njohuri reale të vërtetuar përmes provave direkte apo rrethanore se vartësit e tij ishin duke kryer apo do të kryenin krimet; apo
- 2) Ai ka pasur në posedim informacione të asaj natyre të cilat, të paktën, do të paralajmëronin atë për rrezikun për këto vepra penale duke shfaqur nevojën për hetime shtesë me qëllim që të vërtetohet nëse këto krime ishin kryer apo do të kryheshin nga vartësit e tij.¹⁶²

150. Përsa i përket *mens rea*, ka dy mënyra për të paraqitur gjendjen mendore relevante:

- 1) Ose vetë gjendja mendore specifike duhet të paraqitet si fakt material dhe në këtë rast faktet me të cilat do të vërtetohet fakti material janë çështje provash të zakonshme dhe nuk kanë nevojë të argumentohen; ose

¹⁶¹ Prokurori kundër. Tihomir Blaškić, TPNJ, Aktgjykimi i Ankesës, 29.07.2004, paragr.218; Prokurori kundër. Miroslav Deronjić Vendimi, paragr.15 (që urdhëron Prokurorin të paraqesë në mënyrë të qartë pozicionin që formon bazën për akuzat për përgjegjësi të lartë); Prokurori kundër. Milorad Krnojelac, TPNJ, Vendimi në Shqyrtim Kryesor mbi Kërkesë Paraprake për Formën e Aktakuzës së Ndryshuar, 11.02.2000, paragr.18; Prokurori kundër. Radoslav Brdjanin dhe Momir Talic, TPNJ, Vendimi në Shqyrtim Kryesor, 20.02.2001, paragr.19.

¹⁶² Prokurori kundër. Zejnil Delalić, Zdravko Mucić, i njohur si 'Pavo', Hazim Delić, Esad Landžo, i njohur si 'Zenga', TPNJ, Aktgjykimi i Shqyrtimit Kryesor, 16.11.1998, paragr.383; dhe Prokurori kundër. Zejnil Delalić, Zdravko Mucić, i njohur si 'Pavo', Hazim Delić, Esad Landžo, i njohur si 'Zenga', TPNJ, Aktgjykimi në Ankesë, 20.02.2001, paragr.223, 241.

2) Faktet dëshmuese nga të cilat do të sigurohet gjendja mendore duhet të paraqiten. Zakonisht secili nga faktet materiale duhet të paraqitet shprehimisht edhe pse në disa rrethana mund të mjaftojë nëse ato shprehen përmes aludimit të nevojshëm. Megjithatë ky rregull themelor i paraqitjes dhe argumentimit nuk respektohet nëse paraqitja dhe argumentimi vetëm supozon ekzistencën e parakushtit ligjor.¹⁶³

151. Duke pasur parasysh çfarë u tha më lart, aktakuza në këtë rast mbështet akuzat aty ku përgjegjësia e lartë e të akuzuarve pretendohet si në vijim:

- 1) NK ka qenë njëri prej përgjegjësve për menaxhimin e burgut të Kleçkës përfshirë pranimin dhe regjistrimin e të burgosurve. NK ishte 'oficer policie i zonës', përgjegjës për të hetuar këdo donte ai. NK ka marrë në pyetje të burgosur dhe në një rast ka rrahur një të burgosur.¹⁶⁴
- 2) FL ka ushtruar komandë dhe kontroll të përgjithshëm në burgun e Kleçkës. FL ishte shef i policisë ushtarake të UÇK-së në atë zonë. FL ka urdhëruar se ku do të mbaheshin të burgosurit. FL ka marrë pjesë në marrje në pyetje. FL kishte fuqinë për të urdhëruar lirimin e të burgosurve. FL të paktën në një rast, ka torturuar personalisht një të burgosur serb në Kleçkë. FL kishte fuqinë të urdhëronte vrasjen e të burgosurve të caktuar.¹⁶⁵ FL ka urdhëruar dëshmitarin bashkëpunues AZ që të ekzekutojë VM dhe ND.¹⁶⁶
- 3) NS ishte njëri prej përgjegjësve për menaxhimin e burgut të Kleçkës përfshirë pranimin dhe regjistrimin e të burgosurve. Të burgosurit dorëzoheshin nën përgjegjësinë e NS. NS lejohej të hynte në shtabin e përgjithshëm të UCK-së në Divjakë.¹⁶⁷

152. Nuk paraqiten fakte të tjera materiale në aktakuzë për akuzat ku pretendohet përgjegjësia e lartë e të akuzuarve.

¹⁶³ Prokurori kundër Tihomir Blaškić, TPNJ, Aktgjykim në Ankesë, 29.07.2004, paragr.219; Prokurori kundër. Radoslav Brdjanin dhe Momir Talic, TPNJ, Vendimi i Shqyrtimit Kryesor, 20.02.2001, paragr.48.

¹⁶⁴ Aktakuza, p.25.

¹⁶⁵ Aktakuza, p.26.

¹⁶⁶ Aktakuza, p.27.

¹⁶⁷ Aktakuza, p.25.

153. Lidhur me këtë pikë trupi gjykues është i detyruar të diskutojë, në veçanti pikën 1 kundër të akuzuarve, NK, FL dhe NS dhe pikën 2 kundër FL.

154. Pika 1 pretendon përgjegjësinë e lartë të të akuzuarve si ‘komandantë të UÇK-së’ dhe/ose “pjesëtarë të UÇK-së me pozita me përgjegjësi” në qendrën e ndalimit në Kleçkë, në krimin e dhunimit së integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të papërcaktuar të civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosur ushtarakë serbë në burgun e Kleçkës. Aktakuza, siç është diskutuar më lart (paragr 87) jep emra individësh konkretë të cilët janë nënshtruar trajtimit çnjerëzor. Në pikën 1 kundër secilit prej të akuzuarve prokurori nuk ka paraqitur fakte materiale shtesë të tjera nga ato të përshkruar në paragrafin 151 të aktgjykimit.

155. Më tej, nën pikën 2 FL akuzohet si ‘komandant’ në krimin e torturës së një të burgosuri ushtarak serb në burgun e Kleçkës.¹⁶⁸ Megjithatë aktakuza përmban vetëm fakte materiale për pjesëmarrjen aktive të FL në krim. Në veçanti aktakuza thotë se FL ka marrë në pyetje, goditur me grushte dhe shqelma të burgosurin ushtarak serb bashkë me të akuzuarit e tjerë të specifikuar.¹⁶⁹

156. Si e tillë, është udhëzuese për trupin gjykues që të shqyrtojë mungesën e paraqitjes së fakteve materiale të cilat nënvizojnë pretendimet e përgjegjesisë së lartë të të akuzuarve. Aktakuza për pikën 1 kundër NK, FL dhe NS dhe pika 2 kundër FL, në përgjithësi, dështon në paraqitjen dhe demonstrimin e fakteve materiale lidhur me ekzistencën e marrëdhënies epror-vartës; dhe se të akuzuarit kanë ditur apo kanë pasur arsye për të ditur se vepra penale do të kryhej apo ishte kryer; dhe se të akuzuarit kanë dështuar në marrjen e masave të nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar veprën penale apo për të ndëshkuar kryerësin e saj.

157. Trupi Gjykues duhet të theksojë se në rastet kur pretendohet përgjegjësia e lartë marrëdhënia e secilit prej të akuzuarve me vartësit e tyre është thelbësore. Niveli që duhet të

¹⁶⁸ Aktakuza, p.9.

¹⁶⁹ Aktakuza, fq.29, 30.

arrihet për vendosjen e një marrëdhënie epror-vartës është ai i kontrollit efektiv të një vartësi – aftësia materiale për të parandaluar apo ndëshkuar sjelljen kriminale pavarësisht mënyrës si ushtrohet ky kontroll.¹⁷⁰

158. Më tej, është materiale të demonstrohet se të akuzuarit kanë pasur njohuri për krimet dhe masat e nevojshme dhe të arsyeshme të cilat të akuzuarit kanë dështuar të marrin për të parandaluar krimet apo për të ndëshkuar vartësit e tij.

159. Për më tepër, në rastin ku prokurori paraqet përgjegjësi të lartë, nuk është e duhur të mbështetet kjo përgjegjësi me pretendimet për pjesëmarrjen aktive të të akuzuarit përfshirë dhënien e urdhrave kryerësve të tjerë. Akuzat për përgjegjësi të lartë kanë për qëllim të vërtetojnë përgjegjësinë për **lëshime** – në rastin kur përgjegjësia e lartë paraqitet në mënyrë të drejtë, një i akuzuar është përgjegjës për dështimin e tij për të marrë masa të nevojshme dhe të arsyeshme për të **parandaluar** akte të caktuara apo për shkak se ai ka **dështuar të ndëshkojë** kryerësit. Në rastet kur pretendohet se vartësit kanë ndjekur urdhrat e të akuzuarve akuzat nuk është për përgjegjësi komanduese.¹⁷¹

160. Në rastet kur të akuzuarit janë të akuzuar për përgjegjësi të lartë penale dhe pjesëmarrje aktive (përgjegjësi penale), aktakuza duhet të ndajë këto akte në mënyrë të qartë sepse të njëjtat fakte nuk mund të krijojnë në të njëjtën kohë dy lloj përgjegjësish.¹⁷²

161. Të gjitha këto mangësi në aktakuzë do të duhej të ishin eliminuar në fazën e konfirmimit të aktakuzës. Gjyqtari konfirmues në asnjë moment nuk e ka kthyer aktakuzën prokurorit në pajtim me nenin 306(2) KPPK. Në këtë mënyrë trupi gjykues mbetet me akuzat kundër të

¹⁷⁰ Prokurori kundër. Zejnil Delalić, Zdravko Mucić, i njohur si 'Pavo', Hazim Delić, Esad Landžo, i njohur si 'Zenga', TPNJ, Aktgjykimi në Ankesë, 20.02.2001, paragr.256.

¹⁷¹ Prokurori kundër. Protais Zigiranyirazo, TPNJ, Vendimi i Trupit Gjykues për Kërkesën më Kusht të Prokurorit për Leje për të Ndryshuar Aktakuzën dhe për Kundërkërkesën e Mbrojtjes e cila kundërshton Formën e Ribërjes së Aktakuzës, 02.03.2005, paragr.19, <http://www.unictr.org/Portals/0/Case/English/Zigiranyirazo/decisions/020305.pdf>.

¹⁷² Shih Prokurori kundër. Joseph Kanyabashi, TPNJ, Vendimi i Trupit Gjykues për Kërkesën Paraprake të Mbrojtjes lidhur me Defektet në Formën e Aktakuzës, 31.05.2000, paragr.5.8-5.11, <http://www.unictr.org/Portals/0/Case/English/Kanyabashi/decisions/defect.pdf>.

akuzuarve me pretendimet për përgjegjësi të lartë por pa fakte materiale të mjaftueshme që vërtetojnë plotësisht të gjitha elementet e përgjegjesisë së lartë; dhe me të njëjtën akuzë me pretendimin për përgjegjësi të lartë, bashkë me pjesëmarrjen aktive të të akuzuarve në krim. Në veçanti pika 1 kundër NK, FL dhe NS dhe pika 2 dhe 3 kundër FL.

162. Edhe pse përballë këtyre vështirësive trupi gjykues mbetet megjithatë i detyruar të veprojë sipas nenit 396(7) KPPK dhe të ‘... deklarojë qartë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse cilat fakte ai vlerëson të vërtetuara apo jo si dhe bazat për këtë’. Për këtë arsye, gjykata ka ekzaminuar në tërësi provat lidhur me pretendimet për përgjegjësinë e lartë të të akuzuarve si dhe pjesëmarrjen aktive në pjesët ku ato pretendohen në aktakuzë. Në vlerësimin e përgjegjesisë së lartë , trupi gjykues mori parasysh elementet e formës së përgjegjesisë siç është përcaktuar në ligjin zakonor ndërkombëtar dhe diskutuar më lart.. Lidhur me këtë trupi gjykues vëren se qëndrimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në rastin *Kononov v. Latvia*, ishte se nuk ka shkelje të *nullum crimen, nulla poena sine lege* (neni 7(1) GJEDNJ), në rastin kur në kohën e akteve të inkriminuara ata përbënin vepra penale të përkufizuara me mundësi qasjeje dhe parashikuese të mjaftueshme nga ligjet dhe zakonet e luftës.¹⁷³

163. Gjatë vlerësimit të përgjegjesisë së lartë trupi gjykues analizoi provat me kujdes dhe nëse provat vërtetojnë përgjegjesisë e lartë të të akuzuarve. Për këtë ekzaminim ishte thelbësore që trupi gjykues të vlerësojë çfarë roli kanë pasur të akuzuarit, NK, FL dhe NS në burgun e Kleçkës. Trupi Gjykues ka parasysh se ‘për të qenë i zbatueshëm parimi i përgjegjesisë së lartë duhet që eprori të ketë kontroll efektiv në personat që kryejnë shkeljet e përmendura të ligjit humanitar ndërkombëtar, në kuptimin që ai të ketë aftësinë materiale për të parandaluar dhe ndëshkuar kryerjen e këtyre veprave penale’.¹⁷⁴

¹⁷³ Kononov kundër. Latvia, GJEDNJ, Dhoma Kryesore, Aktgjykim, 17.05.2010, paragr.211, 213, 238, 244. <http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-98669>.

¹⁷⁴ Prokurori kundër. Zejnil Delalić, Zdravko Mucić, i njohur si ‘Pavo’, Hazim Delić, Esad Landžo, i njohur si ‘Zenga’, TPNJ, Aktgjykimi I Shqyrtimit Kryesor, 16.11.1998, paragr.377-378; dhe pohuar në Prokurori kundër. Zejnil Delalić, Zdravko Mucić, i njohur si ‘Pavo’, Hazim Delić, Esad Landžo, i njohur si ‘Zenga’, TPNJ, Aktgjykimi në Ankesë, 20.02.2001, paragr.197.

164. Më tej, trupi gjykues ka ekzaminuar provat lidhur me pretendimet për pjesëmarrje aktive të të akuzuarve, NK, NXX, FL dhe NS në kryerjen e krimeve.

B. NK

165. Aktakuza pretendon se NK, si pjesëtar dhe komandant i UÇK-së dhe si person që ka pasur pozitë me përgjegjësi në qendrën e ndalimit në Kleçkë dhe në bashkëkryerje me të akuzuarit e tjerë të specifikuar, ka shkelur integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të papërcaktuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosur ushtarakë serbë në qendrën e ndalimit në Kleçkë. Trupi gjykues nuk ka qenë në gjende të arrijë në përfundimin se kushtet në qendrën e paraburgimit në vetvete ishin të tilla sa të përbënin trajtim mizor. Megjithatë trupi gjykues gjeti se nga individët specifikë emrat e të cilëve janë dhënë në aktakuzë, dëshmitari anonim H, vëllai i tij dhe SA janë nënshtruar trajtimit mizor.

166. Më tej aktakuza pretendon se NK, duke vepruar në bashkëkryerje, ka vrarë AA; ka marrë pjesë në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë të paraburgosur në burgun e Kleçkës; ka shkelur integritetin trupor dhe shëndetin e një të burgosuri ushtarak serb i paraburgosur në burgun e Kleçkës; ka marrë pjesë në vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb; dhe ka marrë pjesë në vrasjen e VM dhe ND.

1. Roli i NK në burgun e Kleçkës

167. Disa dëshmitarë, përfshirë QK,¹⁷⁵ dhe BZ,¹⁷⁶ kanë njohur NK si pjesëtar i Brigadës 121 ('Brigada Kumanova'). Gjatë shqyrtimit kryesor NK pohoi se pseudonimi i tij ishte 'BF'.¹⁷⁷

¹⁷⁵ QK, supra note 47, p.4.

¹⁷⁶ BZ, supra note 45, p.5.

168. BZ, i cili ishte shëf i shtabit në shtabin e përgjithshëm të UÇK-së nga janari 1999 deri në prill 1999, deklaroi se pas nëntorit/dhjetorit 1998 HS është bërë komandant i Brigadës 121. BZ iu kujtua se 'BF' ishte pjesëtar i Brigadës 121 nën komandën e FL dhe më vonë nën komandën e HS (shih diskutimin më poshtë).¹⁷⁸

169. Përsa i përket çështjes së komandës, trupi gjykues konstaton se sipas dëshmisë së dëshmitarit anonim C, në shtabin e UÇK-së në Llapushnik ishte një gjyqtar mysliman ai që urdhëroi ushtarët të lidhnin dhe arrestonin C-në. Pas kësaj C-ja u dërgua me makinë në Tërpezë. Dëshmitari anonim C u kujtua se njërin prej ushtarëve të UÇK-së e thirrnin 'BF' apo 'N'. 'BF' ishte njëri nga tre ushtarët e UÇK-së i cili ka shoqëruar me makinë në Terpeze dhe e ka burgosur C-në në Terpeze, e ka marrë atë në pyetje dhe ka qenë i pranishëm kur C është rrahur dhe ka marrë pjesë në rrahje dhe më vonë ka liruar C-në dhe dërguar atë në Kleçkë.¹⁷⁹

170. Në këtë mënyrë, dëshmia e C-së sugjeroi se 'BF' ka vepruar sipas urdhrit të gjyqtarit mysliman në Llapushnik. Megjithatë, trupi gjykues nuk është në gjendje të nxjerrë përfundimin se ishte me saktësi i akuzuari NK ai që veproi sipas urdhrave të gjyqtarit mysliman, sepse deklarata e C-së është e paqartë për identitetin e 'BF'. C deklaroi se pas luftës ai është përpjekur të zbulojë se kush ishte 'BF' dhe ka mësuar se emri i tij ishte NS.¹⁸⁰ Kështu, trupi gjykues nuk është në gjendje të nxjerrë nga dëshmia e C-së përfundimin se ishte i akuzuari NK ai që kishte dërguar me makinë C-në në Kleçkë, që do të mund të shërbente për të treguar funksionet e NK në Kleçkë.

171. Lidhur me Kleçkën, BZ iu kujtua se ai ka parë 'BF' në shtabin e Brigadës 121 në Kleçkë apo Berishë sepse shtabi lëvizte nganjëherë.¹⁸¹ Megjithatë dëshmia e BZ nuk ka dhënë detaje të

¹⁷⁷ Procesverbal 11.11.2011, para.25, Dosja e gjykatës 3. Në seancën mbi paraburgim 16 mars 2011, NK tregoi se nofkën 'BF' e ka pasur gjatë luftës. Shiko Procesverbalin e seancës mbi paraburgimin 16.03.2011, f.1, GJPP dosja 2.

¹⁷⁸ BZ, supra note 45, pp.2, 4, 5.

¹⁷⁹ Dëshmitari anonim C, supra note 84, faqet.2, 3, 4.

¹⁸⁰ Dëshmitari anonim C, supra note 84, f.3.

¹⁸¹ BZ, supra note 45, pp.2, 4, 5.

tjera për rolin e NK në qendrën e ndalimit në Kleçkë për të mundësuar trupit gjykues që të nxjerrë ndonjë përfundim.

172. NK deklaroi se ai kishte qenë në burg në Kleçkë herë pas here ose për të dërguar persona atje apo për të bërë marrje në pyetje por jo për të inspektuar burgun. Ai ka vizituar Kleçkën edhe për shkak se komanda e Brigadës 121 ishte e vendosur aty. Sipas NK puna e tij ka konsistuar në raste kundër ushtarëve të UÇK-së por atij nuk i kujtohej se në burgun e Kleçkës ishin dërguar civilë edhe pse ka qenë e mundur të ndodhë. NK nuk ka parë asnjëherë asnjë civil apo ushtarak serb në Kleçkë. Nga deklarata e NK del se ai ka bashkëpunuar ngushtë me dëshmitarin A dhe ka ndjekur udhëzimet e A-së në punën e tij.¹⁸²

173. Dëshmitari A dëshmoi se në disa raste ai ka urdhëruar paraburgimin e individëve të caktuar në burgun e Kleçkës. Në veçanti, A iu referua rastit të BKU i cili ishte akuzuar për dezertim dhe A ka urdhëruar që BKU të paraburgoset në burgun e Kleçkës në pritje të zbatimit të dënimit të tij. Megjithatë, sipas dëshmisë së A-së burgu ishte nën kontrollin fizik të policisë ushtarake të UÇK-së dhe një person i caktuar ishte përgjegjës i burgut – ‘drejtor’ burgu, emri e të cilit nuk i kujtohej A-së. Në të njëjtën kohë, dëshmitari A ka njohur ‘BF’, por vetëm si oficer i policisë ushtarake. A e ka parë atë në Kleçkë si dhe në shtabin e përgjithshëm dhe A-ja i ka dhënë ‘BF’ udhëzime për sjelljen e policisë ushtarake.

174. Nga dëshmia e A-së nuk doli se NK (‘BF’) ka komanduar në burgun e Kleçkës. Trupi gjykues vëren se edhe pse A ka deklaruar se ai ka shkuar në Kleçkë rregullisht A ka përshtuar ‘BF’ si oficer i policisë ushtarake.¹⁸³

175. Lidhur me këtë edhe BZ iu kujtua ‘BF’, por vetëm si pjesëtar i Brigadës 121 dhe BZ nuk dinte tjetër për detyrat e ‘BF’.¹⁸⁴

¹⁸² NK, supra note 46.

¹⁸³ Dëshmitari A, supra note 69.

¹⁸⁴ BZ, supra note 45, p.5.

176. Trupi gjykues vëren se dëshmitari anonim H dëshmoi se kur H dhe vëllai i tij ishin marrë nga ushtarët e UÇK-së me datë 27 shkurt 1999, në një moment të caktuar, H dhe vëllai i tij ishin të ulur në gjunjë. Një person i veshur me rroba civile dhe i armatosur me mitraloz qëlloi një të shtënë mu afër kokës së H-së. Dëshmitari anonim H nuk ka ditur nëse kjo ishte pa dashje apo e qëllimshme por një person tjetër me rroba civile tha: 'B çfarë po bën?' Pasi që personat e grupit biseduan mes tyre ata dhanë urdhër H-së dhe vëllait të tij që të shkonin 10 metra më lart në kodër dhe të shtriheshin. H ka menduar se do të vriteshin por një person me një pushkë shumë të madhe iu tha atyre që të mos kishin frikë sepse ata nuk do ti vrisnin. Dëshmitari anonim H u informua se për fatin e tyre do të vendoste një komandant. Pas rreth 10 minutash erdhi komandanti me një grup prej katër deri në gjashtë persona të cilët ishin të veshur të gjithë me uniforma të UÇK me stemë. Pastaj dëshmitari anonim H dhe vëllai i tij janë vendosur në makinë.¹⁸⁵

177. Duhet të përkujtojmë se trupi gjykues gjeti se dëshmitari anonim H dhe vëllai i tij janë dërguar në burgun e Kleçkës dhe nënshtruar trajtimit mizor (paragr.101-104 më lart).

178. Lidhur me këtë dëshmia e dëshmitarit anonim H sugjeron se 'B' ka marrë pjesë në ndalimin e H-së dhe vëllait të tij por nga ana tjetër ai ka pritur udhëzimet nga komandanti eprori i tij. Provat tregojnë se 'BF' ishte pseudonimi i NK.

179. Përveç Dëshmitarit Anonim H, edhe Dëshmitari Anonim I tregoi mbi sjelljen e NK në burgun e Kleçkës. Në veçanti Dëshmitarit Anonim I kujtohet se në prill 1999 katër oficerë serbë ishin dërguar në Kleçkë, edhe NK ('BF') kishte marrë në ngarkim oficerët serbë.¹⁸⁶ Dëshmitari Anonim I tregoi gjithashtu se NK ('BF') ishte 'oficer policie i zonës' dhe se detyra e tij ishte të zhvillonte hetime dhe se ai mund të hetonte këdo që donte.¹⁸⁷

¹⁸⁵ Dëshmitari anonim H, supra note 123.

¹⁸⁶ Prova P6, Dëshmitari Anonim I, supra note 100, fq.2.

¹⁸⁷ Dëshmitari Anonim I, supra note 99, fq.7.

180. Përsa i përket dëshmisë së Dëshmitarit Anonim H dhe Dëshmitarit Anonim I, trupi gjykues duhet të bëjë dallimin kur ajo dëshmi provon rolin e NK në qendrën e ndalimit në Kleçkë, dhe pretendimet e ndara faktike mbi pjesëmarrjen aktive të NK në krimet e pretenduara. Në lidhje me këtë të fundit, dëshmia e secilit Dëshmitar Anonim ka të bëjë me pretendime të ndara dhe si e tillë aktivizon Nenin 157(3) KPPK.

181. Përsa i përket rolit të NK në qendrën e ndalimit në Kleçkë, trupi gjykues vëren se as dëshmia e Dëshmitarit Anonim H dhe as ajo e Dëshmitarit Anonim I nuk tregojnë se NK ka dhënë urdhra apo udhëzime apo se ai ka ushtruar fuqi disiplinore në qendrën e ndalimit në Kleçkë. Ndërkohë që provat tregojnë se NK është parë në qendrën e ndalimit në Kleçkë, provat nuk arrijnë të vërtetojnë se NK ka ushtruar fuqi komanduese në qendrën e ndalimit.

182. Gjatë shqyrtimit të përgjegjësisë komanduese të NK në qendrën e ndalimit në Kleçkë, trupi gjykues vëren se provat sugjerojnë se NK është lidhur gjithashtu me dy skuadra të UÇK-së në dy vende, në Bellanicë dhe në Shalë (Lipjan). Për këtë arsye, NK nuk del të jetë i lidhur ekskluzivisht me Kleçkë por se ai ka qenë në fakt i ndarë mes të paktën tre vendeve.

183. Përsa i përket Bellanicës, trupi gjykues vëren se AH, administrator në policinë ushtarake të UÇK-së, ka dëshmuar se duke filluar nga fundi i vitit 1998, ai ka qenë i stacionuar në Bellanicë, dhe se mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë ka qenë UG dhe se NK ka qenë më i lartë në zinxhirin komandues.¹⁸⁸ Megjithatë, AH nuk i dinte detyrat e NK.

184. Sipas dëshmisë së IZ, ish-anëtar i Brigadës 121, një skuadër prej shtatë deri tetë oficerë të policisë ushtarake ishte e stacionuar në Bellanicë dhe udhëheqësi i tyre ishte UG. Megjithatë IZ nuk e dinte kush ishte komandanti i policisë ushtarake për të gjithë zonën.¹⁸⁹

¹⁸⁸ AH, 14.12.2010, deklaratë e dëshmitarit, marrje në pyetje nga policia e EULEX-it, PSRK dosja D; AH, supra note 67.

¹⁸⁹ IZ, supra note 60, fq.4.

185. BAZ dëshmoi se në korrik/gusht 1998 ai iu bashkëngjit policisë ushtarake dhe u stacionua në Bellanicë, dhe se udhëheqësi i ekipit ishte UG. Sipas asaj që tha BAZ askush nuk dinte se kush i raportonte kujt. Më vonë BAZ mësoi se UG i raportonte NXX. Njëra prej detyrave të BAZ ishte ndjekja e lëvizjeve të ushtarëve. Ata nuk kishin arrestuar kurrë askënd si skuadër. BAZ nuk kishte qenë kurrë në Kleçkë gjatë luftës.¹⁹⁰

186. Ndërsa në lidhje me Shalën, nga dëshmia e SB del se duke filluar nga mesi i janarit 1999 ai ishte pjesë e policisë ushtarake dhe se ishte i stacionuar në Shalë. Komandanti i tij ishte AS dhe më lart në pozitë komanduese ishte NS. SB dëshmoi se detyrat e tyre në Shalë ishin të ruanin rregullin në treg, ku kishte lëvizje të popullsisë e cila ishte zhvendosur nga serbët. Ata ndihmuan gjithashtu popullsinë e zhvendosur për t' u rivendosur. Pjesë e detyrave të SB ishte hetimi i ushtarëve të UÇK-së për shkelje disiplinore, por SB nuk i kujtoheshin raste të tilla.¹⁹¹

2. Përgjegjësia e NK

187. Në lidhje me atë që u tha më lart, provat nuk mundësojnë që trupi gjykues të gjejë përtej dyshimit të arsyeshëm nëse ka ekzistuar marrëdhënie epror-vartës mes NK dhe individëve të cilët merreshin me të burgosurit në qendrën e ndalimit në Kleçkë. Provat nuk mundësojnë trupin gjykues të arrijë në përfundimin, përtej dyshimit të arsyeshëm, se NK ka ditur apo ka patur arsye të dinte se individë të caktuar, si p.sh Dëshmitari Anonim H, vëllai i tij ose SA do t' i nënshtroheshin trajtimit mizor apo se i ishin nënshtroar trajtimit mizor; dhe se NK ka dështuar të marrë masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të ndaluar krimet apo për të ndëshkuar kryerësin e këtyre krimeve.

188. Për këtë arsye, trupi gjykues refuzon pretendimet e prokurorisë në aktakuzë mbi përgjegjësinë komanduese të NK.

¹⁹⁰ BZ, supra note 54.

¹⁹¹ SB, supra note 68.

189. Së bashku me përgjegjësinë komanduese, aktakuza pretendon pjesëmarrjen aktive të NK në cënimin e integritetit trupor dhe shëndetin e civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë, ndaluar në burgun e Kleçkës. Trupi Gjykues gjen se kushtet e ndalimit në burgun e Kleçkës nuk përbëjnë *per se* trajtim mizor, por se nga individët e listuar në aktakuzë Dëshmitari Anonim H, vëllai i tij dhe SA i janë nënshtruar trajtimit mizor.

190. Siç është konsideruar më lart në aktgjykim (para.176-178, 180) dëshmia e Dëshmitarit Anonim H sugjeron se 'B' ka marrë pjesë në ndalimin e H-së dhe vëllait të tij. Megjithatë, trupi gjykues nuk është në gjendje të arrijë në ndonjë gjetje në bazë të atyre provave duke vepruar në bazë të Nenit 157(3) KPPK. Më tej, Trupi Gjykues vëren se del nga dëshmia e Dëshmitarit A se A-ja kishte shkuar në burgun e Kleçkës menjëherë pasi mësoi se Dëshmitari Anonim H dhe vëllai i tij ishin ndaluar në Kleçkë. Nga deklarata e A-së del se kur ai kishte shkuar në burg kishte parë atje në atë kohë një 'drejtor' burgu si dhe një grua. Dëshmitari A ishte këshilluar me BZ, shef i shtabit të përgjithshëm, dhe ata kishin rënë dakord që të burgosurit t'i dorëzoheshin OSBE-së, dhe pas kësaj A-ja kishte urdhëruar transferimin e tyre.¹⁹² Trupi gjykues vëren se Dëshmitari A kishte parë dëshmitarin Anonim H dhe vëllain e tij pasi ata i ishin nënshtruar trajtimit mizor në burgun e Kleçkës, megjithatë dëshmia e A-së nuk përmban ndonjë sugjerim që lidh NK me krimet.

191. Për këtë arsye, trupi gjykues gjen se nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se NK ka bërë që Dëshmitari Anonim H, vëllai i tij apo SA t'i nënshtrohen trajtimit mizor.

192. Më tej aktakuza pretendon se NK, duke vepruar në bashkëkryerje ka vrarë AA; ka marrë pjesë në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë ndaluar në burgun e Kleçkës; ka cënuar integritetin trupor dhe shëndetin e një të burgosuri ushtarak serb ndaluar në burgun e Kleçkës; dhe se më pas ka marrë pjesë në vrasjen e të burgosurit ushtarak serb; dhe në vrasjen e VM dhe ND.

¹⁹² Ibid.

193. Trupi gjykues vëren se përta i përket fajësisë së NK në kryerjen e këtyre krimeve, prokuroria i referohet në aktakuzë ekskluzivisht dëshmisë Dëshmitarit Bashkëpunues AZ. Një mbështetje e tillë në dëshminë e AZ është bërë nga prokuroria në lidhje me pjesëmarrjen e pretenduar të NK në vrasjen e AA;¹⁹³ pjesëmarrjen në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë ndaluar në burgun e Kleçkës;¹⁹⁴ cënimin e integritetit trupor dhe shëndetit dhe vrasjen e të burgosurit ushtarak serb ndaluar në burgun e Kleçkës;¹⁹⁵ dhe vrasjen e VM dhe ND.¹⁹⁶

194. Lidhur me këto krime nuk ka prova të tjera në dosje të cilat vërtetojnë fajësinë e NK. Siç është thënë më lart në aktgjykim, ekzistojnë dëshmi nga zhvarrosja dhe ato dhe post mortem të cilat vërtetojnë vdekjen e disa individëve të caktuar (para.108 më lart). Megjithatë, kjo nuk ndihmon në nxjerrjen e përfundimit përta i përket identitetit të kryerësve. Në lidhje me vrasjen e AA, prokuroria i referohet Dëshmitarit Anonim C dhe Dëshmitarit D, por edhe këta dëshmitarë nuk kanë dëshmuar mbi identitetin e kryerësve.

195. Madje edhe sikur dëshmia e AZ të mos ishte përjashtuar, trupi gjykues nuk do të kishte mundur të përcaktonte fajësinë e NK në bazë të asaj dëshmie, duke përdorur Nenin 157(4) KPPK, i cili parasheh se 'gjykata nuk e shpall personin fajtor vetëm mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues'.

196. Trupi gjykues gjen se nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se NK ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, sipas Nenit 390 3) KPPK.

C. NXK

¹⁹³ Aktakuza, fq.28, 29.

¹⁹⁴ Aktakuza, fq.32, 33.

¹⁹⁵ Aktakuza, fq.29, 30, 30, 31. Është shënuar se në faqet 29, 30 të Aktakuzës Prokurori ka cilësuar krimin kundër të burgosurit ushtarak serb si torturë. Megjithatë përta i përket NK akuza nuk përfshin krimin e torturës por në vend të saj 'cënimi i integritetit trupor dhe shëndetit të një burgosuri ushtarak serb' (shih pikën 4 të aktakuzës kundër NK në Aktakuzë, fq.4).

¹⁹⁶ Aktakuza, fq. 27, 28.

197. Aktakuza pretendon se NXK, si anëtar i UÇK-së, dhe në bashkëkryerje me të akuzuar të tjerë të veçantë, ka cënuar integritetin trupor dhe shëndetin e civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë, ndaluar në qendrën e ndalimit në Kleçkë. Trupi gjykues gjen se Dëshmitari Anonim H dhe vëllai i tij i ishin nënshtruar trajtimit mizor në qendrën e ndalimit të UÇK-së Kleçkë, me gjasa në shkurt 1999, dhe SA, dikur në mars 1999 deri më datë 03 prill 1999.

198. Përsa i përket pretendimeve në lidhje me cënimin e integritetit trupor dhe shëndetin e civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë, prokuroria në aktakuzë i është referuar Dëshmitarëve Anonimë B, I, L dhe M, të cilët kishin parë NXK në qendrën e ndalimit në Kleçkë.¹⁹⁷ Duke marrë parasysh këtë, trupi gjykues gjeti se kushtet e ndalimit nuk përbëjnë *per se* trajtim mizor.

199. Trupi Gjykues vëren se akuzat e prokurorisë kundër NXK janë bërë në bazë të pjesëmarrjes aktive në krimet e pretenduara dhe jo në bazë të përgjegjësisë komanduese. Për këtë arsye, trupi gjykues duhet të shyrtojë vetëm përgjegjësinë e NXK në bazë të pjesëmarrjes së tij aktive të pretenduar.

200. Provat tregojnë se rreth dhe gjatë kohës relevante NXK ka vepruar në vende të ndryshme në Kosovë.

201. Në veçanti, BAZ, i cili i është bashkangjitur policisë ushtarake në korrik /gusht 1998 dhe ka qenë i stacionuar në Bellanicë, ka dëshmuar se udhëheqësi i ekipit të tij ka qenë UG, i cili ka raportuar tek NXK. BAZ ka parë UG dhe NXK duke hyrë dhe duke dalë. Më vonë BZ mësoi se NXK ishte stacionuar në 'Kosterc / Nishor', si shefi i policisë ushtarake.¹⁹⁸

¹⁹⁷ Aktakuza, fq.26.

¹⁹⁸ BAZ, supra note 54.

202. Nga deklarata e NXK del se nga dhjetori 1998 ai ishte transferuar në zonën operative të Pashtrikut, në Kasterc (Suharekë), si komandant i policisë ushtarake, dhe Brigada 123 ishte përgjegjëse për atë zonë.¹⁹⁹

203. Dëshmitari A dëshmoi se NXK ishte oficer i policisë ushtarake që vepronte në zonën operative të Pashtrikut. Më tej, Dëshmitarit A i kujtohej se kishte kontaktuar NXK kur A –ja kishte shkuar në burgun Kervasari.²⁰⁰

204. Sipas dëshmisë së BZ, NXK ka qenë anëtar i Brigadës 121, dhe duke filluar nga dhjetori 1998 apo janari 1999 ai ishte komandanti i batalionit të policisë ushtarake, nën komandën e drejtpërdrejtë të drejtorisë së policisë ushtarake udhëhequr nga FL. Batalioni i policisë ushtarake ka qenë i shpërndarë në vende të ndryshme, Divjakë, Berishë dhe Lladroc. Me sa dinte BZ, NXK lëvizte mes këtyre vendeve sipas nevojave.²⁰¹

205. Më tej, provat sugjerojnë se rreth dhe gjatë periudhës relevante kohore NXK është parë në qendrën e ndalimit në Kleçkë.

206. Sipas dëshmimeve të Dëshmitarëve Anonimë L, M, I dhe B, NXK ka kryer disa funksione në qendrën e ndalimit në Kleçkë, përfshirë, edhe në procedurat e zhvilluara kundër anëtarëve të UÇK-së. Megjithatë, asnjë nga dëshmitarët nuk e ka lidhur NXK me trajtimin mizor të disa individëve të caktuar, si p.sh Dëshmitari Anonim H ose vëllai i tij, ose SA.

207. Në veçanti, Dëshmitari Anonim L ka deklaruar se ai ishte anëtar i UÇK-së dhe se në 1999 vendosi t’i bashkëngjitej një brigade tjetër dhe se ishte thirrur në Javor. Kur L-ja kishte arritur në Javor, ai ishte arrestuar nga një ushtar i ri i UÇK-së, anëtar i policisë ushtarake të UÇK-së, dhe ishte dërguar në Kleçkë ku ishte ndaluar. Të nesërmen ai ishte intervistuar nga një ushtar i UÇK-së, ON nga Bellanica. L-së i ishte thënë gjithashtu se ai nuk duhej t’ i ishte

¹⁹⁹ NXK, supra note 63, fq.3.

²⁰⁰ Dëshmitari A, supra note 69, fq.7.

²⁰¹ BZ, supra note 45, fq.5.

bashkangjitur një brigade tjetër pa miratim të mëparshëm. Intervista e L-së ishte ndërprerë nga 'NX', me mbiemër [redacted] ose KR, i cili pas luftës ishte oficer policie në Prizren. Dhe, kishte qenë NX i cili kishte liruar L-në nga qendra e ndalimit të Kleçkës. Gjatë ndalimit të tij, Dëshmitari Anonim L, kishte parë një ushtar tjetër të UÇK-së të burgosur, i cili i kishte thënë L-së se ai ishte rrahur para familjes së tij kur ishte ndaluar. Megjithatë, L-ja nuk kishte parë askënd të rrahur në qendrën e ndalimit në Kleçkë. L-ja gjithashtu nuk kishte parë të burgosur të tjerë në Kleçkë.²⁰²

208. Dëshmitari Anonim I, ish-ushtar i UÇK-së, deklaroi se mes muajit maj 1999 dhe muajit qershor 1999 ai ka qenë i stacionuar në Kleçkë. Ai kishte njohur personalisht një roje burgu, AZ ('MZ'). Dëshmitari Anonim I kishte parë AZ rregullisht në Kleçkë. Në qendrën e ndalimit të Kleçkës ai kishte parë shpesh edhe NXX, i cili komandonte nëntë brigada të policisë ushtarake, duke filluar nga Brigada 121 deri Brigadën 129. Dëshmitari I ka parë shumë ushtarë dhe oficerë të policisë ushtarake të UÇK-së në Kleçkë. Ai kishte dëgjuar se në Kleçkë ishin dërguar shumë persona por ai vetë nuk kishte qenë dëshmitar i asnjë krimi.²⁰³ Në një deklaratë tjetër, Dëshmitari Anonim I deklaroi t' i kujtohej se në muajin prill 1999, kur katër oficerë serbë ishin dërguar në Kleçkë, kishte qenë edhe NXX i cili kishte marrë përsipër oficerët serbë.²⁰⁴

209. Dëshmitari Anonim M dëshmoi se ai kishte qenë civil dhe se ishte arrestuar në muajin mars ose prill 1999 dhe se ishte dërguar në Kleçkë. M-ja ishte marrë në pyetje të njëjtën ditë, përfshirë edhe nga një person të cilin M-ja përshkroi si gjykatës. M-ja ishte kërcënuar me shkopinj druri, por nuk ishte goditur. Një person me maskë qëndronte tek dera dhe kërcënonte M-në se do t'a rrihte. Në një deklaratë të mëvonshme, Dëshmitari Anonim M deklaroi se, pasi gjykatësi përfundoi marrjen në pyetje, një person me maskë kishte qëlluar M-në dy herë në kurriz.²⁰⁵ Nga deklarata e M-së del se në një moment të caktuar NXX kishte ardhur së bashku me gjykatësin, dhe kishte pyetur se pse M-ja dhe disa persona të tjerë të caktuar ishin aty, kishte hapur derën dhe i kishte liruar. M-ja deklaroi se ai kishte dëgjuar individë duke bërëtitur

²⁰² Dëshmitari Anonim L, supra note 111.

²⁰³ Dëshmitari Anonim I, supra note 99.

²⁰⁴ Prova P6, Dëshmitari Anonim I, supra note 100.

²⁰⁵ Dëshmitari Anonim M, supra note 53.

nga kati i mësipërm gjatë marrjes në pyetje. Pasi ishin kthyer, ata dukeshin të rrahur. Megjithatë, M-ja nuk kishte qenë personalisht dëshmitar i rrahjes. Sipas M-së, ai nuk e dinte organizmin dhe strukturën hierarkike të burgut të Kleçkës. Të gjithë ishin me maska përveç gjykatësit. Më vonë, M-ja kishte dëgjuar thashetheme se gjykatësi quhej ON dhe se ai ishte nga Bellanica. M-ja konsideronte se qendra e ndalimit të Kleçkës ishte nën përgjegjësinë FL, i cili kishte në ngarkim Brigadën 121. Ajo vepronte në atë zonë dhe shtabi i Brigadës ishte në Kleçkë. M-ja nuk dinte se kush ishte përgjegjës i burgut.²⁰⁶

210. Trupi gjykues vëren se dëshmia e Dëshmitarit Anonim M flet edhe për praninë e NXK në burgun e Kleçkës rreth kohës kur M-ja kishte dëgjuar disa individë të caktuar duke bërë titur në katin e mësipërm dhe kur kishte vërejtur se disa individë dukeshin të rrahur. Deklarata e Dëshmitarit Anonim M përmban redaktime të shumta sipas masave për të mbrojtur identitetin e dëshmitarit. Nga deklarata e M-së nuk del qartë se kush ishin këta individë, dhe nëse ata mund të kenë qenë Dëshmitari Anonim H, vëllai i tij, ose SA. Dëshmia e M-së nuk është e mjaftueshme për të arritur në një përfundim përse i përket përgjegjësisë së NXK. Gjithashtu, provat e tjera nuk vërtetojnë sjelljen e NXK kur bëhet fjalë për persona të caktuar të cilët i janë nënshtruar një trajtimi mizor, si p.sh Dëshmitari Anonim H, vëllai i tij, ose SA. Sido që të jetë, Trupi Gjykues duhet t'i referohet Nenit 157(3) KPPK i cili do të kufizonte Trupin Gjykues në përcaktimin e fajësisë të të akuzuarit bazuar '... vetëm, ose duke i dhënë rëndësi vendimtare dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar, identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin'.

211. Sipas Dëshmitarit Anonim B, ish-ushtar i UÇK-së, ka gjasa që në muajin maj 1999, ai të ketë qenë i ndaluar në Kleçkë. Kur B-ja kishte hyrë në oborrin e shtëpisë në Kleçkë, kishte parë NXK, të cilin B-ja e njihte si shefi i policisë ushtarake. NXK kishte pyetur B-në se pse ishte aty dhe kush i kishte dhënë leje që të shkonte në majë të malit (para.66 më lart). Më tej B-së i ishte thënë se ai duhet të qëndronte në burg për sa kohë që rasti i tij hetohej. Dëshmitari Anonim B i kujtohej se mbikëqyrësi i burgut ishte AM. Pas pesë apo gjashtë ditësh B-ja ishte sjellë lart, ku

²⁰⁶ Dëshmitari Anonim M, supra note 85.

B-ja kishte parë përsëri NXX me një person tjetër. B-ja kishte shpjeguar edhe njëherë se, kur ishte marrë nga serbët, B-së i ishte dashur t'u tregonte serbëve vendndodhjet e UÇK-së dhe emrat e ushtarëve të UÇK-së të cilët B-ja njihte. Dëshmitari B ishte liruar nga Kleçka pas 21 ditësh, për shkak të rrezikut të një ofensive serbe. Gjatë burgimit të tij në Kleçkë, B-ja nuk kishte qenë dëshmitar i asnjë krimi.²⁰⁷ Përsa i përket Dëshmitarit Anonim B, trupi gjykues vëren se Dëshmitari A i ishte paraqitur një vendim i datës 17 maj 1999, nga gjykata ushtarake e UÇK-së, me anë të të cilit urdhërohej paraburgimi i Dëshmitarit Anonim B nga data 14 maj 1999 deri më datë 14 qershor 1999.²⁰⁸ Dëshmitari A njohu nënshkrimin si i tij, megjithatë atij nuk i kujtohej rasti i veçantë që përfshinte Dëshmitarin Anonim B. Dëshmitari A deklaroi se një dokument të tillë ai do t'ia jepte personit përgjegjës të burgut, pa asnjë dyshim. Megjithatë, A-së nuk i kujtohej emri i personit përgjegjës të burgut të Kleçkës.²⁰⁹ Lidhur me këtë, trupi gjykues vëren se me sa duket A-ja njihte FL, NXX, NK, 'BF' dhe 'FT'.²¹⁰

212. Trupi gjykues vëren se, ndërsa Dëshmitari A thotë se ai ka shkuar rregullisht në burgun e Kleçkës, atij i kujtohet NXX thjesht si oficer i policisë ushtarake në zonën operative të Pashtrikut. Ndërsa dëshmia e Dëshmitarëve Anonimë L, I, M dhe B lart sugjeron se NXX ka ushtruar një autoritet të caktuar në burgun e Kleçkës. Gjthashtu, NB, ish-anëtar i UÇK-së, i është thënë se AJK, AO, AGO dhe DR ishin ndaluar në burgun e Kleçkës. Të katër, përveç AO, i përkisnin policisë ushtarake të UÇK-së. Është përmendur se NXX dhe 'BF' informuan ata se ata ishin të arrestuar dhe i kishin kërkuar të dorëzonin armët e tyre. Më tej, NXX jepte urdhra të burgosurve dhe ushtarëve në burgun e Kleçkës dhe se ishte përgjegjës i burgut.²¹¹

213. Pa marrë parasysh dëshmitë ku thuhet se NXX ka ushtruar një autoritet të caktuar në burgun e Kleçkës, trupit gjykues nuk i lejohet të vazhdojë më tej me ekzaminime shtesë dhe për më tepër nuk mund të arrijë në përfundime të caktuara në lidhje me këtë çështje. Në aktakuzë

²⁰⁷ Dëshmitari Anonim B, supra note 81.

²⁰⁸ Dëshmitari A, supra note 69, shtojcë e deklaratës 0096-09-EWC2/025

²⁰⁹ Dëshmitari A, supra note 69, fq.8, 3.

²¹⁰ Dëshmitari Anonim A, supra note 69, fq.4, 6, 7.

²¹¹ Prova P 17, NB, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë hetimit, PSRK, 12.09.2011, Dosja e Prokurorisë, Prova P 1 - FQ 31.

pretendohet vetëm pjesëmarrja aktive e NXK në krime, dhe trupi gjykues nuk mund të tejkalojë këtë. Në aktakuzë, përveç provave të cilat mund të mbështesin një pretendim të përgjegjësisë komanduese, nuk bëhet një akuzë e tillë kundër NXK. Përsa i përket përgjegjësisë së NXK, trupi gjykues vlerëson se, ndonëse NXK kishte lidhje me burgun e Kleçkës dhe është parë atje, kjo nuk lidh NXK me krime të caktuara të pretenduara, si trajtimi mizor i Dëshmitarëve Anonimë H, vëllait të tij apo SA.

214. Më tej në aktakuzë pretendohet se NXK, duke vepruar në bashkëkryerje, ka vrarë AA; ka torturuar; dhe ka marrë pjesë në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë ndaluar në burgun e Kleçkës; ka cënuar integritetin trupor dhe shëndetin e një të burgosuri ushtarak serb ndaluar në burgun e Kleçkës; dhe pas kësaj ka marrë pjesë në vrasjen e të burgosurit ushtarak serb; dhe ka marrë pjesë në vrasjen e VM dhe ND.

215. Trupi gjykues vëren se Prokuroria ka bazuar fajësinë e NXK në të gjitha këto krime në bazë të dëshmisë së Dëshmitarit Bashkëpunues AZ. Dosja e lëndës nuk përmban prova të tjera të cilat vërtetojnë sjelljen e NXK në kryerjen e këtyre krimeve të pretenduara. Siç është konsideruar më lart në aktgjykim, ekzistojnë dëshmi nga zhvarrosja dhe ato post mortem në lidhje me pretendimet faktike, megjithatë ato prova nuk na japin asnjë sugjerim përse i përket identitetit të kryerësve. Si rezultat, edhe në rast se dëshmia e AZ nuk do të ishte përjashtuar, trupi gjykues do të ishte kufizuar në përcaktimin e fajësisë në bazë të dëshmisë së një dëshmitari të vetëm, si dhe nga Neni 157 (4) KPPK.

216. Trupi gjykues gjen se nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se NXK ka kryer aktet për të cilat akuzohet, sipas Nenit 390 3) KPPK.

D. FL

217. Në aktakuzë pretendohet se FL, në cilësinë e një anëtari dhe komandanti të UÇK-së, dhe si person që ushtron kontroll të përgjithshëm në qendrën e ndalimit të Kleçkës, në bashkëryerje me të akuzuar të tjerë të përmendur, ka cënuar integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të papërcaktuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurish ushtarakë serbë, ndaluar në qendrën e ndalimit të Kleçkës. Duhet të përmendet edhe një herë fakti se trupi gjykues gjeti se kushtet e ndalimit nuk përbënin *per se trajtim mizor*, por se Dëshmitari Anonim H, vëllai i tij dhe SA i ishin nënshtruar trajtimit mizor.

218. Më tej në aktakuzë thuhet se FL, në cilësinë e një anëtari dhe komandanti të UÇK-së, ka torturuar një të burgosur ushtarak serb, ndaluar në qendrën e ndalimit të Kleçkës; dhe ka marrë pjesë në vrasjen e VM dhe ND, dy oficerë serbë ndaluar në qendrën e ndalimit në Kleçkë.

1. Roli i FL në burgun e Kleçkës

219. Në lidhje me rolin e FL në qendrën e ndalimit në Kleçkë, aktakuza pretendon se FL ka komanduar dhe ka ushtruar kontroll të përgjithshëm në qendrën e ndalimit. FL ka qenë shefi i policisë ushtarake të UÇK-së në zonë, ka urdhëruar ku të mbaheshin të burgosurit. Në aktakuzë thuhet se FL ka përdorur fuqitë e tij për të urdhëruar lirim dhe ekzekutimin e disa burgosurve të caktuar.²¹²

220. Trupi gjykues vlerëson se provat tregojnë se gjatë periudhës kohore relevante FL ka qenë shefi i policisë ushtarake të UÇK-së, në shtabin e përgjithshëm të UÇK-së në Divjakë. Para se të marrë këtë post, ai ishte komandanti i Brigadës 121. Zëvendësi i FL ishte HS ('TI'), i cili pas emërimit të FL në shtabin e përgjithshëm të UÇK-së u bë komandanti i Brigadës 121.

221. Trupi gjykues arrin në këto gjetje në bazë të deklaratave të dëshmitarëve të ndryshëm. Në fund të 1998 NM u emërua në shtabin e përgjithshëm të UÇK-së në Divjakë (para.63 më

²¹² Aktakuza, fq.26.

lant). NM dëshmoi se FL ishte fillimisht komandanti i Brigadës 121. Gjatë ristrukturimit të shtabit të përgjithshëm, FL u emërua shefi i policisë ushtarake të UÇK-së dhe zëvendësi i FL, HS, e zëvendësoi si komandanti i Brigadës 121.²¹³

222. Kjo mbështetet edhe nga dëshmia e BZ (paragrafët 61, 63 më lart), i cili ishte shefi i shtabit të UÇK-së, shtabi i përgjithshëm në Divjakë nga muaji janar 1999 deri në mes të prillit 1999. Sipas asaj që tha BZ, FL ishte komandanti i Brigadës 121 dhe zëvendësi i tij ishte HS. Nga muaji janar 1999 deri në prill 1999 FL u emërua shefi i policisë ushtarake të UÇK-së, pas riorganizimit të UÇK-së në nëntor/dhjetor 1998. HS u bë komandanti i Brigadës 121.²¹⁴

223. Edhe dëshmitarë të tjerë, AQ,²¹⁵ AO,²¹⁶ NB,²¹⁷ Dëshmitari G,²¹⁸ IZ,²¹⁹ RI (ish-anëtar i Brigadës 121),²²⁰ FK (ish-anëtar i policisë ushtarake të UÇK-së),²²¹ thanë se gjatë apo rreth periudhës kohore relevante HS ishte komandanti i Brigadës 121. BZ dëshmoi se 'BF' si anëtar i Brigadës 121 ishte fillimisht nën komandën e FL dhe më pas HS.²²²

224. Përveç provave të përmendura më lart, ka prova të tjera të cilat vërtetojnë se policia ushtarake e UÇK-së ka vepruar gjithashtu në bazën e UÇK-së në Kleçkë. Sipas Dëshmitarit Anonim I, policia ushtarake e UÇK-së ka qëndruar në katin e mësipërm të bazës së UÇK-së në Kleçkë.²²³ Sipas dëshmisë së Dëshmitarit A, policia ushtarake e UÇK-së ka mbajtur burgun e Kleçkës nën kontroll fizik.²²⁴ Siç është thënë më lart në aktgjykim (para.76) Dëshmitari D, ish-ushtar në ushtrinë serbe, ishte ndaluar gjithashtu 10 ditë në burgun e Kleçkës në mars 1999. Në Kleçkë D-ja kishte parë shumë ushtarë të UÇK-së. D-ja kishte parë personalisht një ushtarë

²¹³ NM, supra note 66.

²¹⁴ BZ, supra note 45, fq.2, 3, 4; gjithashtu BAZ, supra note 54, fq.3.

²¹⁵ AQ, supra note 45, fq.3, 4, 5.

²¹⁶ AO, supra note 45, fq.3.

²¹⁷ Prova P 17, NB, supra note 211, fq.2.

²¹⁸ Dëshmitari G, supra note 45, fq.3.

²¹⁹ IZ, supra note 60, fq.3.

²²⁰ RI, 24.05.2011, marrje në pyetje-deklaratë e dëshmitarit para policisë së EULEX-it, fq.3, PSRK dosja D.

²²¹ FK, supra note 56, fq.4, 5.

²²² BZ, supra note 45, fq.5.

²²³ Dëshmitari Anonim I, supra note 99, fq.5.

²²⁴ Dëshmitari A, supra note 69.

të UÇK-së duke rrahur 'SH' (para.76 më lart). Ushtarja e përmendur kishte një uniformë kamuflazhi por kishte një emblemë në krah, ku ishte shkruar në gjuhën shqipe 'policia ushtarake'. Sipas D-së, ajo ishte oficere e policisë ushtarake.²²⁵ Dëshmitari Anonim B tha se i kujtohej se kur ai ishte ndaluar në burgun e Kleçkës, ishte një oficer policie 'FE' i cili ruante personat e ndaluar.²²⁶

225. Sipas dëshmisë së FK, i cili ishte caktuar në policinë ushtarake në fillim të 1999, ai nuk ka ruajtur kurrë të burgosur, por ka patur mundësi që çdokush nga anëtarët e policisë ushtarake ka ruajtur të burgosurit në bazën e UÇK-së në Kleçkë.²²⁷

226. Provat tregojnë gjithashtu se policia ushtarake e UÇK-së mund të ketë patur në ngarkim zhvillimin e hetimeve. Dëshmitarit A i kujtohet rasti i SA. Thuhej se SA se ai ishte drejtor burgu në Vushtrri ose Mitrovicë dhe se kishte torturuar shumë të burgosur politikë. Sipas Dëshmitarit A, rasti i SA nuk arriti kurrë tek A-ja, dhe ishin vetëm hetuesit, domethënë, policia ushtarake e UÇK-së, e cila punoi në këtë rast.²²⁸

227. Siç është konsideruar më lart, provat kanë treguar gjithashtu se NXX, si anëtar i policisë ushtarake të UÇK-së, ka qenë në bazën e UÇK-së në Kleçkë.

228. Më tej, provat sugjerojnë se anëtarët e policisë ushtarake të UÇK-së kanë transportuar të ndaluar në dhe nga Kleçka. Dëshmitari A dëshmoi se policia ushtarake e UÇK-së kishte dërguar në burgun e Kleçkës vëllezërit KR, të cilët akuzoheshin për bashkëpunim me serbët. Dëshmitarit A i kujtohej gjithashtu se ka patur mundësi që ai të ketë kërkuar nga policia ushtarake e UÇK-së që të sillnin BKU për marrje në pyetje shtesë për pretendime që kishin të bëjnë me dezertim.²²⁹ AH, i cili i përkiste policisë ushtarake të UÇK-së, tha se i kujtohej se

²²⁵ Dëshmitari D, 24.12.2010, marrje në pyetje-deklaratë e dëshmitarit para policisë së EULEX-it, fq.5, 6, PSRK dosja C.

²²⁶ Dëshmitari Anonim B, supra note 81, fq.5.

²²⁷ FK, supra note 56, fq.4, 5.

²²⁸ Dëshmitari A, supra note 69.

²²⁹ Dëshmitari A, supra note 69.

njëherë kishte shoqëruar një ushtar të arrestuar tek Dëshmitari A.²³⁰ Dëshmitari V, ish-anëtar i UÇK-së, i cili ka shërbyer gjithashtu në Brigadën 121, dëshmoi se policia ushtarake ishte përgjegjëse për transferimin e të burgosurve nga burgu i përkohshëm në Shalë në burgun e Kleçkës.²³¹ Një metodë e tillë veprimi shihet gjithashtu edhe për vende të tjera. Në veçanti, sipas dëshmisë së BZ qendra disiplinore në Lladroc ishte nën përgjegjësinë e gjykatës ushtarake të UÇK-së, por policia ushtarake e UÇK-së ruante burgun dhe të burgosurit.²³²

229. Përsa i përket nivelit të komandës ushtroar nga FL lidhur me qendrën e ndalimit të Kleçkës, Trupi Gjykes vëren se Dëshmitari Anonim I ka deklaruar se ai ka parë FL disa herë në Kleçkë në 1999, dhe FL ishte i vendosur në ndërtesën ku ishte kuzhina.²³³ Në të njëjtën kohë provat tregojnë se anëtarë të ndryshëm të UÇK-së të cilët në raste të ndryshme janë identifikuar si persona përgjegjës të burgut në Kleçkë ose duke dhënë urdhra për të ndaluar, liruar apo ekzekutuar individë të caktuar. Në shumë raste dëshmitarët kanë dëshmuar se nga ata kërkohej ose të raportonin në Kleçkë ose ishin ndaluar në Kleçkë, megjithatë, dëshmitarët nuk kanë thënë diçka gjatë dëshmisë së tyre e cila do të mundësonte Trupin Gjykes të përcaktonte se kjo ishte nën përgjegjësinë komanduese të FL.

230. Në veçanti, Dëshmitari A ishte shefi i departamentit ligjor në shtabin e përgjithshëm të UÇK-së në Divjakë dhe ka drejtuar gjithashtu gjykime ushtarake si gjykatës. Sipas dëshmisë së Dëshmitarit A, BKU, ish-komandant i brigadës së UÇK-së, ishte arrestuar dhe sjellë tek Dëshmitari A. BKU i kishte thënë A-së se e gjithë brigada e tij kishte dezertuar dhe ishte larguar për në Shqipëri. Duke patur parasysh rëndësinë e rastit, A-ja dënoi BKU me vdekje, me pushkatim. Megjithatë atëherë filloi ndërhyrja e NATO-s dhe A-ja mori përsipër përgjegjësinë për të mos ekzekutuar dënimin e tij dhe vendosi se BKU meritonte një shans tjetër. BKU u lirua dhe më pas luftoi trimërisht.²³⁴ Në këtë proces nuk është bërë asnjë referencë ndaj rolit të FL.

²³⁰ AH, supra note 67, p.3.

²³¹ Dëshmitari V, supra note 79.

²³² BZ, supra note 45.

²³³ Dëshmitari Anonim I, supra note 99, fq.6.

²³⁴ Dëshmitari A, supra note 69, fq.5.

231. Dëshmitarit E, i cili ka punuar së bashku me Dëshmitarin A, i kujtohej se A-ja i kishte treguar atij historinë e BKU dhe se BKU ishte burgosur. Dëshmitari A ishte shumë i shqetësuar në lidhje me situatën e BKU, dhe kishte pyetur E-në se çfarë duhet të bënin për BKU.²³⁵

232. Edhe BZ i kujtohej rasti i BKU. Sipas BZ ishte marrë vendimi për arrestimin e BKU dhe sjelljen e tij para gjykatës ushtarake duke ditur se sa rëndë pretendohet se BKU kishte thyer rregullat ushtarake.²³⁶ BZ nuk ishte i sigurt se ku ishte mbajtur BKU. Pas ndërhyrjes së NATO-s filloi ofensiva serbe. Meqenëse forcat serbe po shkelnin vijën e frontit, Dëshmitari A kishte pyetur BZ mbi ushtarët të cilët në atë kohë ishin në paraburgim, përfshirë BKU. BZ kishte këshilluar se ata duhet të lireshin të lirë dhe se rastet e tyre do të shqyrtoheshin pas luftës. Dëshmitari A kishte të njëjtin mendim.²³⁷

233. Më tej, pasi A-ja kishte mësuar mbi burgimin e dy ushtarëve serbë në burgun e Kleçkës, A-ja kishte shkuar për t' i vizituar në qendrën e ndalimit në Kleçkë. Trupi Gjykues gjeti se dy të burgosurit ishin Dëshmitari Anonim H dhe vëllai i tij. A-ja deklaroi se ai u këshillua me BZ për lirim të H-së dhe vëllait të tij, dhe urdhëroi që të dy të burgosurit t' i dorëzoheshin OSBE-së.²³⁸ Trupi Gjykues vëren se sipas Dëshmitarit Anonim H, personi i cili kishte vizituar H-në dhe vëllain e tij pas rrahjes, i kishte thënë H-së se ai nuk e dinte se ata ishin marrë nga UÇK-ja. Dëshmitari Anonim H mendonte se duke thënë këtë ky person la të kuptonte se ai do të kishte mundur të bënte diçka nëse ai do t' a kishte ditur se H-ja dhe vëllai i tij ishin marrë nga UÇK-ja.²³⁹

234. Përsa i përket qendrës së ndalimit të UÇK-së në Kleçkë, AQ, ish-anëtare e UÇK-së, dëshmoi se me sa duket HS ishte përgjegjës i shtëpisë në Kleçkë.²⁴⁰ Megjithatë Dëshmitari A në deklaratën e tij iu referua drejtorit të burgut të Kleçkës, A-ja nuk dëshmoi mbi identitetin e

²³⁵ Dëshmitari E, supra note 45, fq.4.

²³⁶ BZ, supra note 45, fq.4.

²³⁷ BZ, supra note 45, fq.5.

²³⁸ Dëshmitari A, supra note 69, fq.5.

²³⁹ Dëshmitari Anonim H, supra note 123, fq.9.

²⁴⁰ AQ, supra note 45, fq.5.

drejtorit. Lidhur me HS, A-ja tha se A-ja nuk njihte askënd me emrin HS, por A-së i kujtohej 'TI', i cili në atë kohë ishte komandant. Dëshmitari A kishte parë 'TI' në Kleçkë.²⁴¹

235. Dëshmitari V dëshmoi se ai ka qenë i ndaluar në burgun e Kleçkës për 56 ditë dhe qëndroi së bashku me BKU. Sipas Dëshmitarit V, komandanti dhe drejtori i burgut ishte 'MZ', me emrin AM,²⁴² dhe HS dhe 'MZ' kontrollonin kush hynte dhe dilte nga burgu. Në lidhje me këtë Trupi Gjykses vëren se Dëshmitarit A i kujtohej 'MZ' si ushtar i thjeshtë dhe A-ja njihte emrin e AZ por nuk mund të lidhte emrin me fytyrën.²⁴³ Ndërsa, përsa i përket Dëshmitarit Anonim I, i cili ishte i stacionuar në Kleçkë rreth muajit 1999, qershor 1999, AZ ('MZ') ishte roje e burgut Kleçka. AZ kishte veshur uniformë të zezë me emblemat e policisë ushtarake në krahun e majtë. Një roje tjetër burgu ishte AK.²⁴⁴ Më tej, sipas dëshmisë së Dëshmitarit Anonim C, ai ishte liruar nga burgu Kleçka nga 'MZ' [name redacted]. C-ja mendonte se 'MZ' ishte drejtori i burgut. Gjithashtu edhe në bazë të dëshmisë së C-së, të burgosurit merreshin nga bodrumi dhe dërgoheshin lart për marrje në pyetje nga një person të cilin C-ja dëgjoji se dikush e thirri 'komandant H'.²⁴⁵ Dëshmitari Anonim B deklaroi se mbikëqyrësi i burgut ishte AM.²⁴⁶

236. Gjatë ndalimit të tij, V-ja ishte marrë në pyetje dy herë nga FL, HS, Dëshmitari A dhe 'MZ'. Dëshmitari A vepronte në cilësinë e gjykatësit kurse FL dhe HS ishin akuzuesit. V-ja mbrohej nga një avokat nga Peja. Procedura ishte zhvilluar në Novosellë në një ndërtesë private. Pas procedurës V-ja kishte shkuar direkt në shtëpi.²⁴⁷

237. Sipas dëshmisë së V-së, BKU ishte marrë në pyetje nga Dëshmitari A, FL, por shumicën e kohës nga HS ('TI'). Një ditë BKU kishte marrë një letër për të cilën V-ja kishte menduar se ishte letra e dënimit me vdekje. Sipas V-së, i vetmi person i cili kishte autoritet për të shkruar një letër të tillë ishte Dëshmitari A. V-së i kujtohej gjithashtu rrahja e një djali të ri, rreth 17 vjeç, i

²⁴¹ Dëshmitari A, supra note 69.

²⁴² Dëshmitari V, supra note 79, fq.6, 10.

²⁴³ Dëshmitari A, supra note 69, fq.8.

²⁴⁴ Dëshmitari Anonim I, supra note 99, fq.5, 6.

²⁴⁵ Dëshmitari Anonim C, supra note 84, fq.5.

²⁴⁶ Dëshmitari Anonim B, supra note 81, fq.5.

²⁴⁷ Dëshmitari V, supra note 79.

cili kishte vjedhur disa gjëra. Dëshmitari ka dëgjuar djalin e ri duke u rrahur. Djali i ri ka thënë se ai ishte rrahur nga BH, i cili po ashtu ruante të burgosurit.²⁴⁸

238. Dëshmitarit G i kujtohej një ish-anëtar i Brigadës 121, se ai ishte thirrur për intervistë në Kleçkë për shkak të një mosmarrëveshjeje apo zënieje që ai kishte patur me disa persona të tjerë. Komandant HS ('TI') i kishte detyruar ata që t'i jepnin dorën njëri tjetrit dhe u kishte thënë se ata nuk duhet të luftonin me njëri tjetrin.²⁴⁹

239. Duke patur parasysh provat e përmendura Trupi Gjykues vlerëson se në burgun e Kleçkës kanë qenë aktivë individë të ndryshëm.

240. Përsa i përket FL, Dëshmitari A ka dëshmuar se ai kishte dëgjuar se vëllezërit KR ishin liruar nga burgu i Kleçkës nga FL dhe vetëm FL kishte fuqi të tilla duke qenë shefi i policisë ushtarake.²⁵⁰ Edhe Dëshmitari T deklaroi se njëri nga vëllezërit e ndaluar, NXX, (para.99 më lart) i kishte thënë se ai ishte liruar nga FL.²⁵¹ Trupi gjykues vëren se prova e përmendur bazohet në thashetheme. Një pohim i tillë është bërë edhe nga ana e Dëshmitarit Anonim M, i cili mendonte se FL kishte funksione të ndryshme në qendrën e ndalimit. Njëkohësisht, Dëshmitari Anonim M deklaroi se ai nuk e dinte se kush ishte përgjegjës i burgut dhe nëse ai mund të quhej burg sepse ishte thjesht një shtëpi.²⁵²

241. Në lidhje me deklaratat e Dëshmitarit A, Dëshmitarit T dhe Dëshmitarit Anonim M, Trupi Gjykues vëren se dëshmitarët nuk kanë siguruar prova se ata kanë parë FL duke dhënë udhëzime dhe urdhra apo duke ushtruar fuqi disiplinore në Kleçkë.

242. Më tej, Trupi Gjykues vëren se Dëshmitari Anonim I dëshmoi se kur katër ushtarë të UÇK-së sollën në Kleçkë në prill 1999 katër oficerë serbë dhe kur policia ushtarake i mori ata

²⁴⁸ Dëshmitari V, supra note 79.

²⁴⁹ Dëshmitari G, supra note 45, fq.3.

²⁵⁰ Dëshmitari A, supra note 69, fq.4.

²⁵¹ Dëshmitari T, supra note 122, fq.5.

²⁵² Dëshmitari Anonim M, supra note 85, fq.5.

përsipër atë ditë në Kleçkë ishte i pranishëm edhe FL. Sipas Dëshmitarit Anonim I, ai kishte parë FL në kuzhinë, megjithatë ai nuk e dinte nëse FL ishte marrë me këta të burgosur apo jo.²⁵³

243. Duke patur parasysh atë që u tha, provat nuk vërtetojnë përtej dyshimit të arsyeshëm se FL dinte apo se kishte arsye të dinte se persona të caktuar, si p.sh Dëshmitari Anonim H, vëllai i tij apo SA, do t'i nënshtroheshin trajtimit mizor apo se i ishin nënshtuar trajtimit mizor; dhe se FL ka dështuar të marrë masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar krimet apo për të ndëshkuar kryerësit e këtyre veprave.

244. Aktakuza i referohet gjithashtu edhe pozitës së FL si shefi i policisë ushtarake të UÇK-së të zonës.²⁵⁴ Megjithatë vetëm kjo nuk është e mjaftueshme. Përgjegjësia komanduese bazohet në **fuqinë që ka** eprori për të kontrolluar veprimet e vartësve të tij, dhe duke pasur **aftësinë materiale** për të parandaluar dhe ndëshkuar sjellje kriminale.²⁵⁵ Në këtë rast, provat e paraqitura nuk vërtetojnë se FL ka ushtruar fuqi komanduese mbi funksionimin e qendrës së ndalimit në Kleçkë për të bërë atë përgjegjës për sa i përket trajtimit mizor të individëve të caktuar.

245. Trupi Gjykses vëren se shumë shpesh ka ngelur e paqartë se kush ka dhënë urdhër për arrestimin dhe mbajtjen e personave të caktuar në burgun e Kleçkës.

246. Dëshmitari A nuk e dinte se kush kishte arrestuar BKU dhe ku ishte mbajtur BKU deri sa ishte sjellë tek Dëshmitari A.²⁵⁶ E njëjta gjë është deklaruar nga Dëshmitari E.²⁵⁷

247. BEK i kujtohej se në pranverë të vitit 1999 forcat e UÇK-së ishin detyruar të tërhiqen nga forcat serbe, dhe UÇK-ja arriti në fshatin e BEK. UÇK-ja u vendos në një shtëpi në lagje. Pasi

²⁵³ Prova P6, Dëshmitari anonim I, supra note 100.

²⁵⁴ Aktakuza, fq.26.

²⁵⁵ Prokurori k. Zejnil Delalić, Zdravko Mucić, njohur si 'Pavo', Hazim Delić, Esad Landžo, njohur si 'Zenga', TPNJ, Aktgjykimi, 16.11.1998, para.377.

²⁵⁶ Dëshmitari A, supra note 69, fq.5.

²⁵⁷ Dëshmitari E, supra note 45, fq.4.

kupton BEK se shtëpia ishte mbushur përplot, ai propozon që një grup i ushtarëve të UÇK-së të shkojnë në shtëpinë e tij. Ushtarët e UÇK-së hynë në shtëpinë e tij duke e thyer derën, dhe BEK u përlesh me një nga ushtarët e UÇK-së i cili e theu derën. Pas disa ditëve policia ushtarake e UÇK-së erdh te BEK dhe kërkoi nga ai të shkojë në Kleçkë për të dhënë deklaratë. BEK arriti në bazën e UÇK-së në Kleçkë dhe kontaktoi njërin nga ushtarët aty, i cili u mundua ta godas me shuplakë, por ushtarët tjerë i thanë të mos e bëj këtë. Pas kësaj, një nga ushtarët e UÇK-së i thotë BEK që të lajmërohet në shtab çdo tri orë.²⁵⁸

248. Dëshmitari N ka dëshmuar se pas intervenimit të NATO-s, ndoshta, në maj të vitit 1999, ai është ndaluar nga UÇK-ja dhe është dërguar në një shtëpi në Kleçkë apo në Berishë. Aty, Dëshmitari N ishte vendosur në bodrum. Pas tre ditësh dëshmitari N është sjellë në katin më lartë për t'u intervistuar. Dëshmitari N nuk e ka ditur se kush ishte komandant i shtabit të UÇK-së.

249. AO, ish pjesëtar i UÇK-së, ka deklaruar se rreth 45 ditë pas fillimit të intervenimit të NATO-s ushtarët e UÇK-së kërkuan që ai të shkon në Kleçkë dhe t'i raportonte 'TI' lidhur me akuzimet për lëndimin e një civili. Gjatë kohës në shtabin në Kleçkë, AO nuk e kishte pa 'TI'. AO ishte marrë në pyetje nga tre deri katër ushtarë të UÇK-së. AO insistoi që t'i jepet vendimi me shkrim lidhur me akuzat kundër tij. Megjithatë, AO, nuk i është dhënë asnjë vendim i tillë zyrtarë, dhe ai ishte liruar të nesërmen.²⁵⁹

250. Dëshmitari F ka dëshmuar se në mars të vitit 1999 ai ishte arrestuar nga pjesëtarë të UÇK-së, me uniforma të zeza, dhe ishte dërguar me makinë në shtabin e UÇK-së në Kleçkë. Njerëzit që arrestuan Dëshmitarin F nuk u prezantuan. Ishte mbajtur në Kleçkë për shkak të thashethemeve se është kundër UÇK-së. Aty, në Kleçkë, ishte marrë në pyetje nga katër deri pesë persona dhe ishte nxjerrë si përfundim se mbajtja e Dëshmitarit F kishte ndodhur për

²⁵⁸ BEK, supra note 45.

²⁵⁹ AO, supra note 45, faqe.3, 4, 5.

shkak të keqkuptimit. Dëshmitari F nuk kishte njohur asnjë nga personat që e arrestuan atë, as rojet, dhe as personat që e kishin marrë në pyetje.²⁶⁰

251. Dëshmitari Anonim B ka dëshmuar, gjithashtu, se ai nuk e ka ditur se kush ishin oficerët e policisë ushtarake të UÇK-së të cilët kishin ardhur te Dëshmitari B dhe të cilët kishin kërkuar nga ai që të lajmërohet në Kleçkë.²⁶¹

2. Përgjegjësia e FL

252. Duke marrë parasysh çfarë u tha më lartë, trupi gjykues gjen se dëshmitë e përmendura nga Prokuroria nuk provojnë përtej dyshimit të arsyeshëm se FL ka mbajtur përgjegjësi të lartë mbi qendrën e ndalimit në Kleçkë dhe kështu ta bëj atë përgjegjës për trajtimin mizor të personave të caktuar, sikurse ishin Dëshmitari Anonim H, vëllai i tij, apo SA. Dëshmitë, gjithashtu, nuk vërtetojnë pjesëmarrjen aktive të FL në trajtimin mizor të personave të caktuar, përfshirë Dëshmitarin Anonim H, vëllain e tij apo SA.

253. Për më tepër, nuk ka dëshmi, përveç dëshmisë së Dëshmitarit Bashkëpunues AZ, që lidhë FL me torturimin e pretenduar të një të burgosuri ushtarak serb; dhe me vrasjen e VM dhe ND.

254. Trupi gjykues vëren se përsa i përket pjesëmarrjes aktive të FL në torturimin e të burgosurit ushtarak serb; dhe vrasjen e VM dhe ND, aktakuza mbështetet ekskluzivisht në dëshminë e Dëshmitarit Bashkëpunues AZ.²⁶²

255. Siç është marrë parasysh më herët ekzistojnë dëshmi *post mortem* të cilat dëshmojnë për vdekjen e personave të specifikuar (para. 108 më lartë). Megjithatë, nuk ka dëshmi tjera mbi identitetin e kryerësve. Kështu, madje edhe me dëshmitë e Dëshmitarit Bashkëpunues AZ në

²⁶⁰ Dëshmitari F, supra note 80, f.3.

²⁶¹ Dëshmitari anonim B, supra note 81, f.4.

²⁶² Aktakuza, faqe.27, 29, 30.

dosje, trupi gjykues nuk do të ishte në gjendje të merrte vendim mbi fajësinë, në veçanti, duke patur parasysh nenin 157(4) të KPPK-së.

256. Trupi gjykues gjen se nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se FL ka kryer aktet për të cilat akuzohet, sipas nenit 390 3) KPPK.

E. NS

257. Në aktakuzë pretendohet se NS, në cilësinë e një anëtarit të UÇK-së që mbante pozitë me përgjegjësi në qendrën e ndalimit në Kleçkë, në bashkëkryerje me të akuzuarit e përmendur ka cënuar integritetin trupor dhe shëndetin e civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë, të mbajtur në qendrën e ndalimit në Kleçkë. Ishte konstatim i trupit gjykues se kushtet e ndalimit *per se* nuk përbëjnë trajtim mizor, dhe se Dëshmitari Anonim H, vëllai i tij dhe SA i janë nënshtruar trajtimit mizor në burg në Kleçkë nga personat e emëruar në aktakuzë.

258. Për më tepër, aktakuza pretendon se NS në bashkëkryerje me të akuzuar tjerë të përmendur, ka torturuar katër të burgosur ushtarakë serbë, të mbajtur në qendrën e ndalimit në Kleçkë; ka vrarë një të burgosur ushtarak serb, të mbajtur në qendrën e ndalimit në Kleçkë; ka marrë pjesë në vrasjen e AA; dhe ka marrë pjesë në vrasjen e VM dhe ND.

1. Roli i NS në burgun e Kleçkës

259. Sa i përket rolit të NS në qendrën e ndalimit në Kleçkë, aktakuza pretendon se NS ka qenë në mesin e atyre që ishin përgjegjës për udhëheqjen e burgut, duke përfshirë pranimin dhe regjistrimin e të burgosurve. Të burgosur të caktuar i janë dorëzuar në përgjegjësi NS me të arritur në burg.²⁶³

²⁶³ Aktakuza, f.25.

260. Disa dëshmitarë e kujtojnë NS ('FT'). QK e njihte NS si anëtar të UÇK-së.²⁶⁴ Dëshmitari A e njohu nofkën 'FT', por nuk e dinte emrin e tij të vërtetë. Dëshmitari A e kishte parë 'FT' shumë shpesh në Kleçkë.²⁶⁵ BZ e kujton 'FT' si një oficer në komandën e Brigadës 121.²⁶⁶ Dëshmitari Anonim I, kishte parë 'FT', me emrin N, në dy raste në Divjakë. Sipas Dëshmitari Anonim I, 'FT' ka qëndruar në kazermë por gjithashtu i lejohej të hynte në shtabin e përgjithshëm.²⁶⁷

261. Në një deklaratë tjetër, Dëshmitarit Anonim I i kujtohet që në prill të vitit 1999, kur u sjellën katër oficerë serbë në Kleçkë, ishte po ashtu oficeri i policisë ushtarake NS ('FT') i cili mori në ngarkim oficerët serbë.²⁶⁸

262. Nuk ka dëshmi më tej, përveç dëshmisë së Dëshmitarit Bashkëpunues AZ, mbi lidhjen e NS me qendrën e ndalimit në Kleçkë.

2. Përgjegjësia e NS

263. Duke patur parasysh atë që u cekë më parë trupi gjykues gjen se dëshmitë nuk arrijnë të vërtetojnë përtej dyshimit të arsyeshëm se NS ka mbajtur një pozitë me përgjegjësi në qendrën e ndalimit në Kleçkë siç pretendohet në aktakuzë. Dëshmitë e paraqitura nga Prokuroria nuk provojnë përtej dyshimit të arsyeshëm se NS ka mbajtur përgjegjësi të lartë në qendrën e ndalimit në Kleçkë ashtu që të bëj atë përgjegjës për trajtimin mizor të personave të caktuar, siç janë Dëshmitarin Anonim H, vëllain i tij, apo SA.

264. Në pretendimet se NS ka marrë pjesë në torturimin e katër të burgosurve ushtarakë serbë; ka marrë pjesë në vrasjen e katër të burgosurve ushtarë serbë, të mbajtur në qendrën e

²⁶⁴ QK, supra note 47, f.4.

²⁶⁵ Witness A, supra note 69, f.7.

²⁶⁶ BZ, supra note 45, f.5.

²⁶⁷ Dëshmitari anonim I, supra note 99, f.6.

²⁶⁸ Prova P6, Dëshmitari anonim I, supra note 100, f.2.

ndalimit në Kleçkë; ka vrrarë një të burgosur ushtarak serb, të mbajtur bë qendrën e ndalimit në Kleçkë; ka marrë pjesë në vrasjen e AA; dhe ka marrë pjesë në vrasjen e VM dhe ND, aktakuza mbështetet në dëshmitë e Dëshmitarit Bashkëpunues AZ.²⁶⁹ Nuk ka dëshmi të mëtejme që vërtetojnë sjelljen e NS në kryerjen e këtyre krimeve.

265. Siç është marrë parasysh më herët ekzistojnë dëshmi *post mortem* të cilat dëshmojnë për vdekjen e personave të specifikuar (para. 108 më lartë). Megjithatë, nuk ka dëshmi tjera mbi identitetin e kryerësve. Kështu, madje edhe me dëshmitë e Dëshmitarit Bashkëpunues AZ në dosje, trupi gjykues nuk do të ishte në gjendje të merrte vendim mbi fajësinë, në veçanti, duke patur parasysh nenin 157(4) të KPPK-së.

266. Trupi gjykues gjen se nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se NS ka kryer aktet për të cilat akuzohet, sipas nenit 390 3) KPPK.

267. Duke patur parasysh atë që u cek më parë, dëshmitë e paraqitura nga Prokuroria nuk arrijnë të vërtetojnë fajësinë e të akuzuarit përtej dyshimit të arsyeshëm. Prandaj, i akuzuari shpallet i pafajshëm për të gjitha akuzat kundër tij.

VII. SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE DHE KËRKESA PRONËSORE

268. Me që të akuzuarit janë shpallur të pafajshëm, shpenzimet e procedurës penale sipas nenit 99 (2) 1) deri te 5) të KPPK, shpenzimet e domosdoshme të të pandehurve dhe kompensimi dhe shpenzimet e domosdoshme të avokatit mbrojtës, gjithashtu dhe shpenzimet e përkthimit me shkrim dhe me gojë, do të paguhen nga burimet buxhetore në bazë të tarifave që janë në zbatim, në pajtim me nenin 103(1) të KPPK.

²⁶⁹ Aktakuza, faqet.28, 29, 30, 31, 32, 33.

269. Nuk është parashtruar asnjë kërkesë pronësore. Për këtë arsye nuk është marrë vendim, në pajtim me nenin 396 (4) të KPPK.

Kryetari i Trupit Gjykses:

Procesmbajtëse:

Gjykatësi i EULEX-it Jonathan Welford-Carroll

Zyrtare ligjore e EULEX-it

Zane Ratniece

Anëtarët e Trupit Gjykses:

Gjykatësja Shqipe Qerimi

Gjykatësi i EULEX-it Dean

Pineles

MJET LIGJOR: Në pajtim me Nenin 398 (1) KPPK, personat e autorizuar kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë me shkrim kundër këtij Aktgjykimi pranë Gjykatës Supreme të Kosovës përmes Gjykatës së Qarkut Prishtinë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e marrjes së kopjes së Aktgjykimit.

SHTOJCA I

PROVAT E PARASHTRUARA NGA PROKURORIA

(PSRK dosja B)

- 1) **Dëshmitari Y**, 20.4.2012, PSRK procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit, PSRK dosja B.
- 2) **Dëshmitari Anonim C**, 21.09.2010, PSRK procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë hetimit, PSRK dosja B.
- 3) **Dëshmitari Anonim I**, 22.11.2010, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, PSRK, dosja B.
- 4) **Dëshmitari A**, 23.09.2010, PSRK procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë hetimit me shtojca, PSRK dosja B.
- 5) **Dëshmitari F**, 02.01.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, PSRK dosja B.
- 6) **BKU**, 04.10.2010 dhe 15.10.2010, PSRK procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë hetimit me shtojcë, PSRK dosja B.
- 7) **Dëshmitari E**, 28.10.2010, PSRK procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë hetimit, PSRK dosja B.
- 8) **Dëshmitari Anonim B**, 04.12.2010, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, PSRK dosja B.
- 9) **Dëshmitari G**, 11.01.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, PSRK dosja B.
- 10) **Dëshmitari Anonim H**, 24.08.2010, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, PSRK dosja B.

(PSRK dosja C)

- 11) **QK**, 14.06.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, PSRK dosja C.
- 12) **AQ**, 07.06.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojcë, PSRK dosja C.
- 13) **Dëshmitari T**, 03.05.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, PSRK dosja C.
- 14) **Dëshmitari D**, 24.12.2010, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit; 18.01.2011, procesverbal i PSRK i dëgjimit të dëshmitarit në një hetim, PSRK dosja C.
- 15) **Dëshmitari V**, 18.04.2011, intervistë në cilësinë e një dëshmitari me shtojcë, PSRK dosja C.
- 16) **HAB**, 08.04.2011, PSRK, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë hetimit, PSRK, dosja C.
- 17) **IA**, 07.04.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, PSRK dosja C.
- 18) **NAM**, 06.04.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, PSRK dosja C.
- 19) **NM**, 05.04.2011, PSRK procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë hetimit me shtojca, PSRK dosja C.
- 20) **BZ**, 05.04.2011, PSRK procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë hetimit me shtojca, PSRK dosja C.
- 21) **DD**, 04.04.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, PSRK dosja C.
- 22) **ZK**, 01.04.2011, PSRK procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë hetimit me shtojca, PSRK dosja C.
- 23) **BEK**, 08.01.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, PSRK dosja C.
- 24) **Dëshmitari N**, 04.01.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, PSRK dosja C.
- 25) **Dëshmitari O**, 24.12.2010, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, procesverbal i PSRK i dëgjimit të dëshmitarit dosja C, SPRK dosja C.
- 26) **Dëshmitari R**, 22.12.2010, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, PSRK dosja C.
- 27) **NH**, 02.12.2010, marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, PSRK dosja C.

- 28) **AO**, 30.11.2010, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, PSRK dosja C.
- 29) **HK**, 20.10.2010, PSRK procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit në një hetim, PSRK, dosja C.
- 30) **BT**, 08.10.2010, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, PSRK dosja C.
- 31) **JU**, 24.08.2010, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, PSRK dosja C.
- 32) **GB**, 24.08.2010, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, PSRK dosja C.

(PSRK dosja D)

- 33) **Dëshmitari Anonim L**, 12.04.2011, PSRK procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë një hetimi, PSRK dosja D.
- 34) **Dëshmitari Anonim M**, 30.03.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit; 20.05.2011, procesverbal i PSRK i dëgjimit të dëshmitarit gjatë një hetimi, të dyja dosja D PSRK.
- 35) **AH**, 14.12.2010, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit; 27.05.2011, procesverbal i PSRK i dëgjimit të dëshmitarit gjatë një hetimi, të dyja dosja D PSRK.
- 36) **SB**, 27.05.2011, PSRK procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë një hetimi, dosja D PSRK.
- 37) **Dëshmitari U**, 25.06.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, PSRK dosja D.
- 38) **Dëshmitari W**, 16.06.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, PSRK dosja D.
- 39) **IZ**, 19.05.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, PSRK dosja D.
- 40) **BAZ**, 23.05.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, PSRK dosja D.
- 41) **ST**, 25.05.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, PSRK dosja D.
- 42) **RI**, 24.05.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, PSRK dosja D.
- 43) **FK**, 31.05.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, PSRK dosja D.

- 44) **ZS**, 18.05.2011 raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit; 23.07.2011 procesverbal i PSRK i dëgjimit të dëshmitarit, të dyja në PSRK dosja D.
- 45) **VS**, 17.05.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit; 23.07.2011 Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit në PSRK, të dyja në dosjen D të PSRK.
- 46) **LS**, 18.05.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit; 23.07 2011 Procesverbal i PSRK i dëgjimit të dëshmitarit, PSRK dosja D.
- 47) **Dëshmitari O**, 24.05.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, PSRK dosja D.
- 48) **Dëshmitari Q**, 26.05.2011 raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, PSRK dosja D.
- 49) **Dëshmitari P**, 25.05.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, PSRK dosja D.
- 50) **BET**, 05.04.2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, PSRK dosja D.

(PSRK dosja F)

- 51) Fletë-lëshim, dokument shënuar me **0096-09-EWC2/019**, PSRK dosja F.
- 52) Certificate, dokument shënuar si **0096-09-EWC2/020**, PSRK dosja F.
- 53) Certificate për shërbim në UÇK, dokument shënuar **0096-09-EWC2/021**, PSRK dosja F.
- 54) Udhëzues mbi zbatimin e procedurës kundrejt të ndaluarve, dokument shënuar **0096-09-EWC2/022**, PSRK dosja F.
- 55) Shënim burgut ushtarak, dokument shënuar **0096-09-EWC2/023**, PSRK dosja F.
- 56) Raport shërbimi, dokument shënuar **0096-09-EWC2/024**, PSRK dosja F.
- 57) Aktgjykim, dokument shënuar **0096-09-EWC2/025**, PSRK dosja F.
- 58) Aktgjykim, dokument shënuar **0096-09-EWC2/026**, PSRK dosja F.
- 59) Raport shërbimi, dokument shënuar **0096-09-EWC2/027**, PSRK dosja F.
- 60) Raport shërbimi, dokument shënuar **0096-09-EWC2/028**, SPRK dosja F.
- 61) Raport shërbimi, dokument shënuar **0096-09-EWC2/029**, PSRK dosja F.
- 62) Vendim, dokument shënuar **0096-09-EWC2/030**, PSRK dosja F.

- 63) Kërkesë, dokument shënuar **0096-09-EWC2/031**, PSRK dosja F.
- 64) Kërkesë, dokument shënuar **0096-09-EWC2/032**, PSRK dosja F.
- 65) Vendim, dokument shënuar **0096-09-EWC2/033**, PSRK dosja F.
- 66) Dekret, dokument shënuar **0096-09-EWC2/034**, PSRK dosja F.
- 67) Ankesë, dokument shënuar **0096-09-EWC2/035**, SPRK dosja F.
- 68) Njoftim, dokument shënuar **0096-09-EWC2/036**, PSRK dosja F.

(PSRK dosja H)

- 69) Raporti i Njesisë Hetimore për Krime Luftë të Policisë së EULEX-it me ditarin e hetimeve EWC nr. **0068-09-EWC4**, PSRK, dosja H (faqet. H2-H5).
- 70) Raporti i policisë mbi Zhvarrosjen, data 30.09.2009, PSRK, dosja H (faqet **H6-H20**).
- 71) Përmbledhje e informacionit, PSRK, dosja H (faqet **H21-H25**).
- 72) Raport Vlerësues i Policisë me shtojca, data 24-26.08.2009, PSRK dosja H (faqet **H30-H40**).
- 73) Urdhër për zhvarrosje, inspektim post mortem, autopsia dhe identifikimi, PPP nr.685/09, data 08.09.2009, PSRK, dosja H (faqe **H41**).
- 74) Komunikimi NJHKL me EULEX-in PP, data 27.09.2009, PSRK, dosja H (faqet **H45-H46**).
- 75) Deklaratat mbi zinxhirin komandues, PSRK, dosja H (faqet **H47-H48**).
- 76) Deklaratat e printuara të KNPZH mbi personat e zhdukur, PSRK, dosja H (faqet **H49-H53**).
- 77) Raporte autopsie lëshuar nga UNMIK të datës 29.10.2009, PSRK dosja H (faqet **H54-H59**).
- 78) Deklaratë mbi zinxhirin komandues, PSRK, dosja H (faqe **H60**).
- 79) Formularë dorëzimi të kufomave të zhvarrosura, data 23.25.09.2009, PSRK, dosja H (faqet **H61-H66**).
- 80) Certifikatë e vdekjes së BC, datë 12.12.2009 (faqet **H67-H68**).
- 81) Informacion mbi identifikimin e viktimës, PSRK dosja H (faqet **H69-H91**).
- 82) Certifikatë e vdekjes së DV, datë 12.12.2009 (faqet **H92-H93**).
- 83) Informacion mbi identifikimin e viktimës nr.1999-010047, PSRK, dosja H (faqet **H94-H111**).
- 84) Faqe me fotografi pamje e KER, PSRK dosja H (pp.**H112-H134**).

85) CD mbi zhvarrosjen e vendit të varrit të KER, PSRK, dosja H.

(PSRK dosja I)

86) CD ku përfshihen versionet elektronike të provave, PSRK, dosja I.

87) Raporte autopsie me shtojca mbi dy kufoma të gjetura në varrin në vendin KEQ, PSRK dosja I (faqet 1-198).

(PSRK dosja L)

88) CD që përmban versionin elektronik të autopsisë dhe raportet ante mortem, PSRK, dosja L.

89) **MG**, 20.01.2010, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit ekspert në procedurën hetimore, PSRK, dosja L.

90) **TE**, 20.01.2010, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit ekspert në procedurën hetimore, PSRK, dosja L.

91) Fotografi të varrit në vendin KER, PSRK, dosja L (faqet **L7-L9**).

92) Raporti i autopsisë dhe raporti ante mortem i kufomës KER01/001B, PSRK dosja L (faqet **L10-L96**).

93) Raporti i autopsisë dhe raporti ante mortem i kufomës KER01/004B, PSRK dosja L (faqet **L97-L237**).

94) Raporti i autopsisë dhe raporti ante mortem i kufomës KER01/005B, PSRK dosja L (faqet **L238-L335**).

95) Raporti i autopsisë dhe raporti ante mortem i kufomës KER01/006B, PSRK dosja L (faqet **L336-L412**).

96) Raporti i autopsisë dhe raporti ante mortem i kufomës KER01/004B, PSRK dosja L (faqet **L413-L516**).

(PSRK dosja M)

- 97) Raporti i policisë mbi bastisjen e pronave të NS (dosja nr.1-3), 18.03.2011, PSRK dosja M.
- 98) Urdhër mbi bastisjen GJPP 25/10 (PPS 07/10), data 17.03.2011, PSRK, dosja M.
- 99) Kërkesë për punësimin në polici të NXK, data 23.04.2002, PSRK, dosja M.
- 100) Raporti i Policisë mbi bastisjen bërë në UU, data 02.02.2011, me shtojca, PSRK dosja M.
- 101) Urdhër për bastisje GJPP 25/10 (PPS 07/10), data 19.11.2010, PSRK dosja M.
- 102) Fotografi të konfiskuara nga rezidenca e NS, PSRK dosja M.

(Dosja e Gjykatës, dosja 1)

- 103) **AC**, 03.08.2011, PSRK, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë procedurës hetimore, dosja 1 e Gjykatës.
- 104) **BZ**, 29.07.2011, PSRK, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë procedurës hetimore, dosja 1 e Gjykatës.
- 105) Raporte autopsie, dt.29.10.2009, dosja 1 e Gjykatës.

(Provat e Prokurorisë dosja I)

- 106) Prova **P2**, Raporti i oficerit, NJHKL, EULEX i datës 10.11.2011 mbi lokacione të rëndësishme në lidhje me lëndën Kleçka, bashkangjitur fotografi, provat e Prokurorisë, dosja I.
- 107) Prova **P3**, përgjigja e Departamentit të Mjekësisë Ligjore, EULEX Kosovë mbi personin e zhdukur AA, provat e Prokurorisë, dosja I.
- 108) Prova **P4**, certifikata e vdekjes së AZ, provat e Prokurorisë, dosja I.
- 109) Prova **P6**, **Dëshmitari Anonim I**, 02.11.2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë procedurës hetimore, provat e Prokurorisë, dosja I.
- 110) Prova **P7**, **MB**, 08.11.2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë procedurës hetimore, provat e Prokurorisë, dosja I.

- 111) Prova **P8**, **BEC**, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë procedurës hetimore, provat e Prokurorisë, dosja I.
- 112) Prova **P9**, **JS**, 02.11.2011, raport-marrja në pyetje deklarata e dëshmitarit, provat e Prokurorisë, dosja I.
- 113) Prova **P10**, **FZ**, 27.10.2011, raport-marrja në pyetje deklarata e dëshmitarit, provat e Prokurorisë, dosja I.
- 114) Prova **P11**, **SZ**, 26.10.2011, raport-marrja në pyetje deklarata e dëshmitarit, provat e Prokurorisë, dosja I.
- 115) Prova **P12**, **FLZ**, 26.10.2011, raport-marrja në pyetje deklarata e dëshmitarit, provat e Prokurorisë, dosja I.
- 116) Prova **P13**, **NZ**, 24.10.2011, raport-marrja në pyetje deklarata e dëshmitarit, provat e Prokurorisë, dosja I.
- 117) Prova **P14**, **IDZ**, 24.10.2011, raport-marrja në pyetje deklarata e dëshmitarit, provat e Prokurorisë, dosja I.
- 118) Prova **P15**, **BEH**, 23.11.2011, raport-marrja në pyetje deklarata e dëshmitarit, provat e Prokurorisë, dosja I.
- 119) Prova **P16**, **BT**, 24.11.2011, raport-marrja në pyetje deklarata e dëshmitarit, provat e Prokurorisë, dosja I.
- 120) Prova **P17**, **NB**, 12.09.2011, raport-marrja në pyetje deklarata e dëshmitarit, provat e Prokurorisë, dosja I.
- 121) Provat **P21a**, **P21b**, **P21c**, **P21d**, **P21f**, vendimi i Prokurorit Special të EULEX-it Maurizio Salustro për të marrë pjesë të dosjes së lëndës nr.2003/224/PEJ, deklarata e **TM** dhënë para organeve hetimore të Republikës së Serbisë, dt.27.1.2005 dhe 11.04.2004 dhe shtojca (2), provat e Prokurorisë , dosja I.
- 122) Prova **P22**, **AFZ**, 23.11.2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë procedurës hetimore, provat e Prokurorisë, dosja I.
- 123) Prova **P23**, **IDZ**, 23.11.2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë procedurës hetimore, provat e Prokurorisë, dosja I.

- 124) Prova **P24**, **CC**, 06.12.2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë procedurës hetimore, provat e Prokurorisë, dosja I.
- 125) Prova **P25**, **GK**, 07.12.2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë procedurës hetimore, provat e Prokurorisë, dosja I.
- 126) Prova **P26**, **SD**, 08.12.2011 procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë procedurës hetimore, provat e Prokurorisë, dosja I.
- 127) Prova **P27**, **MZS**, 12.12.2011 procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit, provat e Prokurorisë, dosja I.
- 128) Provat **P28a**, **P28b-P28f**, letër nga arkeologu i mjekësisë ligjore drejtuar Prokurorit Special të EULEX-it Maurizio Salustro, dt.8.12.2011, dhe tabela krahasuese (5), provat e Prokurorisë dosja I.
- 129) Provat **P29a** dhe **P29b**, raporti i Departamentit të Mjekësisë Ligjore DFM KEQ 01, dt.10.,11.8.2010, dhe raporti i Departamentit të Mjekësisë Ligjore DFM KEQ 02, dt.10.,11.8.2010, provat e Prokurorisë dosja I.
- 130) Provat **P30a-P30e**, letër nga hetuesi i NJHKL drejtuar Prokurorit Special të EULEX-it Maurizio Salustro, dt.15.09.2011, mbi raportet e zhvarrosjes, raporti i Policisë mbi zhvarrosjen, dt.24.9.2009, raporte shtesë të Policisë mbi zhvarrosjes, dt.17.8.2010, faqe me fotografi KEQ pamje e përgjithshme e Kleçkës, provat e Prokurorisë, dosja I.
- 131) Prova **P31**, **HYS**, 24.01.2012, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit, provat e Prokurorit, dosja I.
- 132) Prova **P33**, **BKO**, 07.02.2012, , procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit, provat e Prokurorit, dosja II.
- 133) Prova **P34**, PPS 07/10 tabelë me fotografi– shtojcë e dëgjimit të **Dëshmitarit V** 18.04.2011, provat e Prokurorisë, dosja II.
- 134) Prova **P35**, **GA**, 08.02.2012, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit, provat e Prokurorit, dosja II.
- 135) Prova **P36**, dosja e policisë nga Shtabi i Përgjithshëm i Policisë Duisberg lidhur me vdekjen e AZ, dt.28.09.2011, provat e Prokurorisë dosja II (me përjashtim të ashtuquajturit ‘Ditari Gjerman’, i cili u deklarua prova e papranueshme me anë të Vendimit 21.03.2012).

136) Prova **P37**, një dokument i vetëm, shënim zyrtar nga Kryeinspektori i Policisë Kriminale, dt.29.09.201, përgjigje e Doktorit të Përgjithshëm, dt.29.09.2011, shënim mbi autopsinë, provat e Prokurorisë, dosja II.

SHTOJCA II

PROVAT E PARASHTRUARA NGA MBROJTJA²⁷⁰

1) Prova e Mbrojtjes **D (NeK) 1**, një grumbull dokumentesh prej 32 faqesh, dokument parashtruar nga Avokati Mbrojtës Mahmut Halimi më datë 06 mars 2012, provat e Mbrojtjes dosja I.

Këtu përfshihen dokumentet si në vijim:

- 'Informacije o saobraćajnim prekršajima na Kosovu', PZ A Nr. 033264 (në gjuhën serbe);
- Dy dokumente të ndarë të UNMIK-ut 'Formular Deklarate', AZ dhe BHO (në gjuhën shqipe);
- Shërbimi i Policisë së Kosovës, 'Fillestar/ Raport mbi Incidentin', lënda Nr. 2005-GR-5628, dt.07.11.2005 (në gjuhën angleze);
- Urdhër i Gjykatës së Qarkut Prizren, Pndr. Nr. 1/2008, dt.03.01.2008 (në gjuhën shqipe);
- Shërbimi i Policisë së Kosovës, stacioni i Policisë Prizren, 'Raporti i policit', dt.09.01.2008 (në gjuhën shqipe);
- Shërbimi i Policisë së Kosovës, 'Fillestar/ Raport mbi Incidentin', lënda Nr. 2008-GI-4, dt.04.01.2008 (në gjuhën angleze);
- Shërbimi i Policisë së Kosovës, 'Formulari për ekzaminim i laboratorit të kriminalistikës së SHPK-se', lënda Nr. 2007-GA-3880 (në gjuhën shqipe);
- Kopje e pasaportës së FAK dhe 2 faqe të tekstit në gjuhën shqipe;
- Aktgjykim i Gjykatës së Qarkut Prizren, P nr. 63/2008, dt.30.04.2008 (në gjuhën shqipe);

²⁷⁰ Lista e provave parashtruar nga Mbrojtja nuk përfshin pjesët të cilat pretendohen të jenë pjesë e ditarit të AZ. Në veçanti, Prova e Mbrojtjes **D (FL) 1, 2, 2a**, e cila pretendohet të jetë pjesë e Ditarit të AZ, pjesë e provave të Mbrojtjes dosja I, dhe Prova e Mbrojtjes **D (FL) 5c** e cila pretendohet të jetë pjesë e Ditarit të AZ, pjesë e provave të Mbrojtjes dosja I. Prova e përmendur është veçuar nga lista duke patur parasysh Vendimin e Trupit Gjykses, data 21.03.2012, me anë të të cilit provat e AZ deklarohen prova të papranueshme.

- Shërbimi i Policisë së Kosovës, 'Fillestar/ Raport mbi Incidentin', lënda Nr. 2005-XP5-12, dt.09.06.2005 (në gjuhën angleze);
 - UNMIK 'Fillestar/ Raport mbi Incidentin', raporti Nr. 2001-JA-4083, dt.16.11.2001 (në gjuhën angleze);
 - Shërbimi i Policisë së Kosovës, 'Fillestar/ Raport mbi Incidentin', lënda Nr. 2005-XP5-22, dt.11.09.2005 (në gjuhën angleze).
- 2) Prova e Mbrojtjes **D (RM) 1**, letër drejtuar EULEX-it, dt.14.11.2011, parashtruar nga Avokati Mbrojtës Naim Qelaj, që përfshihet në provat e Mbrojtjes, dosja I.
 - 3) Prova e Mbrojtjes **D (RM) 2**, Letër Ankesë drejtuar PSRK-së, dt.29.11.2011, parashtruar nga Avokati Mbrojtës Naim Qelaj, që përfshihet në provat e Mbrojtjes, dosja I.
 - 4) Prova e Mbrojtjes **D (FL) 3**, ekspertizë grafike e dorëshkrimeve, dt.02.02.2012, HYK dhe CV e HYK, përfshirë në provat e Mbrojtjes dosja I.
 - 5) Prova e Mbrojtjes **D (FL) 4a**, listë e pronave të konfiskuara nga NJHKO, EULEX, dt.28.04.2010 (në Ministri), përfshirë në provat e mbrojtjes dosja I.
 - 6) Prova e Mbrojtjes **D (FL) 4b**, listë e pronave të konfiskuara nga NJHKO, EULEX, dt.28.04.2010, 29.04.2010 (në apartamentin ZZ; në LL; në XX), përfshirë në provat e Mbrojtjes, dosja I.
 - 7) Prova e Mbrojtjes **D (FL) 4c**, Deklaratë, dt.05.03.2012, DL, përfshirë në provat e Mbrojtjes, dosja I.
 - 8) Prova e Mbrojtjes **D (FL) 4d**, urdhër mbi bastisjen lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, dt.28.04.2010, PPS 425/09, GjPP 91/10, përfshirë në Provat e Mbrojtjes, dosja I.
 - 9) Prova e Mbrojtjes **D (FL) 5a**, artikull i Kohës Ditore, dt.14.10.2011, ARA ('Ekskluzive: AZ ka lënë testament publikimin e letrës në të cilën tregon mbi trajtimin nga Misioni i cili duhet t'a kishte mbrojtur'), përfshirë në provat e Mbrojtjes, dosja I.
 - 10) Prova e Mbrojtjes **D (FL) 5b**, kërkesë drejtuar Kohës Ditore, dt.08.02.2012, ENS, përfshirë në provat e Mbrojtjes, dosja I.
 - 11) Prova e Mbrojtjes **D (FL) 5d**, Kosova Sot intervistë me GZ ('GZ: EULEX-i m'a çoi burrin drejt vdekjes'), dt.31.10.2011, përfshirë në provat e Mbrojtjes, dosja I.

- 12) Prova e Mbrojtjes **D (FL) 5e**, kërkesë drejtuar Kosova Sot, dt.08.11.2011, ENS; Kosova Sot përgjigje, dt.15.11.2011, n/n, përfshirë në provat e Mbrojtjes, dosja I.
- 13) Prova e Mbrojtjes **D (FL) 5f**, Transkriptim ('dokumentari shfaqur në Klan Kosova TV mbi dëshmitarin X dhe vdekjen e tij'), përfshirë në provat e Mbrojtjes, dosja I.
- 14) Prova e Mbrojtjes **D (FL) 5g**, Kërkesë drejtuar Klan Kosova, dt.08.02.2012, ENS; Klan Kosova përgjigje, dt.08.02.2012, BHA, përfshirë në provat e Mbrojtjes dosja I.
- 15) Prova e Mbrojtjes **D (FL) 6**, Lajmërim për AZ, dt.24.08.2009, Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës, departamenti hetimor, VHO, përfshirë në provat e Mbrojtjes, dosja I.
- 16) Prova e Mbrojtjes **D (FL) 7**, letër e K.Khan, QC drejtuar Kryeprokurorit të EULEX-it, dt.31.01.12 (me dy shtojca: letër e K.Khan, QC drejtuar Prokurorit Special të EULEX-it Maurizio Salustro, dt.10.01.12; përfaqësimi penal i GZ, dt.29.11.11), letër e K.Khan, QC drejtuar Prokurorit Special të EULEX-it Maurizio Salustro, dt.10.01.12, përfshirë në provat e Mbrojtjes, dosja I.

SHTOJCA III

PROVAT E PËRJASHTUARA ME AKTGJYKIMIN

(PSRK dosja G)

(rezidenca e FL)

- 1) Raporti i Policisë, dt.07.06.2010, PSRK, dosja G (faqe **G1**).
- 2) Listë e sendeve të konfiskuara nga NJHKO më datë 29.04.2010 në rezidencën e FL, PSRK dosja G (pp.**G2-G4**).
- 3) Fotokopje e dosjes së policisë, ku përfshihen 169 dokumente, PSRK dosja G (faqet **G5-G244**).

(PSRK dosja M)

(prona e NK)

- 1) Raporte të Policisë, dt.18.07.2011, 14.07.2011, PSRK dosja M (faqet **M138-M142**).
- 2) Raport i Policisë mbi ekzaminimin ekspertizën e sendeve të konfiskuara në shtëpinë e NK, dt.20.06.2011, PSRK dosje M (faqet **M145-M180**).
- 3) DEP-NJHOK IT Njësia e Mjekësisë Ligjore, raporti i ekzaminimit të provave, dt.06.05.2011, PSRK dosja M (faqet **M207-M211**) dhe DVD e bashkangjitur, shënuar **0096-09-EWC2**. Përmbajtja e raportit dhe DVD janë përjashtuar vetëm nëse janë marrë nga bastisja e pronës së NK.
- 4) Raporti i Policisë mbi ekzaminimin ekspertizën e sendeve të konfiskuara në rezidencën e NK, dt.06.06.2011, dhe raportet e policisë, dt.16.03.2011, PSRK dosja M (faqet **M215-M226**). Përmbajtja e DEP –NJHKO IT Njësia e Mjekësisë Ligjore, evidence raporti i ekzaminimit, dt.06.05.2011, është përjashtuar përsa i përket bastisjes së pronës së NK (faqet **M227-M235**).